

LIGJ
Nr. 138/2016

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT EUROPIAN PËR
PROGRAMIN INTERREG IPA TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR ITALI-
SHQIPËRI-MALI
I ZI, 2014-2020

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për programin INTERREG IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Itali-Shqipëri-Mali i Zi, 2014-2020, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 22.12.2016

Shpallur me dekreten nr. 9941, datë 9.1.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE FINANCIMI
PËR PROGRAMIN INTERREG IPA BNK
ITALI-SHQIPËRI-MALI I ZI 2014-2020
CCI 2014TC1615CB008

KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si “Komisioni”, që vepron në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si “Unioni”,

nga njëra anë, dhe

nga ana tjetër,

Republika e Shqipërisë, në vijim e referuar si “Përfituesi IPA II”, e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Programi

1. Unioni pranon të financojë dhe përfituesi IPA II bie dakord të pranojë financimin e Programit të mëposhtëm të bashkëpunimit ndërkufitar, siç përcaktohet në shtojcën I dhe miraturar me vendimin e Zbatimit të Komisionit nr. C(2015)9491, të datës 15 dhjetor 2015, korrigjuar nga vendimi i Zbatimit të Komisionit nr. C(2016)2803 i datës 3 maj 2016:

INTERREG – IPA BNK –Itali-Shqipëri– Mali i Zi 2014-2020

CCI 2014TC1615CB008

Referuar si “Programi”

2. Programi financohet nga Buxheti i Unionit, mbështetur në bazë të aktit themelor në vijim:

Rregullorja (BE) nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 mars 2014, Për krijimin

e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)¹ (Rregullorja IPA II, “IPA II”);

3. Vlera totale e parashikuar për Programin është 92,707,558.00 euro, kontributi maksimal i Unionit për Programin nën IPA II është caktuar në vlerën 78,801,422.00 euro, nga të cilat 39,400,711.00, si kontribut nga titulli 4.

Kontributi i Unionit ndahet në pagesa vjetore sipas shtojcës I. Asgjë në këtë marrëveshje financimi nuk mund të interpretohet se nënkupton një angazhim financiar të BE-së në lidhje me kreditë për të cilat ende nuk janë miratuar me miratimin e buxhetit të BE-së. Komisioni duhet të informojë Autoritetin Menaxhues me shkrim në lidhje me miratimin vjetor të angazhimeve financiare të përcaktuara në shtojcën II.

Programi kërkon kontribute financiare edhe nga përfituesi IPA II edhe nga Unioni. Ndarja e kontributeve përkatëse financiare përcaktohet në shtojcën III.

Neni 2

Periudha e zbatimit dhe periudha e pranueshmërisë

1. Periudha e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi fillon me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe përfundon 12 vjet pas kësaj date.

2. Në IPA II, shpenzimet e përfituesit janë të pranueshme për financim nën asistencën IPA II në qoftë se ato janë shkaktuar nga një përfitues përfundimtar nga përfituesit e IPA II dhe paguhet pas dorëzimit të Programit, përkatësisht 30 qershor 2015 dhe para 31 dhjetorit 2023.

Neni 3

Interpretimi

1. Dispozitat dhe shtojcat e kësaj Marrëveshjeje interpretohen si dispozita që plotësojnë dhe kompletojnë kuadrin rregullator të parashikuar sipas nenit 1 të kësaj marrëveshjeje.

2. Kur ekzistojnë kundërthënie ndërmjet dispozitave në kushtet e veçanta të kësaj marrëveshjeje dhe në shtojcat e saj dhe, në veçanti, dispozitat në shtojcën IV (“Kushtet e përgjithshme”), do të mbizotërojnë dispozitat e përfshira në kushtet e veçanta të kësaj Marrëveshjeje.

3. Për çfarëdo dispozite të shprehur në kundërshtim me këtë Marrëveshje, termat e përdorur në këtë Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim që u është atribuar në aktet themelore të renditura në nenin 1, pika 2.

4. Për çfarëdo dispozite të shprehur në kundërshtim me këtë Marrëveshje, referimet ndaj kësaj Marrëveshjeje janë referimet ndaj kësaj Marrëveshjeje, të ndryshuar, të shtuar ose të zëvendësuar herë pas here.

5. Çdo referencë e bërë në këtë Marrëveshje dhe në shtojcat e saj për instrumentet e Bashkimit Evropian janë referenca të këtyre instrumenteve të ndryshuara, plotësuara ose të zëvendësuara herë pas here.

6. Titujt në këtë Marrëveshje dhe në shtojcat e saj nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk cenojnë interpretimin e saj.

Neni 4

Pavlefshmëria e pjesshme dhe mangësitë e paqëllimita

1. Në rast se ndonjëra prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme, ose në rast se në këtë marrëveshje ka ndonjë mangësi të paqëllimtë, kjo nuk do të cenojë vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët do të zëvendësojnë secilën dispozitë të pavlefshme me një të vlefshme, sa më të përshtatshme me qëllimin e dispozitës së pavlefshme.

2. Palët do të plotësojnë çdo mangësi të paqëllimshme me dispozita sa më të përshtatshme me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.

Neni 5

Adresat dhe komunikimi

Të gjitha komunikimet lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi duhet të bëhen me shkrim dhe duhet t'i referohen shprehimisht Programit të identifikuar në nenin 1, pika 1, dhe dërgohen në adresat e mëposhtme:

¹ GZ L 77, 15.03.2014, f. 11

a) Për Komisionin:

Komisioni Evropian

Drejtoria e Përgjithshme për Politikën Rajonale dhe Urbane

1049 Bruksel – Belgjikë

e-mail: REGIO-TRANSNATIONAL-AND-INTERREGIONAL-COOPERATION@ac.europa.eu

b) Për Përfutjesin IPA II:

Daniela Çekani, Sekretare e Përgjithshme

Ministria e Integritimit Evropian

Drejtoria e Bashkëpunimit Territorial

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, sheshi “Nënë Tereza”

1010, Tiranë – Shqipëri

Tel. +355 (0) 4 228645

e-mail: daniela.cekani@integrimi.gov.al; ana.xhilaga@integrimi.gov.al

Neni 6

Marrëveshja Kuadër

Në përputhje me nenin 8, pika 5, të Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, mbi marrëveshjet për zbatimin e Asistencës Financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), e cila hyri në fuqi më 16 prill 2015 (referuar më tej si “Marrëveshja Kuadër”), rregullat për zbatimin e Programit përcaktohen në këtë Marrëveshje Financimi. Si pasojë, Programi duhet të zbatohet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Financimi ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë.

Kjo Marrëveshje Financimi plotësohet me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër, në veçanti, në ato raste kur kjo Marrëveshje Financimi nuk përmban dispozita të posaçme mbi një çështje të caktuar.

Në rast mospërputhje, nga njëra anë, ndërmjet dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe nga ana tjetër, dispozitave të Marrëveshjes Kuadër, marrin përparësi këto të fundit.

Neni 7

Shtojcat

1. Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:

a) këto kushte të veçanta;

b) shtojcat e mëposhtme, të cilat formojnë një pjesë integrale të saj:

i) shtojca I: Programi i Bashkëpunimit “Interreg IPA-BNK”;

ii) shtojca II: Plani financiar (angazhimet/ detyrimet vjetore financiare);

iii) shtojca III: Plani financiar (pjesë e kontributeve financiare të Unionit dhe përfituesve të IPA II sipas aksit prioritar);

iv) shtojca IV: Kushtet e përgjithshme.

2. Në rast mospërputhje, nga njëra anë, ndërmjet dispozitave të shtojcave dhe nga ana tjetër, dispozitave të kushteve të veçanta, marrin përparësi këto të fundit.

Në rast mospërputhje midis, nga njëra anë, dispozitave të shtojcës I dhe, nga ana tjetër, dispozitave të shtojcës IV, marrin përparësi këto të fundit.

Neni 8

Dispozitat plotësuese të shtojcës IV

Dispozitat plotësuese të shtojcës IV:

a) Në plotësim të nenit 11, pika 2, të shtojcës IV, vendet pjesëmarrëse në Program nuk kanë rënë dakord mbi rregullat dhe kushtet specifike lidhur me zhvillimin lokal të udhëhequr nga komuniteti, planet e përbashkëta të veprimit dhe investimet territoriale të integruara, pasi Programi nuk i parashikon këto veprime;

b) Në plotësim të nenit 34, pika 1, të shtojcës IV, këto kushte të veçanta nuk lejojnë pjesëmarrjen në thirrjen për propozime të subjekteve pa personalitet juridik;

c) Në plotësim të nenit 34, pika 5, të shtojcës IV, pranueshmëria sipas këtij neni nuk është e kufizuar më tej në lidhje me kombësinë, vendndodhjen gjeografike ose natyrën e aplikantëve;

d) Në plotësim të nenit 37, pika 4, të shtojcës IV, vendet pjesëmarrëse në Program nuk e kanë përcaktuar

autoritetin menaxhues të vetëm për të kryer funksionet e autoritetit certifikues;

e) Në plotësim të nenit 42, pika 3, të shtojcës IV, përfituesi IPA II nuk e ka autorizuar autoritetin e auditimit për të kryer direkt funksionet e parashikuara në nenin 127 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 në të gjithë territorin e mbuluar nga programi i bashkëpunimit;

f) Në plotësim të nenit 45, të shtojcës IV, Koordinatori Kombëtar IPA e ka deleguar rolin e tij menaxhues për koordinimin e pjesëmarrjes së përfituesit IPA II në programin përkatës ndërkufitar në Strukturën Operuese të Bashkëpunimit Territorial, në kuadër të Ministrisë së Integrimit Evropian;

g) Në plotësim të nenit 49, të shtojcës IV, shkalla e bashkëfinancimit dhe shuma maksimale e asistencës IPA II bazohen në shpenzimet totale të pranueshme, përfshi shpenzimet publike dhe private;

h) Në plotësim të nenit 57, pika 3, të shtojcës IV, metoda e zgjedhur për këtë Program është ajo e përmendur në shkronjën (a) të nënparagrafit të parë të këtij neni;

i) Në plotësim të nenit 73, pika 3, të shtojcës IV, vendet pjesëmarrëse kanë vendosur të mos rimarrin asnjë shumë të paguar padrejtësisht në rast se shuma që do të mbulohet nga përfituesi, pa përfshirë interesin, nuk e kalon vlerën prej 250 eurosh nga kontributi i asistencës financiare IPA II.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi hyn në fuqi në datën në të cilën Komisioni merr një njoftim nga përfituesi IPA II që konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme të përfituesit IPA II të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi. Komisioni informon përfituesin IPA II për datën e marrjes së këtij njoftimi.

Kjo Marrëveshje Financimi është hartuar në dy kopje në gjuhën angleze, një kopje i dorëzohet Komisionit dhe një kopje për përfituesin IPA II.

Për Përfituesin IPA II:

Znj. Klajda Gjoshaj

Ministre e Integrimit Evropian

Koordinatorë Kombëtarë IPA

Nënshkrimi

Tiranë, më....../.../2016

Për Komisionin:

Z. Walter Deffaa

Drejtor i Përgjithshëm DG REGIO

Nënshkrimi

Bruksel,....../.../2016

PROGRAM BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR INTERREG IPA II

ITALI-SHQIPËRI-MAL I ZI

2014–2020



Version 1.4
Tetor 2015

CCI
Titulli
Version
Viti i parë
Viti i fundit
Në fuqi nga
Në fuqi deri më
Numri i vendimit të KE-së
Data e vendimit të KE-së
ShA që ndryshojnë numrin e vendimit
ShA që ndryshojnë datën e vendimit
ShA që ndryshojnë datën e hyrjes në fuqi të vendimit
Rajonet e nivelit III NUTS (ose rajonet ekuivalente ITF21 Isernia në shtetet joanëtare) që mbulohen nga programi bashkëpunimit ndërkufitar

2014TC16I5CB008

<0.3 type="N" input="G">

2014

2020

1 janari 2014

31 dhjetor 2023

<0.8 type="S" input="G">>

<0.9 type="D" input="G">>

<0.10 type="S" maxlength="20" input="M">>

<0.11 type="D" input="M">>

<0.12 type="D" input="M">>

ITF21 Isernia

ITF22 Campobasso

ITF44 Brindisi

ITF45 Leçe

ITF46 Foggia

ITF47 Bari

ITF48 Barletta-Andria-Trani

AL Shqipëri

ME Mali i Zi

PËRMBLEDHJE
Versioni 1.4

SEKSIONI 1: STRATEGJIA PËR KONTRI-BUTIN E KONTRIBUTIT TË PROGRAMIT NË PRIORITETET E ZGJEDHURA TEMA-TIKE DHE MARRËVESHJES PËRKATËSE TË PARTNERITETIT, SI DHE DOKUMENTEVE KOMBËTARE STRATEGJIKE

Sekcioni 1: Strategjia për kontributin e kontributit të programit në prioritetet e zgjedhura tematike dhe marrëveshjes përkatëse të partneritetit, si dhe Dokumenteve Kombëtare Strategjike

PËRSHKRIMI I STRATEGJISË SË PROGRAMIT TË BASHKËPUNIMIT PËR KONTRIBUTIN NË PRIORITETET TEMA-TIKE TË ZGJEDHURA DHE MARRËVESHJES PËRKATËSE TË PARTNERITETIT, SI DHE DOKUMENTEVE KOMBËTARE STRATEGJIKE. STRATEGJIA “EUROPA 2020” SHPALOS TRI PRIORITETE TË PËRBASH-KËTA PËRFORCUESE

1.1.1.1 TERRITORI I PROGRAMIT

1.1.1.2 SPECIFIKAT GJEOGRAFIKE

1.1.1.3 PROFILI TERRITORIAL, SOCIO-EKONOMIK

STRUKTURA DEMOGRAFIKE

PERFORMANCA EKONOMIKE

TREGU I PUNËS DHE PUNËSIMI

ARSIMI

SHËNDETËSIA

1.1.1.4 KËRKIMI, INOVACIONI DHE KONKURRENCA E SME-ve

SFIDAT RAJONALE TË INOVACIONIT

1.1.1.5 ATRAKTIVITETET TERRITORIALE: TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE

TURIZMI SI MOTOR ZHVILLIMI

RUAJTJA DHE MIRËMBAJTJA E BURI-MEVE NATYRORE

1.1.1.6 MBROJTJA E MJEDISIT, MENA-XHIMI I RREZIKUT DHE STRATEGJITË E KARBONIT TË ULËT

NDRYSHIMET E KLIMËS

CILËSIA E AJRIT

EKSPOZIMI NDAJ RREZIQEVE NATYRORE

MENAXHIMI I BURIMEVE UJORE DHE MBETJEVE

STRATEGJITË E KARBONIT TË ULËT DHE BURIMET E RIPËRTËRITSHME

1.1.1.7 RRJETET NDËRKUFTARE DHE AKSESUESHMËRIA

PORTET

AEROPORTET

RRJETI RRUGOR

RRJETI HEKURUDHOR

INFRASTRUKTURA ENERGJITIKE

ANALIZA E PUNËS

ARGUMENTIMI PËR ZGJEDHJEN E PRIORITETEVE TEMATIKE

1.1.2 ARGUMENTIMET MBI ALOKIMET FINANCIARE

Sekcioni 2.1 Përshkrimi i akseve prioritare (ndryshme nga asistenca teknike)

2.a.1 Aksi prioritar 1

2.a.2 Fondi, përllogaritja bazë për mbështetjen e BE-së dhe argumentimin e zgjedhjes së përllogaritjes bazë.

2.a.3 Objektivat specifike të prioritetit tematik dhe rezultatet e pritshme

2.a.4 Udhëzimi i parimeve për zgjedhjen e operacioneve

2.a.5 Veprimet e mbështetura nga prioritetet tematike

2.b.1 Aksi prioritar 2

2.b.2 Fondi, baza e llogaritjes për mbështetjen e unionit dhe argumentimi për zgjedhjen e bazës së llogaritjes

2.b.3 Objektivat specifike të prioritetit tematik dhe rezultatet e pritshme

2.b.4 Parimet rregulluese për përzgjedhjen e projekteve

2.b.5 Veprimet që do të mbështeten sipas prioritetit tematik (nga prioriteti tematik)

2.c.1 Aksi prioritar 3

2.c.2 Fondi, baza e llogaritjes për mbështetjen e Unionit - argumentimi për zgjedhjen e bazës së përllogaritjes

2.c.3 Objektivat specifike të prioritetit tematik dhe rezultatet e pritshme

2.c.4 Parimet udhëzuese për përzgjedhjen e operacioneve

2.c.5 Veprimet që duhet të mbështeten nga prioritetet tematike

2.c.1 Aksi prioritar 4

2.d.2 Fondi, baza e llogaritjes për mbështetjen e Unionit dhe argumentimi për zgjedhjen e bazës së llogaritjes

2.d.3. Objektivat specifike të prioritetit tematik dhe rezultatet e pritshme

2.d.4. Parimet rregulluese për përzgjedhjen e operacioneve

2.d.5 Veprimet që do të mbështeten sipas prioritetit tematik (nga prioriteti tematik)

2.2.5 Treguesit specifike të programit⁸

2.2.5.1 Rezultatet e treguesve specifike të programit

Tabela 3: Treguesit e rezultatit specifik të programit

Tabela 4: Treguesit e kontributit specifik të programit

Tabelat 5-8: Kategoritë e ndërhyrjes

Seksioni 2.3 Tabela e përgjithshme e indika-torëve sipas aksit prioritar dhe prioritetit tematik

Përmbledhje e përdorimit të planifikuar të asistencës teknike

Seksioni 2.b Përshkrim i aksit prioritar për asistencë teknike

2.b.1 Aksi prioritar 5

2.b.2 Fondi, baza e llogaritjes për mbështetjen e Unionit dhe argumentimi për zgjedhjen e bazës së llogaritjes

2.b.3 Objektivat specifike të prioritetit tematik dhe rezultatet e pritshme

2.b.4 Treguesit e rezultatit

2.b.5 Aktet që duhen mbështetur dhe kontributi i tyre i pritshëm në shërbim të qëllimit specifik

2.b.5.1 Përshkrim i akteve që duhen mbështetur dhe kontributi i tyre i pritshëm në shërbim të qëllimit specifik

Seksioni 3. Planifikimi financiar

3.1 Shuma financiare nga IPA (në euro)

Tabela 15

3.2.a. Shuma financiare totale nga IPA dhe bashkëfinancimi kombëtar (në euro)

3.2.b. Ndarja sipas aksit prioritar dhe prioritetit tematik

Seksioni 4: Qasje e integruar për zhvillimin territorial (nëse është e nevojshme)

4.1 Zhvillimi i udhëhequr nga komuniteti vendor (nëse është e nevojshme)

4.2 Investimet territoriale të integruara (iti) (nëse është e nevojshme)

4.3 Kontributi i ndërhyrjeve të planifikuara për strategjitë makrorajonale dhe basenin detar

Seksioni i 5: Dispozitat zbatuese për programin e bashkëpunimit

Autoritetet dhe organet përkatëse

Tabela 19: Autoritetet e programit

Organi të cilit do t'i kryhen pagesat

Tabela 20: Organi/organet që kryejnë kontrollet dhe detyrat e auditimit

Procedura për ngritjen e sekretariatit të përbashkët

Përshkrimi përmbledhës i menaxhimit dhe marrëveshjeve të kontrollit

Struktura e përbashkët për zbatimin dhe ndarja e detyrave ndërmjet organeve të ndryshme

Komiteti i Përbashkët i Monitorimit (KPM)

Përbërja e Komitetit të Përbashkët të Monitorimit (KPM)

Roli dhe detyrat e Komitetit të Përbashkët të Monitorimit (KPM)

Autoriteti menaxhues

Verifikimet e menjëhershme në vend

Autoriteti certifikues

Autoriteti i auditimit

Sekretariati i përbashkët

Pikat kombëtare informative

Organizimi i vlerësimit dhe përzgjedhja e propozimeve të projekteve

Procedura e përzgjedhjes

Hapi i parë – vlerësim i zyrtar

Hapi i dytë – vlerësimi i cilësisë

Zgjidhja e ankesave

Lidhja e kontratës

Marrëveshja për verifikimin e menaxhimit - për t'u përshtatur më tej me rregullat e IPA-s

Verifikimi i shpenzimeve

ITALI

SHQIPËRI

MAL I ZI

Rimbursimi i përfituesve kryesorë nga autoriteti menaxhues

Informimi dhe komunikimi

Vlerësimi i programit

Shkëmbimi elektronik i të dhënave

Kthimi i pagesave nga përfituesit

Ndarja e detyrimeve mes vendeve pjesëmarrëse

Përdorimi i euros

Angazhimi i partnerëve

Përmbledhje e procesit të përgatitjes së programit të bashkëpunimit

Përshkrimi për përfshirjen e partnerëve

Përzgjedhja e partnerëve

Lista e partnerëve të përfshirë në procesin e konsultimit

Aksion i ndërmarrë për të lehtësuar pjesë-marrjen e partnerëve

Vlera kryesore e shtuar e partneritetit në përgatitjen e programit të bashkëpunimit

Rezultatet kryesore të konsultimeve me partnerët

Përshkrimi i angazhimit të partnerëve në zbatimin e programit të bashkëpunimit dhe përfshirjes në komitetin monitorues

Koordinimi me fondet e tjera ESI dhe instrumente dhe programe të tjera të BE-së

Seksioni 6: Parimet horizontale

Zhvillimi i qëndrueshëm

Mundësitë e barabarta dhe mosdiskriminimi

Barazi mes burrave dhe grave

Shtojcat (ngarkuar në sistemin elektronik të shkëmbimit të të dhënave si dosje më vete):

SEKSIONI 1: STRATEGJIA PËR KONTRIBUTIN E KONTRIBUTIT TË PROGRAMIT NË PRIORITETET E ZGJEDHURA TEMA-TIKE DHE MARRËVESHJES PÛRKATËSE TË PARTNERITETIT, SI DHE DOKUMENTEVE KOMBËTARE STRATEGJIKE

Seksioni 1: Strategjia për kontributin e kontributit të programit në prioritetet e zgjedhura tematike dhe marrëveshjes përkatëse të partneritetit, si dhe Dokumenteve Kombëtare Strategjike

PËRSHKRIMI I STRATEGJISË SË PROGRAMIT TË BASHKËPUNIMIT PËR KONTRIBUTIN NË PRIORITETET TEMA-TIKE TË ZGJEDHURA DHE MARRËVESHJES PËRKATËSE TË PARTNERITETIT, SI DHE DOKUMENTEVE KOMBËTARE STRATEGJIKE. STRATEGJIA “EUROPA 2020” PARAQET TRI PRIORITETE TË PËRBASHKËTA PËRFORCUESE

Strategjia Europa 2020 shpalos tri prioritetet e përbashkëta përforcuese:

- Rritje inteligjente: zhvillimi i ekonomisë bazuar në njohuritë dhe inovacionin

- Rritje e qëndrueshme: promovimi i një ekonomie më eficiente me burimet, më të gjelbër dhe konkurruese

- Rritje gjithëpërfshirëse: nxitja e një ekonomie me punësim të lartë që sjell kohezion social dhe ekonomik

Programi IPA CBC (2014–2020) mes Italisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi është hartuar në kuadrin e strategjisë evropiane për një rritje inteligjente, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme dhe dokumentet

kombëtare strategjike.

Strategjia i hap rrugën zhvillimit ekonomik të zonës së ndërhyrjes (rajoni në këtë rast) dhe ka ambicien të kontribuojë në zbatimin e katër shtyllave të EUSAIR-it: “Rritja Blu”, “Lidhja e rajonit”, “Cilësia mjedisore”, “Turizmi i qëndrueshëm”, të cilat janë në koherencë me prioritetet tematike të caktuara nga rregulloret e IPA-s dhe përzgjedhur nga delegacioni kombëtar si fushë e asistencës së Programit:

Nxitja e bashkëpunimit dhe konkurrencës së SME-ve, përmirësimi inteligjent dhe i qëndrueshëm i zhvillimit ekonomik, mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i përshtatjes së ndryshimeve klimatike dhe lehtësive, parandalimi i rrezikut dhe menaxhimi, promovimi i transportit të qëndrueshëm dhe përmirësimi i infrastrukturës publike.

Strategjia është zhvilluar duke marrë në konsideratë lidhjet mes prioritetëve të ndryshme dhe ndikimeve specifike e globale të masave zbatuese. Për shembull: promovimi i transportit të qëndrueshëm ka një ndikim direkt në mbrojtjen e mjedisit dhe konkurrencës, ndërkohë që ka një ndikim indirekt në zhvillimin e turizmit.

1 Krahasoni-Marrëveshja e Partneritetit me Italinë IT: I; Raporti Kombëtar Strategjik i Shqipërisë (2014-2020) draft versioni 3; Raporti i Progresit të Malit të Zi 2013 SËD (2013) 411 përfundimtar; Dokumenti Strategjik Indikativ për Malin e Zi (2014- 2020).

2 Rregullorja e BE-së nr. 231/2014, shtojca III “Prioritetet tematike të asistencës për bashkëpunim territorial”.

Në të njëjtën kohë, për promovimin e një transporti të qëndrueshëm, përpjekjet duhen bërë nga kërkuesit dhe kompanitë novatore për sa kohë që zhvillimi i teknologjisë dhe mjeteve nga autoritetet rajonale dhe ato kombëtare bazuar në politikat e paqëndrueshme dhe kuadrin ligjor.

Sipas rezultateve të analizës territoriale, sfidat janë përkthyer në TP dhe SO me një metodë të bazuar në rezultatin.

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të nxisë bashkëpunimin strategjik ndërkufitar për një rritje inteligjente dhe të qëndrueshme të fushës së programit, kryesisht përgjatë kufirit detar.

Qëllimi i tillë i përgjithshëm përbën bazën për përpunimin e kuadrit strategjik të programit, referuar katër prioritetëve tematike, përkatësisht:

a) Nxitja e konkurrencës, mjedisi i biznesit dhe zhvillimi i një kompanie të vogël dhe të mesme, tregtia dhe investimi nëpërmjet, ndër të tjera, promovimit dhe mbështetjes së sipërmarrjes, në veçanti;

b) Nxitja e turizmit dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore;

c) Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i përshtatjes së ndryshimeve klimatike dhe lehtësive, parandalimi i rrezikut dhe menaxhimi nëpërmjet masave të përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit, promovimit të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, efikasiteti së burimeve, burimet e energjisë së rinovueshme dhe kalimit në një ekonomi të sigurt, të qëndrueshme dhe me nivel të ulët karboni; promovimi i investimeve në adresimin e rreziqeve specifike, sigurimi i qëndrueshmërisë ndaj katastrofave dhe zhvillimi i sistemeve për menaxhimin e katastrofave dhe parapërgatitjet e emergjencave;

d) Nxitja e transportit të qëndrueshëm dhe përmirësimi i infrastrukturës publike, duke reduktuar izolimin nëpërmjet përmirësimit të aksesit në transport, informacione dhe rrjetet e komunikimit dhe shërbimet e duke investuar në sistemet dhe lehtësirat ndërkufitare të ujit, shpërdorimit të ujit dhe energjisë.

Prioritetet e përzgjedhura tematike janë ndarë në katër akse prioritare, duke reflektuar nevojat dhe sfidat e identifikuara në analizën territoriale të fushës së programit:

Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe konkurrencës së SME-ve.

Objektivat specifike lidhur me AP-1:

SO 1.1 Rivlerësimi i kushteve kuadër për zhvillimin e tregut ndërkufitar të SME-ve.

Rezultatet e pritshme, janë:

a) Rritja e bashkëpunimit dhe konkurrencës mes SME-ve nëpërmjet ndërveprimit mes biznesit dhe palëve kërkimore;

b) Kulturë e përforcuar e sipërmarrjes dhe aftësive sipërmarrëse dhe qëndrimit;

c) Rrjete dhe grumbull inovacioni të përforcuar dhe fuqizuar, veçanërisht në dimensionin e tyre ndërkufitar, kryesisht në fushën e ekonomisë blu, bujqësisë së qëndrueshme, përpunimit të ushqimit, ekonomisë së gjelbër dhe inovacioneve sociale.

Aksi prioritar është në përputhje me nevojat, sfidat dhe rezultatet e:

- Dokumentit Kombëtar Strategjik të Shqipërisë, i cili parashikon, ndër rezultatet që lidhen me fushën e

ndërhyrjeve, për të nxitur konkurrencën dhe inovacionin, veçanërisht nëpërmjet zhvillimit të sipërmarrjeve të vogla dhe mesatare, si rrjedhim duke nxitur integrimin e Shqipërisë në tregun rajonal dhe evropian; për të përmirësuar konkurrencën e përgjithshme në sektorin bujqësor dhe zonat rurale të qëndrueshme.

- Dokumenti Strategjik Indikativ për Malin e Zi, i cili thekson nevojat e Malit të Zi për përmirësimin e mjedisit të biznesit, duke zhvilluar lehtësira në infrastrukturën e informacionit për të reduktuar ndarjen dixhitale brenda vendit dhe, gjithashtu, boshllëkun me BE-në. Mali i Zi, gjithashtu, duhet të mbështesë aftësinë e industrive tradicionale për të konkurruar dhe bërë ndryshime nëpërmjet përmirësimit të TIK, trajnimit dhe zhvillimit të aftësive kompjuterike. Një tjetër mekanizëm i rëndësishëm për rritjen e konkurrencës në ekonominë e vendit përfshin përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit kërkimor dhe politikave novatore dhe duke forcuar lidhjet e saj me biznesin.

- Marrëveshja e Partneritetit Italian, ku objektivi tematik 3 “Promovimi i konkurrencës së SME-ve, bujqësi, peshkim dhe akuakulturë” i trajtohet për të arritur rezultatet e mëposhtme: forcimi, modernizimi dhe diversifikimi i sistemeve produktive territoriale; krijimi dhe konsolidimi i mikro e SME-ve; nxitja e konkurrencës, kushteve të punës dhe inovacionit në teknologji të sipërmarrjeve në sektorin e peshkimit.

Menaxhimi inteligjent i trashëgimisë natyrore dhe kulturore për shfrytëzimin e turizmit të qëndrueshëm ndërkufitar dhe bukurive territoriale.

Objektivi specifik lidhur me AP- 2:

SO 2.1 Promovimi i atraktivitetit të aseteve natyrore dhe kulturore për përmirësimin inteligjent dhe të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik.

SO 2.2 Rritja e bashkëpunimit mes faktorëve kyçë të fushës për shpërndarjen e produkteve novatore, kulturore dhe kreative.

Rezultatet kryesore të pritshme, janë:

- a) Menaxhim më të mirë, inteligjent dhe të qëndrueshëm të turizmit ndërkufitar;
- b) Përmirësim të produkteve dhe shërbimeve për asetet kulturore dhe natyrore ndërkufitare;
- c) Rritje të bashkëpunimit të strukturuar dhe rritjet në sektorët kreativë dhe kulturorë.

Ky aks prioritar kontribuon në mbulimin e nevojave dhe arritjen e rezultateve të pritshme siç përshkruhen në dokumentet në vijim:

Dokument i Kombëtar Strategjik i Shqipërisë, ku citohet qartësisht se fondet e IPA-s, gjithashtu, mund të parashikojnë asistencë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Potenciali i SME-ve kryesisht në industrinë e turizmit është nënvleftësuar. Lidhja e turizmit me ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore mund të luajë një rol të madh në nxitjen e zhvillimit dhe rritjes ekonomike.

Dokument i Strategjik Indikativ për Malin e Zi, i cili konsideron turizmin, energjinë, bujqësinë dhe zhvillimin rural, si fusha kryesore me potencial të madh zhvillimi. Ndaj reformat për përmirësimin e konkurrencës dhe inovacionit duhet t’u kushtojnë rëndësi të veçantë këtyre sektorëve ekonomikë. Kjo përfshin, ndër të tjera, përmirësimin e mjedisit për biznes, zbatim të rregullores, qasjes në kapital për SME-të.

Marrëveshja e Partneritetit me Italinë, ku objektivi tematik 6 “Mbrotja e mjedisit dhe promovimi i përdorimit efikas të burimeve” trajtohet për të përmirësuar kushtet dhe standardet e ofertave turistike dhe trashëgimisë kulturore, në fushat e bukurive natyrore; ripozicionim konkurrues të destinacioneve turistike; konsolidim, modernizim dhe diversifikim të sistemeve prodhuese territoriale (përfshirë sektorin e turizmit).

Mbrotja e mjedisit, menaxhimi i riskut dhe strategjia e karbonit të ulët

Objektivat specifikë lidhur me AP-3:

OS 3.1: Rritje të strategjive të bashkëpunimit ndërkufitar për peizazhet ujore

OS 3.2: Promovimi i praktikave novatore dhe mjeteve për reduktimin e emetimeve të karbonit për përmirësimin e efikasitetit së energjisë në sektorin publik.

Rezultatet kryesore të pritshme, janë:

- a) Plane shumënivëlëshe dhe shumësektoriale të miratuara në fushat e menaxhimit të ciklit të ujit, parandalimin e rreziqeve mjedisore e bregdetare dhe mbrotja e biodiversitetit;
- b) Iniciativa të integruara në fushat e menaxhimit të ciklit të ujit, parandalimin e rreziqeve mjedisore e bregdetare dhe mbrotja e biodiversitetit;
- c) Përmirësim të kapaciteteve të bashkëpunimit ndërkufitar/ kombëtar/ rajonal/ lokal për planifikim të qëndrueshëm të energjisë sipas standardeve të BE-së;

d) Skema efikase të energjisë për administrime publike të miratuara dhe arritje të objektivave për energji të qëndrueshme.

Ky aks prioritar është zhvilluar sipas dispozitave të parashikuara në Dokumentet Kombëtare Strategjike:

Dokumenti Kombëtar Strategjik i Shqipërisë parashikon se nevojat për investime në nënsektorët e ujit janë thelbësore, ndërkohë që ka kufizime të kapaciteteve menaxhuese. Asistenca e programit duhet të parashikohet për të mbështetur të ndryshmet për të menaxhuar elementet bazë të metodologjisë së një sektori, si: zhvillimi i strategjisë, planifikimi i buxhetit, zhvillimi institucional dhe organizativ, koordinimi me të tjerë. Për sa i përket sektorit të energjisë, nevojiten reforma për të garantuar funksionim të sistemit në përgjithësi.

Dokumenti Strategjik Indikativ i Malit të Zi parashikon se ndërhyrja për asistencë duhet të fokusohet në transpozimin dhe zbatimin e acquis për ujin, përgatitjen e planeve të menaxhimit të baseneve të lumenjve dhe krijimin e kushteve për krijimin e një sistemi eficient dhe efikas për menaxhimin e ujit. Në fushën e lehtësirave dhe adaptimit të ndryshimeve klimatike, aksionet e asistencës IPA do të përqendrohen në forcimin e kapaciteteve institucionale për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave lehtësuese, si dhe për rritjen e elasticitetit të sektorëve ekonomikë dhe infrastrukturës së cenuar ndaj ndryshimeve klimatike. Për më tepër, IPA II mund të mbështesë promovimin e efikasitetit energjetik dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme.

Marrëveshja e Partneritetit me Italinë, ku TO 4 “Ruajtja e qëndrueshmërisë së tranzicionit drejt ekonomisë me karbon të ulët në të gjithë sektorët” parashikon se rezultatet e pritshme të reduktimit të konsumit të energjisë në ndërtesa publike dhe reduktimi i rreziqeve hidrogeologjike dhe erozionit bregdetar.

Rritje të eksedit ndërkufitar, promovimi i shërbimeve dhe lehtësirave të qëndrueshme të transportit dhe përmirësimi i infrastrukturës publike.

Objektivat specifikë lidhur me AP-4:

OS 4.1: Rritja e koordinimit me palët e interesuara për promovimin e lidhjeve të qëndrueshme ndërkufitare në fushën e bashkëpunimit.

Rezultatet kryesore të pritshme, janë:

a) Lidhje të qëndrueshme transporti ndërkufitar brenda zonës janë përmirësuar;
b) Lidhje ekzistuese me kohë transiti dhe procedura të përbashkëta janë optimizuar;
c) Cilësia e lidhjeve ndërrajonale të zonës nëpërmjet rrjetit efikas multimodal të transportit është përmirësuar;

d) Konsolidim të zinxhirit të logistikës për mallrat për të sjellë një sistem të integruar transporti në çdo derë, duke prezantuar një ndërmodal të ri të bazuar në det.

Ky aks prioritar kontribuon në arritjen e rezultateve kryesore të pritshme, siç dhe tregohet në dokumentet në vijim:

Dokumenti Strategjik Kombëtar i Shqipërisë konsideron si prioritet në sektorin e transportit sigurimin e përfundimit dhe mirëmbajtjes së investimeve ekzistuese, lidhjen me rrjetet evropiane dhe adresimin e çështjeve të sigurisë.

Dokumenti Strategjik Indikativ i Malit të Zi përfshin ndër rezultatet kryesore të pritshme për t'u arritur nëpërmjet asistencës së IPA përmirësimin e kapaciteteve të administratës për përcaktimin e strategjisë së duhur të sektorit dhe hartimin e legjislacionit saktë, si dhe ngritjen e kapaciteteve për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve komplekse infrastrukturore; rritje të mundësive për zhvillimin e transportit të kombinuar; interkonjeksionin me vendet fqinje.

Marrëveshja e Partneritetit me Italinë në rezultatet e pritshme të objektivit tematik 7, përfshin përmirësimin e mobilizimit rajonal, integrimin modal dhe përmirësimin e lidhjeve multimodale; rritje të lidhjeve të rrjeteve sekondare dhe tretësore me rrjetin TEN-T.

Strategjia prezanton dy çështje ndërkufitare:

- “Përforcimi i kërkimit shkencor, zhvillimi teknologjik, inovacionit e informacionit dhe teknologjive të komunikimit nëpërmjet, ndër të tjera, promovimit të ndarjes së burimeve njerëzore dhe instrumenteve për kërkime shkencore dhe zhvillimin e teknologjisë” (këtu “Kërkim shkencor dhe inovacion”) si kusht, i cili do të sillte çdo lloj zhvillimi ekonomik;

- “Promovimi i qeverisjes vendore dhe rajonale dhe rritja e kapaciteteve planifikuese dhe administrative të autoriteteve vendore dhe rajonale” (këtu “Qeverisja”), si parakusht për arritjen e objektivave të strategjisë dhe për zbatimin me efikasitet të politikave, masave dhe instrumenteve të strategjisë në të gjitha prioritetet

tematike.

Të dyja mjetet konsiderohen horizontale në analizën e shtyllave të identifikuar në aksionet specifike.

Kërkimi shkencor dhe inovacioni janë kusht për çdo lloj zhvillimi dhe janë pika thelbësore për t'u konsideruar në zbatimin e ndërhyrjes së programit.

Zhvillimi i dimensionit sistematik të inovacionit, përmirësimi i lidhjeve mes aktorëve të ndryshëm novatorë, kryesisht sistemit shkencor dhe arsimit të lartë, qeverisë dhe sektorit privat, me synim lehtësimin e transferimit teknologjik dhe komercia-lizimin e rezultateve kërkimore është veçanërisht i përshtatshëm për fushën e bashkëpunimit. Inovacioni i vazhdueshëm teknologjik, menaxhues dhe operacional përbën një motor të rëndësishëm për zhvillim dhe rritje të qëndrueshme. Çdo entitet publik dhe privat, që operon në fushën e inovacionit, luan një rol të ndryshëm, por aq dhe të rëndësishëm në fushën e inovacionit dhe kërkimit shkencor: qeveritë dhe institucionet publike janë aktorë kyçë për krijimin e kushteve të favorshme për inovacion, mbështesin kompanitë novatore dhe universitetet nëpërmjet stimujve dhe mekanizmave të tjerë; institucionet kërkimore janë të përfshira në mënyrë tipike në kërkimin bazë dhe të aplikuar dhe gjenerojnë njohuri të reja; kompanitë janë thelbësore në shndërrimin e njohurive në produkte të reja dhe shërbime dhe janë aktive veçanërisht në pjesën e R&D, duke çuar në komercializimin nëpërmjet testeve zhvilluese, prototipave etj. Aksionet “Kërkim shkencor dhe inovacion” do të rrisin koordinimin dhe sinergjitë mes këtyre aktorëve për të krijuar një sistem efikas si motor për konkurrencën dhe përfitimet produktive, ndaj dhe duke u siguruar MSME-ve qëndrueshmëri dhe rritje. Për më tepër, duke stimuluar kompanitë që të mësojnë nga njëra-tjetra dhe shkëmbejnë përvojat, duke ndarë qasjet në kërkime dhe mjete testimi është, gjithashtu, një shtytje për krijimin e lidhjeve ndërkombëtare.

Çështja tjetër ndërkufitare “Promovimi i qeverisjes vendore dhe rajonale dhe rritja e kapaciteteve planifikuese dhe administrative të autoriteteve vendore dhe rajonale” është thelbësore për efikasitetin e ndërhyrjes së Programit.

Edhe pse shtetet pjesëmarrëse kanë korniza të ndryshme legjislative dhe operationale ku institucionet vendore operojnë, atyre u duhet të përballen me sfida të përbashkëta në fushat e ndryshme të ndërhyrjes së Programit. Aksionet për “Ngritjen e kapaciteteve” do të rrisin kapacitetet e sektorit publik në shtetet e përfshira- në veçanti duke pasur parasysh rritjen e kapaciteteve administrative dhe institucionale dhe për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në fushën e ndërhyrjes sipas standardeve të BE-së. Në këtë kontekst, ngritja e kapaciteteve, ndër të tjera, ndihmon planifikimin e përbashkët, financimin dhe zbatimin e aksioneve, para së gjithash për të mbështetur strategjinë makrorajonale.

1.1.1.1 TERRITORI I PROGRAMIT

Ky Program Bashkëpunimi (PB) përshkruan kontekstin dhe prioritetet për bashkëpunim ndërkufitar (CBC) ndërmjet Italisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi për periudhën 2014–2020. Ai ka për qëllim t'u mundësojë aktorëve rajonalë dhe vendorë nga të tria (3) vendet të shkëmbejnë njohuritë dhe përvojat, për të ndërmarrë dhe zbatuar aksione pilot, për të testuar fizibilitetin e politikave të reja, produkteve dhe shërbimeve dhe për të mbështetur investimet. Programi është i bashkëfinancuar nga Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF) dhe Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA) dhe ka një buxhet total prej 92.707.555,00 EUR (përfshirë bashkëfinancimin kombëtar).

Ky seksion paraqet territorin e lejueshëm të programit, analizon karakteristikat kryesore të tij dhe ofron një pasqyrë të sfidave të zhvillimit që rrethojnë zonën e Programit, të cilat mund të trajtohen nëpërmjet bashkëpunimit ndërkufitar. Ai synon të shërbejë si pikënisje për të shpalosur një strategji programi, e cila synon të përmirësojë kohezionin ekonomik, social dhe territorial të zonës dhe në të njëjtën kohë për të kontribuar në Strategjinë EU2020, Evropa Juglindore (EJL) 2020 dhe në Strategjinë e BE-së për rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR).

Në vijim të kërkesave specifike të vendeve pjesëmarrëse, Zona e Programit IT-AL-ME u shtri dhe si rezultat rajonet, janë:

Shtetet anëtare:

Italia: 2 rajone, 8 provinca

Vendet IPA:

Shqipëria: Gjithë vendi

Mali i Zi: Gjithë vendi

Strategjia e programit bazohet në rezultatet e analizave territoriale, përfundimet e procesit të konsultimit

dhe mësimet e nxjerra nga programet e tjera për bashkëpunim që mbulonin të njëjtën zonë të lejueshme, gjatë periudhës 2007–2013. Më konkretisht, analiza territoriale ka marrë parasysh dokumentet e mëposhtme:

- Marrëveshjen e Partneritetit me Italinë
- 2 Programet operationale rajonale të ERDF-së për Molise dhe Pulia;
- Progres Raporti i KE-së 2013 dhe Dokumenti Strategjik Kombëtar për Shqipërinë;
- Progres Raporti i KE-së 2013 dhe Dokumenti Strategjik Indikativ për Malin e Zi 2014–2020;
- Raportet tematike mbi inovacionin dhe “specializimin inteligjent” për të tria vendet;
- Statistikat kombëtare dhe të Eurustat-it.

1.1.1.2 SPECIFIKAT GJEOGRAFIKE

Zona e Programit është e pozicionuar në mënyrë strategjike mes Evropës Lindore dhe detit Mesdhe. Ajo mbulon një total prej 66.365 km² dhe ka një popullsi prej 7.805.809 banorësh. Shqipëria mbulon pjesën më të madhe të zonës së Programit (më shumë se 40%), kurse rajoni italian, Molise pjesën më të vogël (4437 km²).

Rajoni i Pulias kufizohet me detin Adriatik në lindje, detin Jon në juglindje dhe Kanalin e Otrantos e gjirin e Tarantos në jug. Skaji më jugor, i njohur si Gadishulli Salento, formon një takë të lartë për “çizmen” e Italisë. Pulia është kryesisht fushore; Bregdeti i saj i shkurtër thyhet nga malet Gargano në veri dhe ka male në pjesën veriqendrore të rajonit. Ajo kufizohet nga Molise në veri, Campania në perëndim dhe Basilicata në jugperëndim. Ka fqinje: Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Kroacinë, Greqinë dhe Malin e Zi përgjatë detit Adriatik dhe Jon.

Rajoni i Molise kufizohet me Abruzzo në veriperëndim, Lazio në perëndim, Campania në jug, Pulia në juglindje dhe detin Adriatik në verilindje. Territori karakterizohet nga male në brendësi e që rrethohet nga fushat kodrinore bregdetare.

Shqipëria ndan një kufi prej 172 km me Malin e Zi në veriperëndim, 115 km me Kosovën në verilindje, 151 km me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë në veri dhe në lindje 282 km me Greqinë në jug dhe juglindje. Vija bregdetare e saj ka gjatësi 487 km. Ultësirat e pjesës perëndimore të detit Adriatik dhe ngushticës së Otrantos me rëndësi strategjike, ku distanca mes Shqipërisë dhe Pulias është më pak se 100 km. Shqipëria ka një vijë bregdetare përgjatë detit Adriatik dhe Jon. Shumica e territorit të vendit është e mbuluar nga malet.

Mali i Zi ka një vijë bregdetare prej 293,5 km në detin Adriatik në jugperëndim dhe kufizohet nga Kroacia në perëndim, Bosnjë-Hercegovina në veriperëndim, Serbia në verilindje, Kosova në lindje dhe Shqipëria në juglindje.

1.1.1.3 PROFILI TERRITORIAL, SOCIO-EKONOMIK

STRUKTURA DEMOGRAFIKE

Rajoni italian, Pulia, është rajoni më i populluar me 50% të popullsisë së zonës së Programit të përqendruar aty (4.050 milionë banorë). Regjistrimi i fundit i popullsisë në vitin 2010 ka shënuar një rritje prej +1.52% të popullsisë nga 2001-a më 2010-n. Për më tepër, një komunitet i rëndësishëm shqiptarësh prej 12.000 njerëzve janë të regjistruar në rajon. (Burimi: ISTAT)

Molise ka një popullsi prej 319,780 banorësh. Regjistrimi i fundit i popullsisë në vitin 2010 ka regjistruar një rënie prej -0.57% të popullsisë nga 2001-a më 2010-n. Një dendësi mesatare prej 63.60 banorësh për m² e bën atë rajonin e dytë më të vogël, më pak të populluar dhe me dendësi më të vogël të popullsisë në Itali. (Burimi: ISTAT)

Shqipëria ka një popullsi prej 2.8916 milionë banorësh për një sipërfaqe totale prej 28750 km². Regjistrimi i fundit i popullsisë në vitin 2011 ka shënuar një rënie prej 8.8% të popullsisë nga 2001-a më 2011-n. Kjo është për shkak të prirjes së vazhdueshme të emigracionit, kryesisht në vendet fqinje, si Greqia dhe Italia. Vlen të përmendet se Shqipëria regjistron lëvizje migrimi të brendshëm drejt qyteteve më të zhvilluara në Perëndim (kryesisht zona bregdetare dhe Tiranë). (Burimi: INSTAT)

Popullsia e Malit të Zi, gjatë dy dekadave të fundit, ka mbetur pothuajse e pandryshuar për sa i përket numrit të përgjithshëm, nga 615,035 në vitin 1991 në 620,029 në vitin 2011, sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011. Vendi mbulon një sipërfaqe prej 13812 km² dhe ka një dendësi të popullsisë prej 44.9 për km². Megjithatë, struktura demografike e vendit ka ndryshuar konsiderueshëm për shkak të migrimit të madh të popullatës dominuese rurale në zonat urbane. Së bashku me shpopullimin, zonat rurale dhe qytetet e vogla janë prekur nga një proces “emigrimi i trurit”, duke i lënë ata pa burime njerëzore të kualifikuara.

PERFORMANCA EKONOMIKE

Kriza globale ekonomike e pesë viteve të fundit ka ndikuar dukshëm në zonën e Programit. Rritja e përgjithshme në terma të GDP-së ka qenë e ngadaltë. Kriza ka kthyer përmbys procesin e konvergencës së GDP-së rajonale për frymë dhe papunësinë në Itali, dhe goditi Shqipërinë e Malin e Zi kohën e konsolidimit të progresit të bërë pas daljes nga vitet e paqëndrueshmërisë politike dhe programet e dhimbshme të reformave ekonomike. Për shumicën e vendeve në rajonin e Ballkanit, periudha 2003–2007 ishte ndër më të fortat në më shumë se një dekadë, me rritje vjetore të GDP-së reale mesatarisht rreth 6%, ndërkohë që rajoni pati fluks të madh të IHD-ve gjatë 2003–2007. Ngadalësimi ekonomik në vendet e BE-së, përfutjesit kryesorë të eksporteve të Ballkanit dhe rënia e fluksit të investimeve të huaja direkte dha shenjat e para të krizës në Zonën e Programit deri në tremujorin e fundit të vitit 2008, nga e cila ende nuk është rikuperuar.

Edhe pse Italia është ekonomia e tretë më e madhe në Eurozonë, ekonomia e saj është tkurrur gjatë viteve të recesionit. Në rajonin e Pulias, gjatë periudhës 2000–2011, shkalla e rritjes së GDP-së për frymë ishte -3,4%, duke u tkurrur me një ritëm më të shpejtë se mesatarja kombëtare (-2,3%). Edhe pse Pulia konsiderohet si një nga rajonet më dinamike në Italinë e Jugut, gjatë periudhës 2000–2012, konvergjenca e GDP-së bruto në vlera kombëtare ka qenë e dobët, veçanërisht për shkak të rritjes së ngadaltë të produktivitetit (1,7 vs. + 2.3%). (Burimi: DG Enterprise and Industry, Regional Innovation Monitor Plus)

Në Molise, shkalla e rritjes së GDP-së reale ishte -10,8% në periudhën 2008–2012. Në vitin 2012, shkalla e rritjes së GDP-së ishte ende në nivele të dobëta: -2.5%. GDP-ja ishte e barabartë me 17.337 € për frymë në vitin 2012. Ka pasur një rënie rreth 8.6% që nga viti 2008. (Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Ndërmarrjeve dhe Industrisë, Regional Innovation Monitor Plus)

Në Shqipëri, rritja ekonomike u ngadalësua në 1.6% në vitin 2012 nga 3.1% një vit më parë. Kufizimet financiare, besimi i ulët në mesin e investitorëve dhe kriza globale ndikoi në ekonomi. Shqipëria përjetoi një ngadalësim më 2012-n për shkak të investimeve të brendshme të dobëta private. Pavarësisht nga fakti se viti 2013 shënoi performancën më të ulët ekonomike të Shqipërisë në 10 vitet e fundit, ku ende rritja e GDP-së u vlerësua me 0.7%. Dobësia ekonomike ishte rezultat i kërkesës së brendshme të dobët agregate, shkaktuar nga reduktimi i remitancave për shkak të gjendjes së dobët ekonomike në Greqi dhe Itali, por edhe prej uljes së të ardhurave të buxhetit të qeverisë dhe si rrjedhim investime më të pakta publike në infrastrukturë dhe sektorë të tjerë të rëndësishëm. (Burimi: INSTAT)

GDP-ja e Malit të Zi për frymë më 2013-n ishte 5,356 EUR, kurse më 2012-n llogaritej në 5,074 EUR. Rritja e GDP-së reale më 2013-n ishte 3.3%. Pas dy vitesh rritje të moderuar, ekonomia hyri në recesion në vitin 2012 me vështirësi për të tërhequr investimet e huaja të nevojshme për riaktivizimin e saj. GDP-ja reale e kontraktuar me 2.5%, pësoi rënie nga performanca e dobët në industri, ndërtim, transport, shërbime financiare dhe bujqësi.

Ekonomia e Zonës së Programit është kryesisht ekonomi e bazuar në shërbime. Sektori terciar është dominues. Sektori i turizmit përbën një element të rëndësishëm në ekonomi, në aspektin e vlerës absolute, vlerës së shtuar bruto (VSHB) dhe punësimit. Më e rëndësishmja, ajo ofron një mundësi për rritje ekonomike në të ardhmen dhe ribalancim të ekonomisë. Pjesa e sektorit primar është e ulët në krahasim me dy sektorët e tjerë të VSHB-së së zonës së Programit, por mbeten të rëndësishëm të dy si një burim punësimi dhe të ardhurash, veçanërisht në zonat rurale.

Sektori i shërbimeve dominon ekonominë e Pulias, megjithëse bujqësia është shumë e rëndësishme, duke përbërë prirje kombëtare. Pulia prodhon 23.1% të vlerës së shtuar në sektorin bujqësor të jugut të Italisë dhe 9.5% në nivel kombëtar.

Në Molise, analiza e vlerës së shtuar me çmimet aktuale, gjithashtu, tregon një rritje të peshës së sektorit primar në përcaktimin e rezultatit të përgjithshëm të ekonomisë rajonale: në vitin 2011 rezultoi 4.4%. Sektori i shërbimeve regjistron një rritje më të rëndësishme, deri në 71.1% në vitin 2011.

Në Shqipëri, për sa i përket strukturës së GDP-së, 50% e vlerës së shtuar në ekonominë shqiptare në vitin 2013 erdhi nga sektori i shërbimeve. Megjithatë, bujqësia mbetet një nga sektorët më të mëdhenj dhe më të rëndësishëm me shumë zhvillime dinamike. Ajo përbën rreth 20% të GDP-së, ndërsa llogaritet se përbën rreth gjysmën e punësimit total. Sektori bujqësor i Shqipërisë vazhdon të përballë me një sërë sfidash, duke përfshirë përmasat e vogla të fermave dhe fragmentimin e tokës, kufizimet e tregut për shkak të konkurrencës nga Greqia dhe Italia, aksesit të kufizuar për kredi dhe grante dhe institucioneve të papërshtatshme rurale.

Në Mal të Zi, numri i shërbimeve që kontribuon në GDP vlerësohet të rritet nga 69% që ishte më 2010-n në 77% më 2016-n. Sektorët kryesorë të ekonomisë po kthehen gjithnjë e më tepër turizmi dhe bujqësia,

së bashku me sektorin tashmë të fuqishëm të energjisë. Bujqësia (karakterizohet nga një numër i madh i fermave të vogla) është përgjegjëse për 7.4%, industria dhe minierat 5.4%, ndërtimi 4.6% dhe transporti 4.1% të vlerës së shtuar. Kompanitë në sektorin e arteve, aktivitetëve të kohës së lirë dhe argëtimit u llogaritën për 2% të vlerës së shtuar bruto më 2012-n. (Burimi: Monstat)

TREGU I PUNËS DHE PUNËSIMI

Kushtet në tregun e punës të të gjithë Zonës së Programit janë në gjendje kritike. Shkalla e papunësisë është mbi dyfishin e shkallës së 28 vendeve të BE-së (10.8%). Pabarazitë, gjithashtu, janë të dukshme për sa i përket moshës dhe gjinisë. Shkalla e papunësisë së të rinjve është veçanërisht e lartë. Shkalla e papunësisë së femrave është, gjithashtu, e lartë dhe ndjek të njëjtën linjë në të gjitha vendet e rajonit, duke reflektuar integrim në nivel të ulët të femrave në tregun e punës. Migrimi i brendshëm dhe sektori informal përbëjnë aspektet strukturore të papunësisë në të gjithë Zonën e Programit.

Në Pulia, papunësia është kryesisht e përqendruar në shërbime (përfshirë administratën publike), një sektor që mbulon 66% të të punësuarve; të dhënat janë më të ulëta për industrinë (25.4%) dhe bujqësinë (8.5%). Shkalla e papunësisë ruajti ritmin e 23% më 2013-n. Të punësuarit janë kryesisht meshkuj. Është e rëndësishme të theksohen prirjet pozitive të raporteve të të dhënave për 2012-n, që prej 2010-s në punësimin e femrave. Gjatë 5 viteve të fundit është shënuar rritje e konsiderueshme e nivelit të imigrimit ku historikisht Pulia ka pasur nivel të lartë të imigrimit. Një tjetër fenomen i rëndësishëm është pajtimi nëpërmjet “grupeve” të specializuara të punëtorëve, të cilët në mënyrë periodike zhvendosen në veri të Italisë për të punuar si të kontraktuar për firma të mëdha ndërtimi. (Burimi: EURES- Portali European për Punëkërkuesit).

Rajoni i Molise ka një shkallë punësimi të barabartë me 54.7% (20–64 vjeç) për periudhën 2010–2012. Ajo mban vendin e 16-të ndër rajonet italiane dhe të parin ndër rajonet e Italisë Jugore. Trendet negative në dinamikën e punësimit nisën pas 2008-s. Shkalla e punësimit të të rinjve (mosha 15–24) më 2011–2012 u rrit nga 28.6% në 41.9%. Është e rëndësishme të theksohet se humbjet më të mëdha në forcë punëtore goditën forcën punëtore më pak të kualifikuar gjatë 2007–2010.

Rritja ekonomike e regjistruar në dekadën e fundit në Shqipëri nuk është shumë e dukshme në nivelet e punësimit formal. Më 2007-n, anketimi i forcës së parë të punës regjistroi një shkallë punësimi prej 56.4%. Shkalla e regjistruar e papunësisë më 2013-n mbeti në nivelin 13% mesatarisht, me një rënie të lehtë nga 13.4% nga 2011. Tregu i punës në Shqipëri ndikohet nga shumë faktorë, si për shembull, shkalla e lartë e pjesëmarrjes së të rinjve në arsimim. Anketa e forcës së punës (AFP) më 2012-n tregoi një shkallë pjesëmarrjeje në punë prej 65.5% (74.3% për meshkuj dhe 56.6% për femra). Tregu i punës karakterizohet nga pjesëmarrje e lartë e të vetëpunësuarve duke reflektuar shpirtin e sipërmarrjes së popullsisë. Ekonomia informate mbetet një ofrues pune i rëndësishëm dhe punësimi i fëmijëve mbetet një sfidë e madhe. (Burimi: INSTAT)

Në Mal të Zi vërehet kalimi nga ekonomi industrie në ekonomi shërbimesh. Më 2012-n, afërsisht 76% e punëtorëve u punësuan në shërbime dhe 18% në industri. Numri i përgjithshëm i të punësuarve sipas MONSTAT-it më 2013-n ishte 171,474. Më 2013-n, sektori i tregtisë punësoi shumicën e forcës punëtore (21.8%) e ndjekur nga sektori publik (12%). Vetëm 2.54% e forcës punëtore të përgjithshme është e punësuar në bujqësi (në Zonën e Programit, 1.53% të numrit të popullsisë në punë).

Në Mal të Zi, papunësia ishte e lartë, 19.1% për tremujorin e parë të 2014-s dhe nuk ka ndryshuar që prej 2010-s. Pabarazitë rajonale janë të mëdha. Në rajonet bregdetare dhe qendrore, shkalla e papunësisë është 10% dhe 15.6% përkatësisht, por rritet në 36.7% në pjesën veriore të Malit të Zi. Papunësia prek veçanërisht të rinjtë (12-24 vjeç) dhe papunësinë afatgjatë. Procesi i ngadaltë i krijimit të vendeve të punës është shoqëruar nga prirje jo të favorshme të migrameve dhe procesit të vazhdueshëm të “emigrimit të trurit”. Në migrimin e brendshëm nga veriu më pak i zhvilluar drejt qendrës më të zhvilluar dhe zonave bregdetare, rajoni verior ka humbur 9.34% të popullsisë që prej 2007-s deri më 2012-n.

ARSIMI

Arsimi është një ndër mjetet më të rëndësishme për luftimin e varfërisë. Qëllimi i BE-së është të përmirësojë cilësinë dhe efikasitetin e arsimit dhe trajnimeve nëpërmjet reduktimit të shkallës së braktisjes së shkollave në më pak se 10% dhe nëpërmjet rritjes së numrit të personave që ndjekin arsimin e lartë në më pak se 40%. Rajonet italiane pjesëmarrëse kanë ende punë për arritjen e këtyre qëllimeve, por situata po përmirësohet gjatë dekadës së fundit. 2 vendet IPA vuajnë në fushën e arsimit profesional, i cili shpesh nuk ofron aftësitë e nevojshme dhe përgatitjen e duhur për të konkurruar në tregun e punës. Lidhjet mes

institucioneve arsimore dhe sektorit të biznesit kanë prirjen të ulen dhe të rezultojnë në aktivitete të pakta inovacioni, kërkimi shkencor dhe zhvillimi.

Në Itali, arsimi alokon 4.29% të GDP-së. Sfera e arsimit në Pulia shënon rezultate të mira pavarësisht performancës relativisht të ulët të rajonit lidhur me mesataren italiane. Gjithsesi, shkalla e braktisjes së shkollës mbetet e lartë (19.9% më 2013-n), mbi mesataren italiane prej 17%, ku 20% e të rinjve të moshës 18-24 vjeç braktisin shkollën. (Burimi: MIUR)

Molise mban vendin e gjashtë në Itali lidhur me arsimin dhe trajnimin e të rinjve të moshës 15-19 vjeç. Molise është larg traqetit të EU 2020 (40% e popullsisë së rajonit të moshës 30-34 me arsim të lartë); indeksi i atraksionit në universitete shënoi një trend negativ më 2012-n (-26%), kurse numri i popullsisë të moshës 18-24 vjeç pa arsim është më i ulët se 20%. (Burimi: MIUR).

Mali i Zi alokon afërsisht 4.5% të GDP-së së saj për arsimin (2010). Sistemi i saj i arsimit është relativisht i zhvilluar. Më pak se 2% e banorëve janë analfabetë. Shkollat e arsimit të mesëm gjenden në çdo qytet. Sistemi i arsimit të lartë përbëhet nga një universitet publik, 2 universitete private dhe shtatë fakultete individuale private. 70% e personave që përfundojnë arsimin e mesëm regjistrohen në institucione të arsimit të lartë. Cilësia e arsimit në shkolla dhe universitete ka nevojë për përmirësime. Përveç kësaj, ka një mospërputhje midis diplomave që lëshohen dhe tregut të punës por, vendi ka filluar të trajtojë prioritetet e tij në këtë fushë.

Në Shqipëri, arsimi konsiderohet fushë prioritare. Gjatë viteve të fundit, shpenzimet në arsimin publik nuk e kalojnë 3% të GDP-së, por, ndërsa këto të dhëna nuk përfshijnë stimujt privatë, të cilët kanë hyrë në fushë. Ndryshe nga arsimi i përgjithshëm, arsimi profesional ka regjistruar një trend rënieje kërkesë. Numri i studentëve të regjistruar në institucione të arsimit profesional ra me rreth 38% gjatë periudhës 2006–2011, për shkak të zhvendosjes në institucione të ciklit të tretë të studimeve. Arsimi profesional konsiderohet si e dyta më e mira pas arsimit të lartë dhe jo si një mënyrë për të hyrë në tregun e punës. Mundësitë për mësim gjatë gjithë jetës dhe mundësitë për personat e larguar nga punonjësit e arsimit dhe ata të pakualifikuar mirë për të rritur kompetencat për punë janë ende të limituara në sasi dhe cilësi.

SHËNDETËSIA

Shëndetësia në fushën e programit përfaqëson një sektor në të cilin duhet të arrihet progres i madh. Rajonet italiane janë ndër më pak të përparuarat krahasuar me mesataren italiane me përqindje të lartë karakteristike të zhvendosjeve të spitaleve për shërim. Në shtetet anëtare në IPA, përpjekje domethënëse po kryhen për përafrimin e politikave shëndetësore me standardet e BE-së. Gjithsesi, qëllimet ambicioze kufizohen nga niveli i ulët i shpenzimeve publike. Shpenzimet publike për shëndetësinë janë të vogla në hapësirën e programit (Mali i Zi shënon nivelin më të lartë me 9012% të GDP-së, ndjekur nga Italia me 7.2% dhe Shqipëria me 2.8%). (Burimi: Shëndetësia 2020 si një kuadër për krijimin e lidhjes mes shëndetësisë dhe përvojës së sektorëve të tjerë të Malit të Zi, korrik 2014)

Rajoni i Pulias ende klasifikohet si një ndër më pak të zhvilluarit në Itali. Shërbimet e tij publike shëndetësore janë të organizuara në gjashtë autoritete lokale, dy qendra shëndetësore dhe dy institute kërkimore me një numër të përgjithshëm force pune prej 40 000 profesionistësh. Numri total i klinikave dhe i spitaleve të përgjithshme është 660. Transferimi nga spitali në terma të transferimeve për shërim llogaritet 7.3%, ndërsa strukturat ekzistuese pritëse të dedikuara janë 1200. Përmirësimi i cilësisë dhe qasjes së shërbimeve, veçanërisht në zonat rurale, përmirësimi i infrastrukturës dhe zbatimi i plotë i pajisjeve shëndetësore për menaxhimin e politikave socio-sanitare janë disa nga qëllimet kryesore për periudhën e programit 2014–2020. (Burimi: ISTAT)

Rajoni i Molisë përbëhet nga 58 klinika dhe spitale të përgjithshme. Një problem specifik duket të jetë transferimi në spitale, që nënkupton transferimin për shërim. Në fakt, përqindja lidhur me të më 2012-n ishte 20.8, e cila përbën dhe nivelin më të lartë ndër rajonet e Adriatikut. Për më tepër, Molisë klasifikohet si “rajon tranzicioni” lidhur me fëmijët e moshës 0–3 vjeç, nën kujdesin e shërbimeve të fëmijërisë e që ndajnë vështirësitë socio-sanitare me pjesën tjetër të Italisë Jugore, mesatarja e të cilës në këtë kategori të veçantë arrin 5% kundrejt 17.9% të Italisë Veriore. IDEA-ja, për personat mbi 65 vjeç, është e barabartë me 3.9%. (Burimi: ISTAT)

Në Shqipëri, sistemi i shëndetësisë është i bashkuar me shërbimet shëndetësore publike dhe private. Spitalet private ofrojnë shërbim më të mirë, kurse në spitalet publike mbeten ende disa probleme të shkurtimeve nga puna për shkak të nivelit të lartë të borxhit të grumbulluar nga entitetet publike dhe shpërndarjes së pabarabartë të shërbimeve shëndetësore në spitale. Progres raporti i KE-së më 2013-n

theksoi se “Kujdesi shëndetësor primar ka mangësi fondesh dhe burimesh njerëzore. Mbulimi i kujdesit sipas sigurimeve mbetet ende shumë i ulët. Sektori i spitalit publik mbetet i pazhvilluar, kurse sektori privat po zhvillohet pa rregullat të sakta”. Gjithsesi, përveç problemeve dhe shkurtimeve në sistemin shqiptar të shëndetësisë, jetëgjatësia në lindje është ndër më të lartat në rajon me 77 vite, krahasuar me Malin e Zi me 75 vite dhe Italinë me 83 vite.

Në Mal të Zi, kujdesi primar shëndetësor ofrohet në nivel bashkie (18 qendra mjekësore dhe tri stacione shëndetësore). Kujdesi sekondar shëndetësor ofrohet nëpërmjet shtatë spitaleve të përgjithshme, tri spitaleve të specializuara, një qendër klinike, një institut për mjekësinë fizike, rehabilitimin dhe reumatologjinë “Dr. Simo Milošević” AD Igalo dhe pesë struktura të përhershme. Strategjia e qeverisë “Politikat Shëndetësore në Malin e Zi deri më 2020-n” ka për synim të integrojë sistemin shëndetësor të Malit të Zi me procesin e zhvillimit të shëndetësisë evropiane dhe globale.

Për sa i përket jetëgjatësisë, ajo është rritur gjatë 10 viteve të fundit në të tria shtetet. Gjithsesi, Italia ka mesatare më të madhe të jetëgjatësisë me 79.7 vite, kurse në Shqipëri është 2.2 vite më pak (77.5 vite) dhe Mal të Zi 76.1 vite.

Për më tepër, vdekshmëria foshnjore ka shënuar rënie përgjatë viteve, por në Shqipëri mbetet në nivele të larta, duke arritur 8.7 foshnje për 1000 lindje, ndërsa në Mal të Zi dhe Itali është pothuajse përgjysmë, përkatësisht 4.4 dhe 3.1.

Nëpërmjet bashkëpunimit ndërkufitar, rajonet e Italisë mund të krijojnë rrjete transnacionale të ofruesve të kujdesit shëndetësor dhe të përgatisë masa për menaxhimin e transferimeve në spitale (p.sh. sipas Rregullores (KE) nr. 883/2004 “Për transferimin e pacientëve që vuajnë nga sëmundje të rralla në spitale të shteteve të tjera anëtare”, kurse Shqipëria dhe Mali i Zi mund të përforcojnë kapacitetet për transpozimin e direktivës së BE-së 2011/24 në vendet e tyre. I gjithë territori mund të kontribuojë në përmirësimin e sigurisë, cilësisë dhe efikasitetit të sistemeve ekzistuese shëndetësore, të përfitojnë nga mobilizimi i ekspertizës dhe të kenë akses në shërbime shëndetësore të specializuara.

1.1.1.4 KËRKIMI SHKENCOR, INOVA-CIONI DHE KONKURRENCA E SME-ve

Inovacioni i SME-ve është një nga nxitësit kryesorë të konkurrencës. Fusha e programit qëndron pas ekonomisë evropiane në terma të zhvillimit ekonomik dhe masave qartësisht të nevojshme mbështetëse. Sistemi i saj i inovacionit është i dobët, i karakterizuar nga investime të pakta R&D, nivel të ulët të punësimit në sektorët e teknologjisë së lartë, numër i vogël patentash, rrjete të pamjaftueshme bashkëpunimi, mangësi të internacionalizimit të SME-ve dhe bashkëpunim i papërshtatshëm mes SME-ve, organizatave mbështetëse të biznesit dhe qendrave kërkimore. Këto kushte bëhen më kritike nga kriza ekonomike dhe borxhi, të cilat ndikojnë në ekonominë kombëtare të shteteve pjesëmarrëse. Më specifikisht, karakteristikat e performancës së konkurrencës dhe inovacionit të fushës së programit përmbledhen si më poshtë vijon:

Rajonet italiane të Pulias dhe Molisës alokojnë një pjesë shumë të vogël të GDP-së në RTD (GERD) krahasuar me mesataren e Italisë dhe të BE-së; Po ashtu aksionet e biznesit në GERD janë më të vogla se mesatarja e BE-së;

Niveli i aplikimeve të patentave në dy të rajonet është shumë i vogël; Italia, gjithashtu, shënon nivel më të ulët se mesatarja e BE-së;

Pulia ka shkallë të ulët punësimi në sektorët e teknologjisë së lartë; Po ashtu, Italia është nën nivelin mesatar të BE-së; E njëjta situatë është edhe për punësimin në shërbimet e njohurive të vazhdueshme.

Numri i studiuesve dhe numri i përgjithshëm i personelit të R&D është më i ulët se mesatarja e Italisë dhe BE-së; treguesit në arsim, gjithashtu, mbeten prapa.

Performanca e konkurrencës së SME-ve në Itali mbetet nën mesataren e përgjithshme të BE-së; Investimet janë në mesataren e BE-së.

Rajonet e ligjshme të Italisë kanë profile më të ndryshme (nga “rajonet me teknologji të pazhvilluar” në “rajone me teknologji të zhvilluar” dhe “rajone të industrializuara” dhe nga “rajone të kërkimit intensiv” në “rajone pa specializim në aktivitete të dijeve”).

Vëzhgimet e mëposhtme kryesore (përfundime që rrjedhin nga “Përmbledhje e Bankës Botërore për sektorët e kërkimit shkencor dhe inovacionit në Ballkanin Perëndimor”, 2013) mund të bëhen për Shqipërinë dhe Malin e Zi:

Performanca e ulët shkencore, si rezultat i furnizimit të pamjaftueshëm të kontributit - burimeve njerëzore, financimi i kërkimeve dhe objektet; megjithatë performanca shkencore po tregon shenja përmirësimi;

Emigrimi i trurit, për shembull, në Shqipëri, më shumë se 50% e lektorëve dhe kërkuesve emigruan gjatë viteve 1991–2005;

Vjetrimi dhe amortizimi i infrastrukturës kërkimore; shpërndarje e dobët në të gjitha institucionet;

Aktiviteti i ulët i patentimeve; menaxhimi i papërshtatshëm i pronësisë intelektuale (PI);

Mekanizma joefikasë për transferimin e teknologjisë dhe komercializimin e rezultateve të hulumtimit;

Mungesa e lidhjeve të ndërveprimeve industri - shkencë; bashkëpunimet *ad hoc* pa strategji afatgjatë;

Bizneset tregojnë pak interes për të investuar në kërkime shkencore dhe inovacion; rënie të tendencave në punësimin e studiuesve nga sektori i biznesit;

Mungon kuadri ligjor për menaxhimin e pronës intelektuale; mungojnë reformat për të lehtësuar zbatimin e kontratave, konkurrencën, qasjen në financa dhe rregullimin e tregut të punës;

Ristrukturimi dhe konsolidimi i organizatave kërkimore publike mbetet i papërfunduar.

SFIDAT RAJONALE TË INOVACIONIT

Pulia mund të nxisë një sistem të rëndësishëm industrial. E pozicionuar rreth zonës së madhe industriale të Barit, Brindizit dhe Tarantos, por edhe me pozitën e rëndësishme në Salento, plantacione bimore dhe plantacione të mëdha prodhimi operojnë në fushën e hekurit dhe çelikut, kimikate themelore dhe kauçukut, qelqit, energjisë, automotive, hapësirë ajrore, përpunimit të ushqimit, TIK dhe materialeve të ndërtimit. Pranë tyre gjenden qendra të vogla industriale nëpër qytete të ndryshme. Sistemi rajonal i R&D është i përbërë nga pesë (5) universitete (4 shtetërore, një privat) dhe Zyrat e tyre të Ndërlidhjes Industriale (ILO), qendrat kërkimore publike dhe private, nga parqet teknologjike të “Technopolis” Valenzano dhe “Qyteti i kërkimeve shkencore” në Brindisi dhe rrethe të tjera teknologjike. Pula ka qenë e përfshirë në sektorin e aeronautikës që prej 1934-s. Investimet e vazhdueshme në kërkime dhe zhvillime kanë kthyer Pulian në një qendër të përsosmërisë në sektorin e hapësirës, e cila zotëron një nga përqendrimet më të mëdha industriale të firmave të hapësirës ajrore në Itali dhe ku kompani të shumta kanë lehtësira prodhimi si shteti i artit. Në vitet e fundit, sektori i hapësirës ajrore ka shënuar rritje të ndjeshme. SME-të u përfshinë në një xhiro vjetore prej 1 miliardë eurosh dhe punësuan rreth 6 000 njerëz - nganjëherë të rekrutuar direkt nga universiteti.

4 EURISY: http://www.eurisy.org/article-smes-in-the-Pulian-space_8#sthash.b2en0hCV.dpuf

Një grup aeronautik është përqendruar në Pulia dhe përfshin ndërmarrjet e mëdha dhe të vogla, shumica e të cilave gjenden në provincën e Brindisit. Është e rëndësishme të theksohet se Pulia është rajoni i vetëm që kryen specializime të ndryshme biznesi: “me krahë fiksë” (Alenia), “me krahë rrotullues” (Agusta Westland), forcë shtytëse dhe programe të hapësirës ajrore (Space Software Italia).

Kërkimi aero-hapësinor është kryer në Universitetin e Barit, te Politekniku i Barit dhe Universiteti i Salentos, si dhe në qendrat kërkimore, të tilla si: CETMA, ENEA, CNR-IMM, CNR-Issia dhe Consorzio OPTEL. Duke pasur parasysh se shumica e kërkimit lidhur me grupin aero-hapësinor mbulon në mënyrë indirekte edhe fusha të tjera, ARTI (Agjencia Rajonale për Teknologjinë dhe Inovacionin) vlerëson se rreth 500 studiues janë të përfshirë në mënyrë direkte ose indirekte në aktivitetet kërkimore që lidhen me sektorin aero-hapësinor. 300 prej tyre janë të punësuar nga universitetet (200 në Universitetin e Barit dhe 100 në Universitetin e Leçës) dhe mbi 200 janë punësuar nga qendrat kërkimore, të përqendruara kryesisht në provincën e Brindizit.

Në vitet e fundit, Pulia ka promovuar fuqishëm një politikë grupimi. Aktualisht janë 18 grupe me orientim tematik. Mëdis tyre, grupi “Creative Pulia” bashkon 302 partnerët privatë dhe publikë (kompani, fondacione, konsorciume dhe shoqata, si dhe sindikata, qendra për arsim profesional dhe kërkim shkencor, shoqata të industrisë, përfaqësues artizanale dhe të tregut). Sektorët kulturorë përfaqësohen gjerësisht: art vizual, audiovizuale, kërcim, muzikë, multimedia, dizajn etj.).

Sektorët kulturorë dhe kreativë janë burim i rëndësishëm strategjik për Pulian, e cila regjistron rezultate të rëndësishme:

- Rritje të kërkesës për produktet kulturore dhe kreative: të gjitha industritë kulturore dhe kreative kanë regjistruar shtim të audiencës dhe konsumatorëve, mbi mesataret kombëtare. Në mënyrë të veçantë, për sa u përket kinemave dhe eventeve direkte zbavitëse, për periudhën 2008–2010, Pulia regjistroi:

- më shumë evente (+44%, nga 94,215 në 136,345);

- më shumë spektatorë (+26% nga 7.9 mln për 10 mln);

- më shumë bileta (+43%, nga 943,000 për 1.350.000);

- rritje të kërkesës në turizëm (+23% gjatë periudhës 2002–2012);

- zgjerim të rrjeteve kulturore dhe kreative: mbi 200 fusha të reja publike.

Në Pulia ndodhen edhe selitë e të gjitha qendrave të mëdha kërkimore publike. Përveç sistemit të rrjeteve të laboratorëve publikë, Pulia zë një vend të rëndësishëm në kuadrin e infra-strukturës kërkimore evropiane. Vlen të përmendet IAM- Instituti Bujqësor i Mesdheut në Bari, Qendra Ndërkombëtare për Studime të Avancuara në Bujqësi në Mesdhe, Qendra Mesdhetare për Ndryshimet Klimatike (QMNK) dhe infrastruktura ESFRI për biodiversitetin.

Disa konsorciume kërkimi gjenden, gjithashtu, në rajon, të tilla si: Qendra Kërkimore Bonomo, CETMA, OPTEL, ISBEM dhe Qendra Laser, të cilat kanë një pjesëmarrje të madhe publike.

Analiza e veprimtarisë së patentës në rajonin e Pulias në periudhën 1980–2011 thekson dominimin e makrosektorëve “mekanikë” dhe “kimikë”. Pothuajse 40 dhe 19% e patentave në këto dy sektorë janë regjistruar përkatësisht nga Pulia në vitet 1978–2010.

5 ARTI: <http://www.arti.Pulia.it/index.php?id=169&L=1>

6 Të dhënat statistikore janë marrë nga prezantimi “Kultura dhe kreativiteti në APULIA”, Labororët APuliane të TIK të 10 qershorit 2013.

Megjithatë, pavarësisht progresit në aspektin e kapacitetit të inovacionit dhe rritjes së ndërgjegjësimit mbi çështjet e inovacionit në politikëbërjen rajonale, Pulia mbetet një nga rajonet më pak novatore në Itali (EU Regional Innovation Monitor Plus). Në Molise, sistemi rajonal i inovacionit është i brishtë dhe karakterizohet nga investime të pakta nga R&D. Të gjithë treguesit paraqesin kapacitetin shumë të kufizuar të inovacionit në lidhje me të dyja rajonet e Italisë, Veriqendrore dhe Jugore. Më 2011-n, shpenzimet e përgjithshme të R&D përbënin 0.42% të GDP-së, shumë më e ulët se mesatarja kombëtare (1.25%).

Pjesa e SME-ve që prezantojnë produkte të inovacionit apo procese ishte 16.4% më 2010-n (viti i fundit për të cilit disponojmë të dhëna), sa gjysma e mesatares italiane. Këto të dhëna tregojnë konkurrencën e dobët dhe fragmentimin e industrisë vendase. Për më tepër, sistemi inovacionit ndikohet, gjithashtu, edhe nga mungesa e bashkëpunimit mes të kërimit publik dhe biznesit, si dhe nga dobësitë e organizatave lokale, të cilat sigurojnë transferimin e teknologjisë dhe të shërbimeve të biznesit.

Pamjaftueshmëria e infrastrukturës rajonale teknologjike (zhvillim të vakët të rrjeteve me brez të gjerë dhe mjeteve logjistike, si dhe niveli i ulët i shpërndarjes TIK janë faktorë të tjerë kufizues që pengojnë zhvillimin e një mjedisi miqësor me inovacionin.

Sipas Raportit të Konkurrueshmërisë Globale 2013–2014 i Forumit Ekonomik Botëror, Indeksi Global i Konkurrueshmërisë për Shqipërinë është 3.8, ndërsa faktori inovacionit dhe sofistikimit është vetëm 3.1. Janë duke u bërë përpjekje për të stimuluar inovacionin dhe për të forcuar kapitalin njerëzor. Buxheti kombëtar për kërkimin është rritur pak, por niveli i investimeve në kërkim dhe zhvillim teknologjik është ende i ulët. Niveli i investimeve në kërkim si pjesë e GDP-së vlerësohet rreth 0.35%, por kjo shifër nuk përfshin kontributin e sektorit privat (universitetet private, SME-të), pavarësisht nga fakti se ajo është e kufizuar. Sektori privat mbetet dominues dhe ende përbën rreth 80% të GDP-së. Regjistrimi dhe licencimi i biznesit po kryhet me sukses nëpërmjet rrjetit të krijuar të shërbimeve me një ndalesë (one-stop shop). Në vitin 2012, numri i bizneseve të reja të regjistruara u rrit me 8% nga viti në vit; Ato përbëjnë 12% të gjitha ndërmarrjeve aktive. SME-të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në ekonominë shqiptare, duke siguruar 71% të punësimit zyrtar, 90% e ndërmarrjeve aktive në Shqipëri janë ndërmarrjet mikro (1–4 të punësuar), nga të cilat 87% veprojnë në sektorin e shërbimeve.

Politika për inovacion e Malit të Zi fokusohet kryesisht në kërkimin shkencor, për një shoqëri të bazuar në njohuri dhe për të rritur konkurrueshmërinë e saj ekonomike. Sipas Raportit Global të Konkurrueshmërisë 2013–2014, Indeksi Global i Konkurrueshmërisë për Malin e Zi është 4.2, ndërsa i inovacionit dhe sofistikimit është vetëm 3.6. Niveli i investimeve në kërkim, rritur nga 0.13% në vitin 2010 në 0.43% të GDP-së në vitin 2012. Rreth tre të pestat e hendekut të 1.62 për qind në financimet për R&D (GERD) ndërmjet Malit të Zi dhe BE-së mund të gjurmohen në shpenzime jashtëzakonisht të ulëta të sektorit privat, ndërsa pjesa e mbetur 40% është për shkak të performancës së papërshtatshme të sektorit publik. Sektori privat në Mal të Zi kontribuon 27% të GERD. Megjithatë, shpenzimet e buxhetit të shtetit për R&D si pjesë e shpenzimeve të përgjithshme totale të qeverisë janë rritur nga 0.20 për qind në vitin 2008 në 0.27 për qind në vitin 2010. Plani është për të rritur nivelin e investimeve në kërkime në 1.4% në vitin 2016. (Burimi: Ministria e Shkencës)

Komercializimi i kërimit dhe shpenzimet e sektorit privat në R&D janë penguar nga kapacitete

teknologjike të dobëta. Rezultatet e anketës së R&D për vitin 2011 tregojnë se personeli prej 2303 personash u angazhuan në punë për R&D atë vit, nga të cilët 1,699 ishin kërkues. Përafërsisht 65% e të punësuarve në institucione R&D punojnë në Universitetin e Malit të Zi. (Burimi: MONSTAT)

Mali i Zi ka krijuar së fundi parkun e vet të shkencës dhe teknologjisë dhe ka ndërmarrë disa masa në përputhje me Unionin e Inovacionit, Zonën Evropiane të Kërkimit për të forcuar ngritjen e kapaciteteve. Në vitin 2012, Mali i Zi ndryshoi Strategjinë për veprimtari kërkimore shkencore 2012–2016, duke i dhënë rëndësi më të madhe kërkimit zhvillimor dhe prezantimin e instrumenteve të reja për të sjellë fonde kombëtare kërkimore më shumë në përputhje me prioritetet kërkimore të BE-së. Më 1 qershor 2014, një qendër e parë e përsosmërisë me emër Bio-TIK u themelua në bioinformatikë.

Mali i Zi ka potencial të infrastrukturës kërkimore në fushat: a) shkencat biomjekësore dhe të jetës; b) teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK); dhe c) shkenca e materialeve. (Burimi: STRATEGJIA PËR BALLKANIN PERËNDIMOR RAJONAL R&D PËR INOVACION, BB, 2013)

SME- të kontribuojnë rreth 60% të GDP-së së Malit të Zi. Ata përbëjnë rreth 99% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve dhe shpërndarja e tyre në punësimin e përgjithshëm është rreth 67%. Mbështetja e sektorit publik për SME-të është larg nga optimalja. Shumica e SME-ve kanë mangësi në përvojë menaxhuese dhe të marketingut.

Shërbimet mbështetëse të biznesit (qendra biznesi, inkubatorët e biznesit, shërbime këshilluese të biznesit etj.) për të ndihmuar ata në rritjen e performancës dhe forcimit të konkurrencës, nuk janë shumë të zhvilluara. Për më tepër, profesioni këshillues biznesi dhe tradita e përdorimit të shërbimeve të saj është ende në fazat e para të zhvillimit në Mal të Zi. Kufizimet e tjera përfshijnë ekzistencën e barrierave të biznesit dhe qasjen joadekuate në financa. Këto dekurajojnë iniciativat për nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar dhe krijimin e llojeve të ndryshme të grupeve të biznesit dhe lidhje të integruara vertikalisht të kompanisë. Deri më tani, për shembull, nga 63 grupime të mundshme biznesi të identifikuar, vetëm 4 janë krijuar për përpunim metali, peshkim në ujë, prodhim të verës dhe të vajit të ullirit. Si pasojë, duhet të shqyrtohen të gjitha mundësitë për të reduktuar barrierat në biznes dhe për të krijuar një mjedis më miqësor me biznesin për bashkëpunim ndërkufitar.

Dokumenti Strategjik Indikativ për Malin e Zi 2014–2020 përcakton si prioritet zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të konkurrencës industriale dhe zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme administrative për të siguruar zbatimin e duhur të tij.

1.1.1.5 ATRAKTIVITETET TERRITORIALE: TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE

TURIZMI SI MOTOR ZHVILLIMI

Zona e Programit është një rajon evropian me kultura të ndryshme që ka trashëgimi unike kulturore/historike, peizazhet tërheqëse natyrore dhe traditat e vjetra të kuzhinës, të cilat ofrojnë një shumëllojshmëri të produkteve eno-gastronomike dhe popullore artizanale. Prandaj turizmi është një nga motorët e rëndësishëm të ekonomisë së Zonës së Programit, në vlerë absolute, vlerë të shtuar bruto (VSHB) dhe punësim. Megjithatë, Zona karakterizohet nga sinergjitë joefikase ndërkufitare territoriale, kërkesa e turizmit sezonal, mungesa e reputacionit të markës, mungesa e strategjive të qëndrueshme të promovimit të identitetit dhe vështirësitë në qasje. Për më tepër, zhvillimi i saj ekonomik është komprometuar veçanërisht nga mungesa e instrumenteve të planifikimit për trashëgiminë kulturore dhe natyrore inteligjente dhe të qëndrueshme, së bashku me mungesën e njohurive, përvojës dhe aftësive në menaxhimin e destinacionit dhe të marketingut, si dhe mungesa e produkteve të turizmit të diferencuar dhe novatore dhe shërbimet. Në këtë kontekst, Programi paraqet një mundësi për zona për të zhvilluar modele të përbashkëta së bashku për menaxhimin e qëndrueshëm të turizmit në nivel makrorajonal dhe për të promovuar destinacionet më pak të njohura, përmes lidhjeve më të mira me ofertat tradicionale turistike.

Net-qëndrimet gjatë periudhës 2008–2011 në Zonën e Programit ishin rreth katër herë më shumë se mesatarja evropiane për të njëjtën periudhë. Rajonet italiane padyshim tregojnë norma më të larta të turizmit, ndërkohë që Shqipëria shënon nivelin më të lartë të rritjes së turizmit (50% nga viti 2008 deri në vitin 2012). Turizmi ka tendencë të përqendrohet në rajonet bregdetare.

Rajonet italiane përgjatë Adriatikut kanë deri më sot kapacitetin më të madh të akomodimit. Përgjatë shteteve në Zonën e Programit, numri i turistëve në vend (vizita nga jashtë) ndryshon shumë gjerësisht: në vitin 2011, ajo varion nga niveli më i ulët prej 40.9% të numrit total të net qëndrimeve në Itali dhe 44.4% në Shqipëri në nivel të lartë prej 88.8% në Mal të Zi. Mali i Zi kryeson me gjatësinë më të gjatë të net

qëndrimeve në zonë, me një mesatare 6.35 ditë dhe Shqipëria më të ultë, 2.5 ditë.

Kërkesa e turizmit në Pulia mbetet nën mesataren kombëtare. Në Itali, Pulia renditet ndër 5 destinacionet kryesore turistike për kohën e lirë në aspektin e ardhjeve brenda dhe renditet e 7-ta për biznesin e turizmin. Sipas të dhënave rajonale të vitin 2013, janë regjistruar mbi 3.1 milionë mbërritje dhe rreth 13.3 milionë netqëndrime. Kontributi i sektorit të turizmit në GDP është në nivelin e 8% dhe sipas parashikimeve të IPRES-it, prireja është pozitive dhe turizmi do të rezultojë edhe me i rëndësishëm në vitet e ardhshme. Turizmi detar është veçanërisht i rëndësishëm për rajonin: ekzistojnë 64 porte, nga të cilat 46 janë përgjatë Adriatikut dhe 18 përgjatë Jonit, e që presin një numër të përgjithshëm prej 12.703 ankorime anijesh të mbushura plotësisht gjatë verës. (Burimi: Agenzia Pulia Promozione, IPRES)

Molise është rajon shumë sezonal dhe shtrihet përgjatë zonave bregdetare. Vetëm 36.4 shtretër për person janë në dispozicion për çdo 1,000 banorë. Për më tepër, 80% e hoteleve janë të vendosura pranë Campobasso dhe provincës së saj. Sipas të dhënave të UNIONCAMERE (2011), përqindja e ndërmarrjeve turistike të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve ekzistuese në Molise arrin 6%, kundrejt mesatares kombëtare prej 6,6%. Vetëm 4,2% e të punësuarve të rajonit vijnë nga kjo fushë, nën vlerën kombëtare (5,3%).

Operatorët privatë në sektorin e kulturës në Molise përbëjnë 0,5% të ndërmarrjeve kulturore kombëtare. Përqindja e të punësuarve në sektorin e kulturës (1,3%) është nën mesataren e Italisë Jugore (1,6%) dhe nën mesataren kombëtare, gjithashtu (1,7%). Në një këndvështrim, një nga nevojat kryesore të territorit duket të jetë krijimi i rrjeteve mes trashëgimisë kulturore dhe historike dhe peizazheve natyrore. Pra, duket e nevojshme për të përmirësuar - përmes iniciativave të duhura e të përbashkëta të bashkëpunimit ndërkufitar - zonat e lashta rurale, vendet historike dhe thesaret e gjelbra, të cilat mund të përfaqësojnë një model të atraktivitetit në aspektin e jetesës së vërtetë, cilësisë së mjedisit, kohezionit social kundër humbjes demografike. (Burimi: Unioncamere Molise)

Në Shqipëri, zhvillimi i potencialeve turistike të qëndrueshme është identifikuar si sfida kryesore që nga periudha e mëparshme e programimit dhe mbetet një nga prioritetet kryesore strategjike të qeverisë. Me gjithë rritjen e qëndrueshme të udhëtarëve që vijnë gjatë viteve të fundit, numri i udhëtarëve mbetet i ulët në krahasim me vendet fqinje të Greqisë, Malit të Zi dhe Kroacisë. Kapacitetet e strehimit në hotele, të cilat shënuan një rritje të qëndrueshme deri në vitin 2011, kanë pësuar rënie gjatë tri viteve të fundit. Ka ende vend për përmirësim të standardeve të mikpritjes dhe diferencimit të produktit turistike. Ministria e Turizmit është në proces të përgatitjes së Strategjisë së re të Turizmit për periudhën 2014–2020 dhe ka nisur një proces për përgatitjen e Planit Kombëtar Bregdetar Hapësinor dhe shumë projekte ambicioze në mbështetje të turizmit. Qeveria po përmirëson menaxhimin dhe ka miratuar masa më të rrepta ndaj zhvillimit të pakontrolluar dhe ndërtimeve të paligjshme në të gjithë zonën bregdetare.

Turizmi ka qenë në zgjerrim gjatë viteve të fundit në Mal të Zi dhe është bërë industria kryesore e vendit. Përveç bregdetit tërheqës dhe disa qytete në brendësi, vendi ofron burime unike të peizazhit, male, pyje, liqene, lumenj të pastër, ujëra minerale dhe termale, parqe natyrore, biodiversitet, fshatra të vjetra tradicionale dhe trashëgimi të pasur historike dhe kulturore, duke përfshirë një kuzhinë të njohur tradicionale të grupeve të ndryshme etnike. Organizata Kombëtare e Turizmit bazohet në këto cilësi për të promovuar vendin në tregun e turizmit botëror si “Wild Beauty”.

Në Mal të Zi, më 2013-n u regjistruan 1,492,006 ardhje, 3,6% më shumë në krahasim me vitin e paraardhës, 2012, ndërsa net-qëndrimet regjistruan një rritje prej 2,8% nga 2012-a. Net qëndrimet e turistëve vendas përbëjnë 10,6%, ndërsa turistë të huaj përbëjnë 89,4% të gjitha net-qëndrimeve për 2012-n. Sektori i turizmit kontribuon 19,5% të GDP-së. Në vitin 2013 kontributi i drejtpërdrejtë i udhëtimeve dhe turizmit në GDP ruajti vlerën 9,8% të GDP-së totale. (Burimi: Enti i Statistikave Mali i Zi, 2014)

Dobësitë kryesore që pengojnë zhvillimin e turizmit, veçanërisht jashtë qendrave kryesore turistike në bregdet, janë: infrastruktura e papërshtatshme e mikpritjes, kapacitetet e pamjaftueshme për të planifikuar dhe zbatuar programet e zhvillimit të turizmit, menaxhim dhe aftësi marketingu të dobëta, promovimi statik dhe joefektiv i turizmit, mungesa e burimeve financiare, integrim në nivele të ulëta të trashëgimisë kulturore në ofertën turistike, mungesa e shkëmbimit të informacionit brenda industrisë së turizmit, niveli i ulët i bashkëpunimit ndërmjet operatorëve të turizmit dhe sektorë të tjerë, si bujqësia dhe mungesa e produkteve të diferencuara dhe novatore të turizmit dhe shërbimeve që do të përfshinte të gjithë rajonin dhe ta bënte atë më tërheqës për turistët potencialë. Rrjedhimisht, sezoni turistik është i shkurtër dhe një nga sfidat kryesore që promovuesit e saj po përballen është zgjatja përtej muajve të verës duke përllogaritur më shumë se 75%

të ardhjeve të vizitorëve.

(Të dhënat në këtë seksion janë nxjerrë nga Eurostat, ISTAT, MONSTAT)

RUAJTJA DHE MIRËMBAJTJA E BURI-MEVE NATYRORE

Zona e Programit përfshin një grup të gjerë zonash natyrore me vlerë si peizazhe dhe biodiversitet të pasur, ku bëjnë pjesë pyjet, toka bujqësore, zonat malore, rrjedha ujore dhe brigje, shpella dhe gropa karstike me një pamje tipike territoriale. Gjithsesi, siç përmendet dhe më sipër, Zona e Programit karakterizohet nga sinergjitë joefikase territoriale ndërkufitare, kërkesa e turizmit sezonal, mungesa e reputacionit të kompanisë dhe mungesa e strategjive të qëndrueshme për promovimin e imazhit. Për më tepër, është e rëndësishme të theksohet dallimi midis shteteve anëtare të BE-së dhe dy shteteve të IPA-së lidhur me mbrojtjen e burimeve natyrore. Shpërndarja e zonave të mbrojtura të rajoneve italiane dhe Natura-s është shumë më e madhe. Kjo pa dyshim tregon një metodologji të ndryshme në caktimin dhe menaxhimin e këtyre zonave. Është e qartë që të dyja shtetet joanëtare duhet të ngrenë kapacitetet, zbatojnë ligjin dhe koordinim më të mirë pasi një administratë e fortë dhe e mirëpërgatitur në nivel kombëtar dhe vendor është e domosdoshme për zbatimin e acquis. Një planifikim me kujdes zhvillimi që merr parasysh vlerat unike natyrore në nivel ndërkufitar mund të shqyrtohet nëpërmjet këtij Programi Bashkëpunimi.

Në Pulia ka kategori të ndryshme të vendeve që mbrohen, sipas legjislacionit të BE-së, legjislacionit kombëtar dhe rregullave rajonale. Ato përfshijnë: 2 parqe kombëtare, 16 rezervate kombëtare natyrore, 3 zona të mbrojtura detare, 19 zona të mbrojtura rajonale. Lidhur me “NATURA 2000” ekzistojnë 89 zona me interes (20,6% e sipërfaqes rajonale), 11 nga të cilat janë Zonat të Veçanta të Ruajtjes. (Burimi: ISTAT)

Rajoni i Molise ka një shumëllojshmëri të zonave të rëndësishme të mbrojtura natyrore (1,46% e sipërfaqes rajonale): Një Park Kombëtar, i përbashkët me Lazio-n dhe Abruzzo-n, katër rezervate natyrore, dy Oasis që menaxhohen nga organizatat aktiviste mjedisore. Lidhur me “NATURA 2000”, mund të gjenden 85 zona të interesit komunitar (21,5% të sipërfaqes rajonale), si dhe 12 Zona të Veçanta të Ruajtjes (14,7% të sipërfaqes rajonale). (Burimi: ISTAT)

Në Shqipëri përqindja e territorit të mbrojtur u rrit nga 0.75% në 15,83% dhe përfshin 17 zonat kombëtare të mbrojtura, pesë rezervate natyrore të menaxhuara, monumente natyrore, peizazhe të mbrojtura dhe zonat “Ramsar”. Mbulimi aktual i zonave të mbrojtura është i pabarabartë dhe nuk përfaqëson tipat e ndryshëm të habitatit që ekzistojnë në vend. Rrjeti kombëtar është ende i vogël për të pasur një ndikim efikas afatgjatë për mbrojtjen e biodiversitetit. Qeveria ka marrë një sërë masash për të eliminuar kërcënimet nga ndërtimi informal, prerjet dhe gjuetia e paligjshme. Burimet peshkore rrezikohen veçanërisht nga mbi-peshkimi në afërsi të zonës bregdetare dhe përdorimi i praktikave të paligjshme. Vetëm disa hapa janë ndërmarrë pas pranimit në Konventën e Bernës, më, 2011-n të zonave kandidate të propozuara nga Shqipëria për rrjetin Emerald.

Mali i Zi ka një rrjet prej 5 parqesh të mbrojtura në nivel kombëtar, të cilat mbulojnë 7.37% të territorit kombëtar: Durmitor, Skadarsko jezero (liqeni i Shkodrës), Lovćen, Biogradska gora dhe Prokletije. Pjesa tjetër përfshin mbi 48 zona të mbrojtura, si: monument natyror, peizazh me vlera të jashtëzakonshme dhe rezervate natyrore që mbulojnë 1,69% të territorit. Të gjitha rezervatet natyrore (me përjashtim të “Tivatska solila”) gjenden në brendësi të dyja parqeve kombëtare - liqenit të Shkodrës dhe malit Durmitor - duke formuar kështu pjesët e tyre integrale). Në rrjet përfshihen, gjithashtu, dhe zonat ndërkufitare, si për shembull, liqeni i Shkodrës, i ndarë në mes Malit të Zi dhe Shqipërisë. Pyjet janë ekosistemi më i përhapur në vend, duke mbuluar rreth 45% të territorit të tij. (Burimi: “Rezultatet e vlerësimit paraprak të menaxhimit të zonave të mbrojtura në Malin e Zi, duke përdorur Metodologjinë RAPPAM”, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të Malit të Zi, 2011)

Mali i Zi po punon për përafrimin e politikave për mbrojtjen e natyrës dhe po përgatitet për krijimin e rrjetit “Natura 2000”, pavarësisht se shumica e masave nuk janë zbatuar deri më sot për shkak të mungesës së kapaciteteve, kufizimeve financiare dhe prioriteteve të tjera të ngutshme. Ndër të tjera, zhvillimi i informacionit shkencor dhe të dhënave të nevojshme për përcaktimin e vendeve të planifikuara për mbrojtje është ende në fazën fillestare. Autoritetet bashkiake, përgjegjëse për përgatitjen e studimeve dhe mbrojtjen e objekteve me rëndësi rajonale, nuk kanë njohuri ose mjetet e mjaftueshme që të angazhohen në përpjekje të tilla dhe nuk janë në gjendje të ndalin zhvillimin e pakontrolluar. Zhdukja e karakteri-stikave natyrore të objekteve të mbrojtura të natyrës është e theksuar në Jugperëndim të Malit të Zi, ku dominon turizmi/presioni i zhvillimit urban, veçanërisht në plazhet e mbrojtura dhe zonat aty. Zbatimi i programit të menaxhimit të zonave bregdetare (CAMP MNE), i përgatitur me mbështetjen e UNEP-it më 2014-n, së

bashku me planifikimin e zhvillimit më të detajuar që merr parasysh vlerat unike natyrore të bregdetit mund të ndalojë degradimin e mëtejshëm të kësaj zone.

1.1.1.6 MBROJTJA E MJEDISIT, MENA-XHIMI I RREZIKUT DHE STRATEGJITË E KARBONIT TË ULËT

Shtetet pjesëmarrëse në Zonën e Programit përballen me shumë kërcënime të përbashkëta mjedisore, të tilla si: ndikimet e ndryshimeve klimatike, nevoja për të reduktuar CO₂, PM dhe NO₂ dhe formimin e ozonit, dhe degradimin e mjedisit. Bashkëpunimi ndërkufitar mund të jenë kritik në këtë drejtim, pasi duhen gjetur zgjidhje të reja dhe këto mund të përfitojnë shumë nëpërmjet bashkimit të njohurive dhe shkëmbimit të praktikave të mira.

NDRYSHIMET E KLIMËS

Në përgjithësi, Zona e Programit karakterizohet nga niveli mesatar i emisioneve për frymë, me një kontrast të dallueshëm mes Italisë (në afërsisht 6.5 teq) dhe Malit të Zi në rreth gjysma e atij niveli. Shqipëria shënon qartë nivel më të ulët, në 1,5 teq për frymë dhe vit si rezultat i motorizimit të ulët dhe kuotës shumë të lartë të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë (BRE).

Sipas një studimi të fundit të ARPA-së, Pulia mbi cilësinë e ajrit, rajoni i Pulias paraqet një situatë mjaft homogjene, kryesisht duke respektuar parametrat e ligjit italian. Përjashtimet e vetme mund të gjenden në Taranto (lagjen “Tamburi”) dhe Martina Franca. Pavarësisht kësaj, mobiliteti i qëndrueshëm urban për nivelin e ulët të emisioneve të CO₂ është një çështje dhe Pulia, ende rezulton në nivel kombëtar një prej rajoneve kryesore italiane në aspektin e ndotjes industriale të atmosferës. Bimët më të rëndësishme industriale gjenden në fushat e Brindizit dhe Tarantos, kështu që kontributi i tyre në bilancin e përgjithshëm të cilësisë së ajrit është padyshim i madh. Së fundmi, përqendrimi i ozonit, veçanërisht gjatë periudhës së verës është i shpërndarë në të gjithë territorin dhe për pasojë tejkalon vlerat e synuara për mbrojtjen e shëndetit. (Burimi: Arpa Pulia)

Reduktimi i emetimeve të CO₂ është prioritet edhe në Molise, ku emetimet e CO₂ janë rritur me 57% gjatë 2005–2011, në raport me vlerat e vitit 1990.

Shqipërisë i mungon një politikë dhe strategji gjithëpërfshirëse për klimën në tërë vendin. Vendi rregullisht është bërë palë me qëndrimet e BE-së në kontekstin ndërkombëtar, por ende nuk treguar një angazhim për lehtësira për 2020-n. Në përputhje me dokumentin e gjelbër të BE-së “Korniza për klimën dhe politikat e energjisë 2030”, vendi duhet të reflektojë mbi klimën e saj dhe kornizën e energjisë për vitin 2030. Sa i përket harmonizimit me acquis mbi klimën, është miratuar legjislacioni në fushën e cilësisë së karburantit. Kërkohen përpjekje të mëdha për të rritur monitorimin, raportimin dhe kapacitetet e verifikimit në vend. Ndërgjegjësimi i klimës në të gjitha nivelet mbetet i ulët dhe kërkohet forcim i mëtejshëm i bashkëpunimit mes të gjitha palëve të interesuara.

Lidhur me ndryshimet klimatike, Mali i Zi ka ratifikuar Protokollin e Kiotos. Kjo nuk është palë e shtojcës I të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimatike (UNFCCC) dhe nuk synon kufizimin/ uljen e emetimeve të gazit serë (GHG). Sipas raportit-progresit të BE-së 2013: “*Mali i Zi nuk është gati të ndërmarrë një angazhim ligjor për detyrueshmëri për kufizimin ose uljen e emetimeve sipas kuadrit mbi klimën të pas 2012-s. Kjo nuk është e mundur të përmbushë detyrimet për raportim të gazit serë sipas vendimit 280/2004/KE për mekanizmin e monitorimit. Vendi është bërë palë e Marrëveshjes së Kopenhagenit, por ende nuk ka treguar një angazhim për ulje deri në vitin 2020, në përputhje me ato të BE-së dhe shteteve anëtare të saj. Lidhur me përafrimin e acquis për klimën, Mali i Zi është në një fazë të hershme.*

CILËSIA E AJRIT

Shkaku kryesor i problemeve të ndotjes së ajrit në zonën e programit janë aktivitetet industriale (përfshirë: termocentralet, rafineritë e naftës, industrinë kimike dhe kompleksat metalurgjike), sektori i ndërtimit, djegia e pakontrolluar e mbetjeve në venddepozitume dhe transporti kryesisht përmes trafikut të shtuar (përfshirë numrin e madh ekzistues të automjeteve dhe rritjen e saj vjetore, cilësinë e keqe të karburantit të përdorur, vitin e tyre të prodhimit).

Në Pulia, sipas raportit vjetor për cilësinë e ajrit më 2013-n, problemi i vetëm lidhet me grimcat PM₁₀. Të dhënat tregojnë se kufiri i tejkalimit prej 35 në vit të mesatares ditore prej 50 µg/m³ (mikrogramë për metër kubik) është tejkaluar në Torchiarolo (për shkak të emetimeve nga biomasa) dhe në Martina Franca (për shkak të trafikut). Pragjet e përcaktuara me ligj nuk janë tejkaluar për NO₂ (një maksimum prej 15 mg/m³ kundrejt limitit prej 40 mg/m³) dhe vlera mesatare e NO₂ (në mg/m³) tregon vlera më të ulëta në vitin 2013 në krahasim me 2002-n. Ozoni (O₃) në muajt e verës është shumë i përhapur në këtë rajon. Vlerat

limit, të vendosura për mbrojtjen e shëndetit, janë tejkaluar gjatë viteve të fundit në zona të shumta, përfshirë Leçe, Brindizi, Tarantos dhe Foggia. Nuk ka të dhëna të tilla në dispozicion për rajonin e Molise.

Në Shqipëri, elementet kryesore që kontribuojnë në uljen e cilësisë së ajrit janë transporti dhe sektori i ndërtimit. Nga matjet e bëra në stacionet monitoruese të Korçës dhe Vlorës, ndotësit kryesorë të ajrit janë grimcat mesatare vjetore e PM10 përmbajtja e të cilit është më e lartë se të përmbajtjes normale mesatare në Shqipëri dhe kufijve të legjislationit evropian. Për ndotësit e tjerë, nuk janë vërejtur matje problematike.

Cilësia e ajrit në Mal të Zi është një shqetësim i madh: matjet tregojnë se përqendrimet e PM10 më 2012-n ishte 52 $\mu\text{g}/\text{M}38$, e cila është shumë më e lartë se ajo që BE-ja dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) kanë vendosur për të mbrojtur shëndetin. Një raport i kohëve të fundit në Mal të Zi mbi cilësinë e ajrit në vitin 2013 (nga EPA-ja, Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit e Malit të Zi), thekson se gjatë këtij viti vlera limit vjetore për PM10, 40 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ është tejkaluar në disa vende, veçanërisht në qytetet e Berane, Bijelo Polje, Bar, Cetinje dhe Podgoricë. Është e nevojshme të ndërmerren masa për ndotjen e ajrit dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Përderisa cilësia e ajrit paraqet një nga sfidat kryesore për zonën e programit, duhet të ndërmerren masat e duhura të vlerësimit përmes monitorimit, modelimit dhe vlerësimit objektiv për përputhje me standardet mjedisore sipas direktivës 2008/50/KE. Përveç kësaj, për të reduktuar efektet negative të ndotjes së ajrit në shëndetin dhe mjedisin duhen ndërmarrë masa duke filluar nga reduktimi i ndikimeve negative në mjedis, ndotjes dhe emetimeve të gazrave në fusha të ndryshme, nga transporti publik dhe i mallrave në prodhimin industrial dhe të furnizimit me energji.

EKSPLOZIMI NDAJ RREZIQEVE NATY-RORE

Shumë pjesë të Zonës së Programit janë relativisht të ekspozuara ndaj rreziqeve të shkaqeve natyrore dhe njerëzore krahasuar me mesataren kombëtare dhe të BE-së (rreshqitja e dheut, rreziqet sizmike, hidraulike dhe hidrogeologjike, shkretëtirëzimi, erozioni dhe zjarri, stresi nga zhvillimi urban dhe turistik ose ndotja industriale). Për më tepër, edhe më agresive janë sjelljet shoqërore, proceset e zhvillimit ekonomik dhe stili i ri i jetesës që gjithnjë e më shumë ndikon në peizazhin e Zonës së Programit duke alternuar bukurinë dhe integritetin e saj.

Në rajonin e Pulias, zjarret në pyje në vitin 2011 shkaktuan 945 raste të shkatërrimit të sipërfaqes “së gjelbër”. Degradimi i tokës dhe ndërtimet e vazhdueshme kanë nxjerrë në pah një kërcënim konkret për ekologjinë rajonale, veçanërisht në Salento, në zonat qendrore dhe në bregun jonian. Zona bregdetare karakterizohet shumë nga turizmi dhe aktivitetet e njerëzve. Kjo është e vërtetë veçanërisht për dunat e rërës (37% e vijës bregdetare), që vuajnë nga erozioni dhe humbja e funksionalitetit natyror mbrojtës kundër avancimit të detit. Pothuajse i gjithë rreziku i rreshqitjes është i përqendruar në provincën e Foggia, ku rreth 30% e territorit është klasifikuar në rrezik krahasuar me mesataren rajonale të barabartë me 8.4%.

Molise është rajoni italian me numrin më të lartë (36%) të bashkive të ekspozuara ndaj rrezikut të rreshqitjes së dheut. Rreziku i lartë sizmik është shtrirë në 91,2% të territorit rajonal, ndërsa banorët e prekur shumë korrespondojnë me 83,3% të popullsisë rajonale. Për më tepër, 43 bashki janë të përqendruara në zonën me rrezikshmëri të lartë, 84 në zonën me rrezikshmëri të mesme dhe vetëm 9 në zonën me rrezikshmëri të ulët. (Burimi: ISTAT/ Mbrojtja Civile, 2012)

Pothuajse i gjithë Mali i Zi është i ekspozuar ndaj ngjarjeve të shpeshta sizmike, veçanërisht përgjatë bregdetit, luginës Zeta-Shkodër dhe basenit Berane. Rreth 40% e territorit të tij është në një zonë të intensitetit sizmik të parashikuar që prek rreth 60% të popullsisë. Përmbajtjet janë rreziku më i shpeshtë natyror, ku Pažićko Polje dhe lugina e lumit Lim janë më të prirur ndaj përmbajtjeve.

Lidhur me kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimit të rrezikut, Shqipëria ka ratifikuar, në shtator 2012, Protokollin mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme (OPRC-HNS). Për sa u përket politikave të zhurmës mjedisore, është krijuar një task forcë e përhershme për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat bregdetare turistike, por zbatimi i vendimeve të saj është e dyshimtë.

Vendet pjesëmarrëse në Program praktikojnë metodologji të ndryshme në fushën e ujit dhe paraqet një nivel të ndryshëm të pjekurisë për zbatimin e direktivës evropiane për sektorin e ujit, miratimin, në veçanti të Planit për Menaxhimit të Basenit të Lumit (PMBL) (sipas direktivës 2000/60/KE, Direktiva Kuadër e Ujit (DKU) dhe Planin për Menaxhimin e Rrezikut të Përmbajtjeve (PMRP) (në bazë të direktivës 2007/60/KE, Direktiva për Përmbajtjet).

E gjithë zona e Programit po përballët me sfida të rëndësishme në aspektin e ndikimit mjedisor në menaxhimin e burimeve ujore, nga njëra anë për mbrojtjen, përmirësimin dhe ruajtjen e kushteve mjedisore të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, nga ana tjetër në përputhje me Zonën Prioritare 4 “Për rivendosjen dhe ruajtjen e cilësisë së ujërave” dhe Zonën Prioritare 5 “Për menaxhimin e rreziqeve mjedisore” të Strategjisë Evropiane për Rajonin e Danubit - EUSDR (në Mal të Zi).

MENAXHIMI I BURIMEVE UJORE DHE MBETJEVE

Shtetet pjesëmarrëse të Programit praktikojnë metodologji të ndryshme në fushën e ujit; Pulia dhe Molise bëjnë pjesë në qarkun e Basenit të Lumit të quajtur “Distretto idrografico dell’ Appennino meridionale”, plani i menaxhimit të cilit u publikua në Gazetën Zyrtare italiane N.160, të datës 10.7.2013. Ky PMBL përfaqëson zbatimin e strategjisë së Direktivës Kuadër të Ujit 2000/60/KE në aspektin e menaxhimit të burimeve ujore dhe qeverisjes, qëndrueshmërisë dhe mbrojtjes, duke integruar dispozitat e Planit të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet sipas direktivës 2007/60/KE për sa i përket përdorimit efikas dhe racional të burimeve ujore, duke garantuar një menaxhimi të mirë dhe një kuadër të vlerësimit të rreziqeve nga përmbytjet.

Dokumentet Strategjike për Shqipërinë dhe Malin e Zi rekomandojnë marrjen e masave për përmirësimin e kapaciteteve institucionale dhe krijimin e kushteve për të krijuar një sistem efikas dhe efektiv të menaxhimit të ujit. Në tetor 2006, Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Lumit Danub (KNMLD) mori letër zyrtare nga Mali i Zi që njofton ratifikimin e Konventës për Mbrojtjen e Lumit Danub, me objektiva ruajtjen, përmirësimin dhe promovimin e një shfrytëzimi racional të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, kontrollin e rreziqeve me origjinë aksidentet (përmbytjet, akulli apo substanca të rrezikshme), uljen e ndotjes që shkarkohet në Detin e Zi.

Ndikimi i transportit mbi mjedisin jetësor, në shëndetin e njeriut (ndotja, në përmirësimin e veçanërisht të cilësisë së ajrit dhe zvogëlimin e PM-së dhe emisioneve NO₂, zhurma), duhet të merren në konsideratë në zhvillimin e zgjidhjeve novatore të qëndrueshme.

Aksionet janë adresuar drejt rritjes së lidhjeve dhe bashkëveprimit të të gjithë mënyrave të transportit nëpërmjet mbështetjeve të një përdorimi të koordinuar e më efçent për kapacitetet aktuale të transportit. Programi do të sigurojë sinergji dhe ndërveprime me shërbimet bazë të shoqërisë si arsim dhe shëndetësi; në këtë perspektivë, aksionet në sistemin e transporteve për lehtësimin e transferimeve në spital mund të zhvillohen.

Rezultatet duhet të arrihen nëpërmjet përmirësimit multimodal të zinxhirëve të transportit, me përfshirjen efektive të aktorëve të transportit publik dhe privat, si autoritete publike, logjistike dhe operatorët e transportit, portet, aeroportet, hekurudhat, transportuesi rrugor, organizatat ndërqeveritare dhe kërkimore.

Në veçanti, rezultatet kryesore të pritshme, janë:

1. Lidhjet transporti ndërkufitare të qëndrueshme, efikase, multimodal dhe me cilësi brenda zonës janë përmirësuar;
2. Lidhjet ekzistuese, me kohë të rregullt tranzit dhe procedurave të përbashkëta janë optimizuar;
3. Zinxhir furnizimi logjistike i konsoliduar për të sjellë një sistem të transportit derë më derë të integruar duke prezantuar ndërmodale të reja me bazë detin.

Ky OS është koherent me shtyllën 2 të Planit të Veprimit EUSAIR, duke iu referuar temave të mëposhtme:

- a) “transporti detar”.
- b) “lidhjet ndërmodale në brendësi”.
- c) Përveç kësaj, OS-ja është në përputhje me çështjen ndërkufitare të EUSAIR “Ngritja e kapaciteteve”

Lista e mëposhtme e veprimeve të mundshme është vetëm një listë treguese dhe mund të plotësohet me veprime të tjera të rëndësishme që kontribuojnë për qëllimet e veçanta të objektivave:

Krijimi i një platforme bashkëpunimi mes të palëve të interesuara për të përmirësuar lidhjet multimodale brenda zonës së programit në mënyrë që infrastruktura ekzistuese e transportit dhe shërbimet e transportit të përdoren në mënyrë më efikase dhe të jenë më miqësor me përdoruesin.

2. Përmirësimi i rrjetit të palëve përkatëse doganore ndërkufitare për përmirësimin e procedurave doganore për pasagjerët dhe sasinë e mallrave, duke kontribuar për të arritur objektivin në vitin 2020 për të ulur kohën në kalimet kufitare rajonale me 50%.

3. Nxitja e lidhjeve midis infrastrukturave kryesore të transportit ndërkufitar dhe korridoreve transeuropiane të BE-së me qëllim promovimin e transportit të qëndrueshëm në rajon edhe zbatimin e investime të shkallës së vogël në shërbime të avancuara dhe infrastrukturave fizike.

4. Rritja e lidhjes brendarajonale të zonës si qendër edhe për transportin e mallrave dhe udhëtarëve drejt dhe nga destinacione të tjera.

5. Përmirësimi dhe shkëmbimi i aftësive në sistem të qëndrueshëm transporti si për operatorët dhe drejtuesit.

6. Ngritja e platformave të konsoliduara duke mundësuar optimizimin e ngarkesave jashtë standardit (LCL - Më pak ngarkesë në kontejner).

Llojet treguese të përfituesve: Organet publike, organeve që rregullohen nga e drejta publike, autoritete lokale, agjencitë e transportit rajonal dhe kombëtar, organizata arsimore dhe trajnimi, ndërmarrjet hekurudhore, autoritetet portuale, institutet kërkimore, kombëtare, rajonale dhe autoritetet lokale të transportit dhe infrastrukturës, organizatat e shoqërisë civile.

Grupet e synuara: Operatorët multimodalë, operatorët e transportit detar, transportuesit, industria detare e transportit, doganat, operatorët hekurudhorë, komunitetet lokale, qytetarët dhe përdoruesit fundorë.

2.2.5 Treguesit specifikë të Programit⁸

2.2.5.1 Rezultatet e treguesve specifikë të Programit

(Referenca: pika c (ii), neni 8(2) i Rregullores nr. 1299/2013 BE)

Tabela 3: Rezultatet e treguesve specifikë të Programit

ID	Treguesi	Njësia matëse	Vlera minimale	Viti i fillimit	Vlera e synuar ⁹	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e raportimit
1.1	Ndërhijet e përbashkëta kanë si qëllim për të përmirësuar kushtet e strukturës ndërkufitare në të cilën funksionojnë asistencat e konkurrencës	Sasiore	8	2015	15	Sondazh	2018 2020 2023
2.1	Miratimi i planeve të përbashkëta të veprimit për menaxhimin racional të destinacioneve turistike nga autoritetet publike të zonës së programit	Sasiore	0	2015	4	Sondazh	2018 2020 2023
2.2	a) Rrjetet ndërkufitare në fushat kulturore dhe krijuese b) Marrëveshjet ndërkufitare në fushat kulturore dhe krijuese	Sasiore	a)2 b)1	2015	a)5 b)3	Sondazh	2018 2020 2023
3.1	Planet e përbashkëta rrisin dhe ruajnë zonat ujore(duke përfshirë zonën detare gjithashtu)	Sasiore	3	2015	7	Sondazh	2018 2020 2023
3.2	Planet e përbashkëta për efikasitetin e energjisë dhe për prodhimin e qëndrueshëm të energjisë	Sasiore	1	2015	4	Sondazh	2018 2020 2023
4.1	Marrëveshjet për pasagjerët ndërkufitarë dhe sistemet e qëndrueshme të transportit të mallrave dhe zgjidhjet e shumta në dispozicion	Sasiore	5	2015	7	Sondazh	2018 2020 2023

⁸ Kërkohet kur të jetë e argumentuar përmbajtja e veprimeve të dhëna dhe ku mbështetja e BE-së për asistencën teknike në programin e bashkëpunimit t'i kalojë 15 milionë euro.

⁹ Vlerat e synuara mund të jenë cilësore apo sasiore.

2.2.5.2 Treguesit e kontributit specifik të programit që do të kontribuojë në rezultate

(Referenca:pika c(iv), neni 8(2) i Rregullores nr. 1229/2013 BE)

Tabela 4: Treguesit e kontributit specifik të programit

ID	Treguesi	Njësia matëse	Burimi i të dhënave
1.1	- Numri i ndërmarrjeve të cilat nuk marrin mbështetje financiare (treguesi i përbashkët-duke u bazuar në aneksin e Rregullores nr. 1229/2013 BE. - Numri i bizneseve dhe institucioneve të kërkimit të përfshira apo të cilat ofrojnë ndihmë.	Numër	Progres raportet
2.1	- Numri i produkteve dhe shërbimeve të reja dhe realizimi i projekteve pilot ose demonstrative. - Numri i vendndodhjeve në rritje.	Numër	Progres raportet
2.2	- Numri i ndërmarrjeve të cilat nuk marrin mbështetje financiare(treguesi i përbashkët-duke u bazuar në aneksin e Rregullores nr. 1229/2013 BE. - Numri i platformave krijuese ndërkufitare.	Numër	Progres raportet
3.1	- Numri i produkteve dhe shërbimeve të reja dhe realizimi i projekteve pilot ose demonstrative. - Numri i përdoruesve (në projektet pilot ose demonstrative).	Numër	Progres raportet
4.1	- Numri i produkteve dhe shërbimeve të reja dhe realizimi i projekteve pilot ose demonstrative. - Numri i pasagjerëve dhe përfitimet e transportit të mallrave të lidhjeve të reja të shumta.	Numër	Progres raportet
5.1	- Numri i punëmarrësve (me kohë të plotë) nga strukturat menaxhuese të programit.	Numër	Progres raportet

2.2.6 KATEGORITË E NDËRHYRJES

(Referencë: shkronjat “c” dhe “v”, të nenit 8, pika 2, të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Kategoritë korresponduese të ndërhyrjes bazuar në nomenklaturë të miratuar nga Komisioni dhe një ndarje indikative e mbështetjes së Bashkimit Evropian.

Tabelat 5–8: Kategoritë e ndërhyrjes

Tabela 5. Dimensioni 1: Fusha e ndërhyrjes

Aksi prioritar	Kodi	Shuma në €
1	62 Transferimi i teknologjisë dhe bashkëpunimi universitet-ndërmarrje kryesisht përfitojnë NVM-të.	1.576.028,40
	63 Mbështetje për grupet dhe rrjetet e biznesit kryesisht përfitojnë NVM-të.	4.728.085,20
	64 Proceset e hulumtimit dhe inovacionit në NVM-të (përfshi skemat e kuponit, procesi, dizajni, shërbimi dhe inovacioni social)	1.576.028,40
	67 Zhvillimi i biznesit të NVM-ve, mbështetje për sipërmarrjen dhe inkubacionin (përfshi mbështetjen për degët e një shoqërie mëmë ose kompanitë e reja).	4.728.085,20
	73 Mbështetje për ndërmarrjet shoqërore (NVM-të)	3.152.056,80
2	91 Zhvillimi dhe promovimi i potencialeve turistike të zonave natyrore.	4.412.879,60
	94 Mbrojtja, zhvillimi dhe promovimi i aseteve të trashëgimisë kulturore publike	4.412.879,60
	95 Zhvillimi dhe promovimi i shërbimeve kulturore dhe të trashëgimisë publike	6.619.319,40
	77 Zhvillimi dhe promovimi i shërbimeve kulturore dhe krijuese te ose për NVM-të	6.619.319,40
	21 Menaxhimi i ujit dhe ruajtja e ujit të pijshëm (përfshi menaxhimin e basenit të lumit, furnizimi me ujë, masat specifike për përshtatjen e ndryshimeve klimatike, matësit e konsumimit dhe matësit e qarkut, sistemet e ngarkesës dhe reduktimi i rrjedhjes)	4.925.089,00
	85 Mbrojtja dhe përmirësimi i biodiversitetit, mbrojtja e natyrës dhe e	1.970.035,60

	infrastrukturës së gjelbër.	
	87 Masat për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve që lidhen me klimën p.sh. erozioni, zjarret, përmbytjet, stuhitë dhe thatësira, duke përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit, mbrojtjen civile dhe sistemet e menaxhimit të fatkeqësive dhe të infrastrukturës.	5.910.106,80
	12 Energji të tjera të rinovueshme (përfshi energjinë hidroelektrike, gjeotermale dhe detare) dhe integrimin e energjisë së rinovueshme (përfshi ruajtjen, infrastrukturën e energjisë, të gazit dhe asaj të rinovueshme të hidrogjenit)	2.955.053,40
	13 Renovimi i infrastrukturës publike të efikasitetit të energjisë, projektet demonstruese dhe masat mbështetëse.	3.940.071,20
	036 Transporti multimodal	8.037.745,20
	44 Sistemet inteligjente të transportit (përfshi futjen e menaxhimit të kërkesës, sistemet e rrugëve me pagesë, kontrolli i monitorimit të TI dhe sistemet e informacionit).	5.358.496,80
	121 Përgatitja, zbatimi, monitorimi dhe inspektimi	4.728.085,20
	122 Vlerësimi dhe studimet	788.014,20
	123 Informimi dhe komunikimi	2.364.042,60

Tabela 6: Dimensioi 2: Forma e financimit

Aksi prioritar	Kodi	Shuma në €
1	01 Grant joripagueshëm	15.760.284
2	01 Grant joripagueshëm	22.064.398
3	01 Grant joripagueshëm	19.700.356
4	01 Grant joripagueshëm	13.396.242
5	01 Grant joripagueshëm	7.880.142

Tabela 7: Dimensioi 3: Lloji i territori

Aksi prioritar	Kodi	Shuma në €
1	01 Zona të mëdha urbane (me dendësi popullsie > 50 000 banorë)	12.608.227,20
	02 Zona të vogla urbane (dendësi e ndërmjetme > 5 000 banorë)	3.152.056,80
2	01 Zona të mëdha urbane (me dendësi popullsie > 50 000 banorë)	5.516.099,50
	02 Zona të vogla urbane (dendësi e ndërmjetme > 5 000 banorë)	6.619.319,40
	03 Zonat rurale (pak e populluar)	9.928.979,10
3	01 Zona të mëdha urbane (me dendësi popullsie > 50 000 banorë)	5.910.106,80
	04 Zonat e bashkëpunimit makrorajonal	13.790.249,20
4	01 Zona të mëdha urbane (me dendësi popullsie > 50 000 banorë)	5.358.496,80
	04 Zonat e bashkëpunimit makrorajonal	8.037.745,20
5	07 Jo e aplikueshme	7.880.142,00

Tabela 8: Dimensioi 6: Mekanizmat e shpërndarjes territoriale

Aksi prioritar	Kodi	Shuma në euro
1	07 E pazbatueshme	15.760.284
2	07 E pazbatueshme	22.064.398
3	07 E pazbatueshme	19.700.356
4	07 E pazbatueshme	13.396.242
5	07 E pazbatueshme	7.880.142

SEKSIONI 2.3 TABELA E PËRGJITHSHME E INDIKATORËVE SIPAS AKSIT PRIORITAR DHE PRIORITETIT TEMATIK

Tabela 9: Tabela e indikatorëve të prodhimit dhe e rezultateve të përbashkëta dhe specifike.

Aksi prioritar	Prioriteti tematik	Objektivi (ët) specifik	Indikatorët e përzgjedhur të rezultateve	Indikatorët e përzgjedhur të prodhimit
----------------	--------------------	-------------------------	--	--

AP1: Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe konkurueshmëria e SMS-ve	PT1: Rritje e konkurrencës, rritet të biznesit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, tregtisë dhe investimeve përmes ndër të tjera, promovimit dhe mbështetjes së sipërmarrjes, në veçanti ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe zhvillimin e tregjeve ndërkufitare lokale dhe ndërkombëtarizimi.	Objekti i specifik 1.1: Përmirësimi i kushteve për zhvillimin e tregut ndërkufitar të NVM-ve.	Ndërhyrje të përbashkëta që kanë për qëllim të përmirësojnë kushtet e kuadrit ndërkufitar, ku operojnë lehtësuesit e konkurueshmërisë	Numri i ndërmarrjeve që marrin mbështetje jo-financiare (indikator i përbashkët - referenca të Shtojca e Rregullores (BE) Nr. 1299/2013); Numri i bizneseve dhe kërkimit/hulumtimit
AP2: Menaxhimi zgjuar i Trashëgimisë kulturore dhe natyrore për shrytëzimin e turizmit të qëndrueshëm ndërkufitar dhe atraktivitet qëndrueshëm ndërkufitar dhe atraktivitet territorial.	TP 2: Nxitja e Numri i turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore	Objekti i specifik 2.1: Inkurajimi i atraktiviteteve të aseteve natyrore dhe kulturore për të përmirësuar rritjen e shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike	Planet e përbashkëta të veprimit për menaxhimin e e zgjuar të destinacioneve turistike që do të miratohen nga autoritete publike.	Numri i produkteve të reja shërbimeve ose demonstrimi i projekteve të realizuar.
		Objekti i specifik 2.2: Rritje e bashkëpunimit të aktorëve kyç përkatës të zonës për ofrimin e produkteve të reja kulturore dhe krijuese.	a) Rrjete ndërkufitare në fushat kulturore dhe krijuese; b) Marrëveshje ndërkufitare në fushat kulturore krijuese.	Numri i vendeve të vlerësuar
				Numri i ndërmarrjeve që nuk marrin ndihmë financiare (referencë indikative e përbashkët në Aneksin e Rregullores (BE) Nr. 1299/2013)
AP3: Mbrojtja e mjedisit, menaxhimi i riskut dhe strategjia për karbonin e ulët.	TP 3: Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutjes, parandalimit dhe menaxhimit të rrezikut përmes, ndër të tjera, aksioneve të përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit; promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, efikasitetit të burimeve, të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe kalimi drejt një ekonomie të sigurtë, të qëndrueshme me nivel të ulët të karbonit; promovimi i investimeve për të adresuar rreziqe specifike, duke siguruar reagimin ndaj fatkeqësive dhe duke zhvilluar sisteme për menaxhimin e katastrofave dhe gatishmërinë e emergjencave.	Objekti i Specifik 3.1: Përmirësimi i strategjive të bashkëpunimit ndërkufitar për peisazhet ujore	Plane të përbashkëta që rrisin dhe ruajnë peisazhet ujore (përfshi edhe ato detare).	Numri i produkteve të reja dhe shërbimeve si dhe demonstrimi i projekteve pilot të realizuar;
		Objekti i specifik 3.2: Promovimi i praktikave dhe mjeteve novatore për të zvogëluar emisionin e për të përmirësuar efikasitetin e energjisë në sektorët publik.	Plane të përbashkëta për efikasitetin e energjisë dhe prodhimin e qëndrueshëm të energjisë.	Numri i përdoruesve të përfshirë (në projektet pilot ose të demonstruara)
				Numri i produkteve të reja, shërbimeve, si dhe demonstrimi i projekteve pilot
AP4: Rritje e aksesit ndërkufitar, nxitja e transportit të udhëtarëve dhe shërbimit të transportit dhe facilitet, dhe përmirësimi i infrastrukturës publike.	TP4: Promovimi i transportit të qëndrueshëm dhe përmirësimi i infrastrukturës nga, ndër të dhe qëndrueshme e demonstrimit nëpërmjet rritjes së aksesit në transport, informacion dhe komunikim rrjete dhe shërbime dhe duke investuar në sistemet e	Objekti i Specifik 4.1 Rritje e koordinimit midis aktorëve përkatës për të nxitur lidhjet e qëndrueshme ndërkufitare në zonën e bashkëpunimit.	Marrëveshjet për lidhjet e qëndrueshme ndërkufitare të sistemeve të tjera të tjera, zvogëlimi i izolimit të pasagjerëve dhe të mallrave si dhe	Numri i produkteve të reja, shërbimet, pilot dhe demonstrimi i projekteve të realizuara.

	ujësjellësit, kalalizime të energjisë dhe facilitetet (pajisjet)		zgjidhjet multimodale të lëvizjes.	Numri i pasagjerëve dhe mallrave që përfitojnë nga lidhjet e reja multimodale.
AP 5: Asistenca Teknike	N/A	5.1Aksione për të mbështetur strukturën e programit me menaxhimin të shëndoshë të programit të bashkëpunimit në aspektin e efikasitetit dhe efektivitetit.	N/A	Numri i punonjësve (kohë e plotë ekuivalente nga strukturat e menaxhimit të programit)

PËRMBLEDHJE E PËRDORIMIT TË PLANIFIKUAR TË ASISTENCES TEKNIKE

(Referenca: pika (b)(vi) e nenit 8(2) e Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

AKSI PRIORITAR ASISTENCA TEKNIKE

Nuk ka asnjë veprim që kufizon rolin zbatues të një akti prioritar specifik. Aksione ndihmëse teknike lidhur me të gjitha akset prioritare marrin zhvillim në seksionin 2.b.

SEKSIONI 2.B. PERSHKRIM I AKSIT PRIORITAR PËR ASISTENCË TEKNIKE

2.B.1 AKSI PRIORITAR 5

ID AKSI PRIORITAR 5

Titulli ASISTENCA TEKNIKE

2.B.2. Fondet dhe procesi i llogaritjes për mbështetjen e Unionit

Fondi IPA

Procesi i llogaritjes (shpenzimet e mundshme në total)

2.B.3. Objektivat specifikë dhe rezultatet e pritshme

(Referenca: pika (c)(i) dhe (ii) e nenit 8(2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Qëllimi specifik (përsëritur për secilin qëllim specifik)

D	5.1
Qëllimi specifik	Të rrisë efikasitetin dhe efektivitetin në menaxhimin dhe zbatimin e Programit të Bashkëpunimit

Rezultatet pritshme	e	Menaxhimi i mirë i Programit të Bashkëpunimit është parakusht zbatimin efektiv të tij. Programi është një “Program CBC”, i cili mund t’i referohet një game të gjerë përvojash dhe mësimesh të nxjerra nga programet e bashkëpunimit transnacionale dhe ndërkuftare të zbatuara në periudhën e programimit 2007-2013 të BE-së, përkatësisht në programet Med, South East Europe (Evropa Juglindore) dhe IPA CBC Adriatik. Gjatë vlerësimit të programit IPA dhe South East Europe 2007-2013 u vu re se barra administrative në kuadër të zbatimit mund të reduktohet. Prandaj, ndryshimi i nxitur nga programi i referohet kryesisht përmirësimit të mëtejshëm dhe lehtësimit të procedurave administrative për zbatim më të shpejtë dhe më efikas të programit dhe një mbështetje më të mirë për përfituesit në mënyrë që ata të zbatojnë në kushte më të mira dhe me një cilësi më të mirë projektet e dëshiruara. Rezultatet kryesore të pritshme janë: a) duhet të garantohet një menaxhim i duhur dhe kontroll ambienti i programit, siç përshkruhet në seksionin 5.3. b) duhet të garantohet që do të zbatohen si duhet dhe brenda afatit të gjithë hapat e zbatimit të programit (përfshirë thirrjet, kontraktimin, monitorimin e operacioneve, arritjet e programit, rimbursimin e shpenzimeve etj.).
---------------------	---	---

D	5.2
---	-----

Qëllimi specifik	Për të përmirësuar mbështetjen ndaj aplikantëve dhe përfituesve dhe për të forcuar përfshirjen e partnerëve përkatës në zbatimin e programit
Rezultatet e pritshme	Përveç një mirëmenaxhimi të programit, kapaciteti i aplikantëve dhe përfituesve për të marrë pjesë në program, dhe për më tepër përfshirja e drejtpërdrejtë e partnerëve përkatës, në përputhje me qasjen disanivelëshe të qeverisë, siç përcaktohet në nenin 5 të Rregullores (BE) 1303/2013 (d.m.th. organet kompetente kombëtare, rajonale dhe lokale që përfaqësojnë institucione publike në të gjitha nivelet përkatëse, organet socio-ekonomike dhe shoqëria civile), janë aspektet kryesore që çojnë në zbatimin e tij të suksesshëm. Në kuadrin e këtij qëllimi specifik, programi do të trajtojë nevojën për të rritur numrin e aplikantëve dhe përfituesve në pjesëmarrjen e këtyre proceseve dhe në arritjen e rezultateve sa më efektive që synojnë përmirësimin e politikave dhe strategjive dhe/ose të investimeve afatgjata. Ndryshimi kryesor i kërkuar është përmirësimi i cilësisë së projekteve, që nënkupton përdorimin e aplikacioneve që korrespondojnë më mirë me kërkesat e programit. Ky ndryshim do të kërkojë një përshtatje të kërkesave për propozime (atyre strategjike dhe të synuara), procedura të thjeshtësuara dhe më shumë mbështetje ndaj aplikantëve dhe përfituesve (që trajnohen në përgatitjen e aplikacioneve, në menaxhimin e projekteve, mobilizimin e sekretariatit të përbashkët (SP), përmes konsultimeve individuale, informacionit, animacionit dhe mobilizimit të Pikave Kombëtare të Informacionit). Në bazë të kësaj, dy përfundime kryesore janë paramenduar: - rritja e numrit të aplikuesve dhe përfituesve që u jepet mundësia të marrin pjesë në program; - një përfshirje më e fuqishme e partnerëve përkatës në zbatimin e programit.

2.B.4 Treguesit e rezultatit

I papërshtatshëm përderisa mbështetja e Unionit për asistencë teknike në programin Interreg Itali-Shqipëri-Mal i Zi IPA II CBC nuk i kalon 15 milionë euro.

2.B.5 Aktet që duhen mbështetur dhe kontributi i tyre i pritshëm në shërbim të qëllimit specifik

2.B.5.1 Përshkrim i akteve që duhen mbështetur dhe kontributi i tyre i pritshëm në shërbim të qëllimit specifik.

(Referenca: pika (c)(iii) e nenit 8(2) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013

Aksi prioritar 5

ASISTENCA TEKNIKE

Lloje dhe shembuj të akteve dhe kontributi i pritshëm në shërbim të qëllimit specifik:

Lista e mëposhtme e akteve të mundshme është vetëm një listë treguese dhe që mund të plotësohet me akte të tjera të përshtatshme që i shërbejnë qëllimit të objektivit specifik.

Objektivi specifik 5: Veprime që mbështesin strukturën e programit të bashkëpunimit me një menaxhim të mirë të tij në aspektin e efikasitetit dhe efektivitetit.

Në përputhje me nenin 59 të Rregullores (BE-së) 1303/2013 (CPR), aktet brenda qëllimit specifik 5.1 synojnë përgatitjen, menaxhimin, monitorimin, vlerësimin, informacionin, komunikimin, rrjetin dhe kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë së programit.

Për më tepër, aktet që i referohen këtij qëllimi specifik, gjithashtu, trajtojnë reduktimin e barrës

administrative për përfituesit, duke aplikuar parimet e thjeshtësisë dhe harmonizimit të rregullave, fleksibilitetit dhe proporcionalitetit në rritje.

Aksionet treguese të mbështetura në objektivin specifik 5.1 janë renditur më poshtë dhe i referohen parimeve dhe detyrave të përshkruara në seksionet 5.3 dhe 7:

- Ngritja dhe menaxhimi i Sekretariatit të Përbashkët që mbështet MA/CA dhe ndihmon (Komitetin monitorues) MC, në menaxhimin, programin, administrativ dhe financiar;

- Vendosja e AA-së (Autoriteti i Auditimit) dhe GA-së (Grupi i Audituesve), për zbatimin, menaxhimin financiar dhe monitorimin e përditshëm të Programit;

- Përgatitja dhe zbatimi i thirrjeve për propozime, duke përfshirë zhvillimin e dokumenteve udhëzuese, që përcaktojnë kushtet për mbështetjen e proceseve, kriteret e pranueshmëisë dhe prioritetet në përzgjedhjen e projekteve;

- Krijimi dhe vënia në zbatim e procedurave për vlerësimin e cilësisë, monitorimin dhe kontrollin e proceseve të zbatuara në kuadër të Programit të Bashkëpunimit, me ndihmën e ekspertëve të jashtëm kur është e nevojshme;

- Zhvillimin e procedurave që kontribuojnë në uljen e barrës administrative për përfituesit, të tilla si rregulloret e përbashkëta ofrimit me programe të tjera ETC, futja e menaxhimit të standardizuar dhe mjetet monitoruese, formate të gatshme dokumentesh, dhe dixhitalizimi i tyre;

- Mbledhja e të dhënave në lidhje me ecurinë e Programit në arritjen e objektivave të tij, të dhënat financiare dhe ato që lidhen me treguesit dhe aksionet që shënojnë ndryshime të rëndësishme, dhe raportimi i tyre ndaj Komitetit të Monitorimit dhe Komisionit Evropian;

- Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Komunikative të Programit, duke përfshirë këtu vendosjen dhe zbatimin e masave komunikative dhe informative dhe mjetet e duhura sipas asaj që parashikon neni 115 i Rregullores (BE-së) 1303/2013 (CPR);

- Hartimi dhe zbatimi i planit të vlerësimit të programit dhe vëzhgimi i informacioneve të vlerësimeve të pavarura të programit;

- Krijimi, drejtimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të kompjuterizuar për të regjistruar dhe për të ruajtur të dhënat e çdo veprimi të nevojshëm për monitorim, vlerësim, menaxhim financiar, kontroll dhe verifikim, në përputhje me kërkesat e zbatueshme elektronike shkëmbimit të të dhënave dhe të kontribuojnë në uljen e barrës administrative për përfituesit;

Ngritja e një rrjeti kombëtar kontrolluesish të nivelit të parë, të koordinuar nga MA / Sekretariati i përbashkët, në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 1299/2013, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe praktikave më të mira në nivel CBC.

- Ngritja dhe zbatimi i kontrolleve mbi programin e menaxhimit, sistemin e kontrolleve dhe proceset;

- Trajnim për organet e programit;

- Organizim i ngjarjeve dhe konferencave, si dhe prodhimi i materialeve promociionale në nivel kombëtar për shpërndarjen e aktiviteteve të Programit.

Për ngritjen e menaxhimit dhe monitorimit të strukturave të saj (Sekretariatit të Përbashkët, Pikat Kombëtare të Informacionit në Shqipëri dhe Malin e Zi, FLC, njësia e asistencës teknike të Autoritetit Certifikues, Autoriteti Menaxhues, Autoriteti i Auditimit dhe Autoriteti Kombëtar), Programi parashikon rekrutimin e stafit, rogat e të cilëve do të paguheshin nga burimet e Asistencës Teknike të Programit

Qëllimi specifik 5.2: Aksionet për të përmirësuar mbështetjen ndaj aplikanteve dhe përfituesve dhe për të forcuar përfshirjen e partnerëve përkatës në zbatimin e Programit.

Në përputhje me nenin 59 të Rregullores (BE-së) 1303/2013 (CPR), aktet brenda qëllimit specifik 5.2 synojnë rritjen e numrit të aplikuesve dhe përfituesve për të përdorur fondet, si dhe përfshirjen e partnerëve përkatës, duke përfshirë edhe shkëmbimin e praktikave të mira midis tyre.

Aksionet indikative mbështetur në qëllimin specifik 5.2 janë renditur më poshtë dhe i referohen parimeve dhe detyrave të përshkruara në seksionin 5.

- Hartimi i dokumenteve të informacionit për aplikantët dhe përfituesit me qëllimin për t'i udhëzuar ata në përgatitjen e aplikacioneve dhe zbatimin e tyre, vlerësimin, kontrollin dhe komunikimin e proceseve të miratuara;

- Organizimi i konsultimit, informacionit, trajnimit dhe eventeve shkëmbyese për të rritur;

numrin e aplikantëve për zhvillimin e aplikacioneve duke kontribuar drejtpërdrejtë në programin “Qëllimet specifike” dhe rezultatet e pritshme;

- Organizimi i trajnimeve për çështje specifike zbatimi, të tilla si: menaxhim projekti dhe finan-cimi, raportim, kontroll, auditim, rrjet dhe komunikim për shkrimin e numrit të përfituesve në zbatimin e proceseve të miratuara;

- Organizimi i vizitës monitoruese për projektet në proces zhvillimi të kryera nga Sekretariati i Përbashkët synon kryerjen e vlerësimit të cilësisë së produkteve / rezultateve, dhe mundësinë për të kërkuar përmirësime.

- Zhvillimi i informacionit dhe mjeteve shkëmbyese (p.sh.: dokumente analitike, takimet bilaterale, eventet e synuara etj.) dhe organizimi i CBC-së dhe eventeve kombëtare për të forcuar përfshirjen e partnerëve përkatës në zbatimin e programit (duke përfshirë edhe autoritetet e përfshira në zhvillimin ose zbatimin e strategjive makrorajonale, organet e përbashkëta ligjore që veprojnë në zonën (EGTC...) dhe organizatat ombrellë (lidhje mes organizatash që bashkëpunojnë për koordinimin e aktiviteteve) në nivel EU/CBC;

Krijimi i një rrjeti të Pikave Kombëtare të Informacionit në vendet pjesëmarrëse, duke bashkëpunuar me Sekretariatit e Përbashkët dhe Autoritetet Kombëtare përgjegjëse për Programin e Bashkëpunimit;

- Kryerja e studimeve, raporteve dhe sondazheve mbi çështjet strategjike në lidhje me Programin që mund të kontribuojnë në: qëndrueshmëri, arritje rezultatesh, hartim politikash, strategji, investime me interes publik, nëse është e nevojshme me ndihmën e ekspertëve.

Në zbatimin e aktiviteteve menaxhuese dhe monitoruese, të gjitha strukturat dhe organet e Programit të renditura në seksionin 5.3 do të financohen me anë të burimeve të disponueshme të Asistencës Teknike të këtij objekti specifik.

SEKSIONI 3. PLANIFIKIMI FINANCIAR

(Referencë: shkronja “d” e nenit 8, pika 2, e Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

3.1. SHUMA FINANCIARE NGA IPA (në EURO)

(Referencë: shkronja “d” dhe “i” e nenit 8, pika 2, e Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Tabela 15 (duke përfshirë ERDF-në) Fondin Evropian për Zhvillimin Rajonal

Fondi	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	TOTAL
IPA		5.707.102	8.150.102	18.717.298	15.104.862	15.406.960	15.715.098	78.801.422

3.2.A. SHUMA FINANCIARE TOTALE NGA IPA DHE BASHKËFINANCIMI KOMBËTAR (në EURO)

(Referencë: shkronja “d” dhe “ii” e nenit 8, pika 2, e Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Tabela 16: Planifikimi financiar (duke përfshirë ERDF-në)

Aksi prioritar	Baza për llogaritjen e mbështetjes nga BE-ja	Mbështetje BE (a)	Homolog kombëtar (b) = (c) + (d)	Ndarje indikative e homologut kombëtar		Financimi total (e) = (a) + (b) (2)	Raporti i bashkëfinancimit (f) = (a)/(e)	Për informacion	
				Financimi publik kombëtar	Financimi privat kombëtar			Kontributet nga vendet e treta	Kontributet nga BEI
AP 1	Total	15.760.284	2.781.227	2.224.981	556.246	18.541.511	84,99999		
AP 2	Total	22.064.398	3.893.718	3.504.346	389.372	25.958.116	84,9999976886%		
AP 3	Total	19.700.356	3.476.534	2.781.227	695.307	23.176.890	84,9999978427%		
AP 4	Total	13.396.242	2.364.043	1.891.234	472.809	15.760.285	84,9999984137%		
AP 5	Publik	7.880.142	1.390.614	1.390.614		9.270.756	84,9999935280%		
TOTAL		78.801.422	13.906.136	11.792.402	2.113.734	92.707.558	84,9999975191%		

(1) Të plotësohet vetëm kur akset prioritar shprehen në kostot totale.

(2) Kjo normë mund të rumbullakohet me numrin më të afërt në tabelë. Shkalla e saktë që përdoret për të rimbursuar pagesat është raporti (f).

3.2.B. NDARJA SIPAS AKSIT PRIORITAR DHE PRIORITETIT TEMATIK

(Referencë: shkronja “d” dhe “ii” e nenit 8, pika 2, e Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Tabela 17

	PRIORITETI TEMATIK	MBËSHETJA E UNIONIT	HOMOLOGU KOMBETAR	TOTALI
Aksi prioritar 1	PT G	15.760.284	2.781.227	18.541.511
Aksi prioritar 2	PT D	22.064.398	3.893.718	25.958.116
Aksi prioritar 3	PT B	19.700.356	3.476.534	23.176.890
Aksi prioritar 4	PT C	13.396.242	2.364.043	15.760.285
Aksi prioritar 5		7.880.142	1.390.614	9.270.756

TOTALI		78.801.422	13.906.136	92.707.558
---------------	--	-------------------	-------------------	-------------------

REZERVONI jo më pak se 50% të shumës totale të burimeve financiare për thirrjet tematike dhe projektet strategjike.

SEKSIONI 4: QASJE E INTEGRUAR PËR ZHVILLIMIN TERRITORIAL (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME)

(Referenca: Neni 35 (2) i Rregullores Zbatuese IPA II dhe neni 8 (3) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Përshkrimi i qasjes së integruar për zhvillimin territorial, duke marrë parasysh përmbajtjen dhe objektivat e programit të bashkëpunimit dhe duke treguar sesi kontribuon në arritjen e objektivave të programit dhe rezultateve të pritshme.

Strategjia e programit evidenton sfidat territoriale të përbashkëta në të gjithë zonën e bashkëpunimit duke reflektuar nevojat e përbashkëta ndërkufitare dhe potencialet që mund të trajtohen në mënyrë efektive nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar dhe miratimin e një qasjeje të integruar për zhvillimin territorial.

Kjo qasje ka një dimension të dyfishtë, duke kombinuar një perspektivë horizontale (integrimin e sektorëve të ndryshëm të ndërhyrjes: turizëm-mjedis-transport, NVM-ve kulturë-turizëm, efikasitetin e energjisë- riskun e mbrojtjes etj.) me një integrim vertikal të niveleve të ndryshme institucionale, programe interesante dhe strategjitë e zbatuara në zonën e bashkëpunimit. Zhvillimi i integruar territorial do të garantohet nga një numër mjetesh duke siguruar pjesëmarrjen në proceset e vendimmarrjes, duke lehtësuar punën e përbashkët të menaxhimit të programeve dhe implementimin e strukturave (si p.sh.: Autoriteti Menaxhues, Komiteti Monitorimit, Koordinatorët IPA) dhe përfshirjen e tyre në ngjarjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Programi do të inkurajojë sinergji në mes të niveleve të ndryshme të qeverisjes, integrimin e programeve dhe fondeve, për ndarjen e veprimeve të përbashkëta të implementimit dhe përputhshmërinë e tyre me strategjitë makrorajonale (në veçanti EUSAIR).

Secili prej prioriteteve të përzgjedhura do të trajtojë nevojat specifike dhe potencialet e zhvillimit të zonës së programit, në koherencë dhe komplementaritet me Marrëveshjen e Partneritetit Italian dhe dokumentet strategjike të shteteve partnere të IPA-s, duke arritur synimin e “Investimeve për zhvillim dhe punë”, siç tregohet më poshtë:

- Prioriteti 1: Zona e Programit ka një prani të rëndësishme të NVM-ve, me një nevojë të lartë të konkurrencës dhe inovacionit; Fuqia ekonomike është e shpërndarë në mënyrë të pabarabartë në zonë, me Investime për Kërkimin dhe zhvillim të përqendruara në disa pole të rritjes dhe zona periferike /rajone me konkurrencë të ulët dhe transferimi teknologjie të kufizuar. Ky prioritet synon reduktimin e pabarazive rajonale forcimin e lidhjeve brenda dhe midis rajoneve, duke mbështetur rrjetet e inovacionit në disa sektor të rëndësishëm siç janë ekonomia blu dhe agro-biznesi. Aksionet e pritshme kanë për qëllim stimulimin e investimeve të NVM-ve në inovacione, fuqizimin e dimensioneve ndërkufitare dhe qasjet në tregjet ndërkombëtare.

- Prioriteti 2: Trashëgimia natyrore dhe kulturore përfaqëson faktorë të rëndësishëm të zhvillimit rajonal; nëse integrohen në një strategji të qëndrueshme të marketingut territorial, mund të jetë një drejtues i fortë ekonomik i zonës së programit. Prioriteti synon përmirësimin e atraktivitetit të aseteve natyrore dhe kulturore, duke i lidhur ato me oferta turistike, si edhe duke zhvilluar produkte të reja novatore kulturore/ krijuese që, në vitet e fundit, po drejtojnë ekonominë e re.

- Prioriteti 3: Të dyja ndërhyrjet e objektivave strategjikë që trajtohen janë adresuar për të përmirësuar menaxhimin e burimeve natyrore (veçanërisht në ujë dhe energji) përmes promovimit/miratimit të mjeteve të reja të përbashkëta rregullues dhe standardeve që kërkojnë një qasje të integruar në qeverisjen territoriale. Menaxhimi i qëndrueshëm do të kontribuojë për të minimizuar ndikimin e ndryshimeve klimaterike dhe rrezikun mjedisor (p.sh. duke luftuar kundër ndotjes në brendësi të vendit dhe ndotjes së ujërave bregdetare apo rritja e përdorimit të RES-it).

- Prioriteti 4: Zona karakterizohet nga një fragmentim i lartë, lidhje të kufizuara me zonat periferike dhe ndërveprim të ulët ndërmjet sistemeve të transportit. Prioriteti trajton këto çështje duke përmirësuar koordinimin e sistemeve të transportit të pasagjerëve dhe mallrave me rajonet dhe në të gjithë kufijtë dhe duke përmirësuar koordinimin midis palëve të interesuara të transportit të mallrave për zgjidhje të shumëllojshme të transportit të mallrave ekologjike.

Analiza territoriale ka theksuar fragmentim të lartë në zonën e Programit, duke identifikuar dallimet të forta ndërmjet rritjes në zonat urbane dhe rënie në zonat periferike. Zonat bregdetare përfaqësojnë një nivel

të lartë tërheqjeje, një përqendrim shumë të rëndësishëm të aktiviteteve të njeriut dhe brishtësinë e burimeve natyrore dhe kulturore; nga ana tjetër, në zonat e populluara rurale dhe të ulëta, turizmi dhe bujqësia paraqesin aktivitetet themelore ekonomike të cilat shpesh janë të kërcënuara nga ndryshimet demografike dhe ato klimaterike. Prioritetet e dedikuara zhvillimit ekonomik, menaxhimit më të mirë të burimeve natyrore dhe pasojave të ndryshimeve klimaterike do të trajtojnë këto sfida. Nuk janë identifikuar zona urbane të veçanta për të zbatuar një zhvillim të qëndrueshëm urban. Partnerët e të gjitha zonave urbane të vendosura në rajonet përfituese të programit mund të marrin pjesë në projekte, duke ndjekur rekomandimet e dhëna në akset e ndryshme prioritare dhe në thirrjet për propozime. Sfidat e veçanta që pasqyrojnë nevojat e zonave të caktuara të programit do të trajtohen edhe përmes thirrjeve të synuara.

4.1 ZHVILLIMI I UDHËHEQUR NGA KOMUNITETI VENDOR (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME)

Qasja për përdorimin e instrumenteve për zhvillimi i udhëhequr nga Komuniteti Vendor dhe parimeve për identifikimin e zonave ku do ato do të zbatohen.

Referencë: Neni 35 (2) i Rregullores për implementimin e IPA II dhe pika (a) e nenit 8 (3) të Rregullores së BE-së nr. 1299/2013

I pazbatueshëm

4.2 INVESTIMET TERRITORIALE TË INTEGRUARA (ITI) (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME)

Qasje për përdorimin e Investimeve Territoriale të Integruara (ITI) (siç përcaktohet në nenin 36 të Rregullores së BE-së nr. 1303/2013), ndryshe nga rastet e përfshira në pikën 4.2 dhe alokimin indikativ financiar të tyre nga çdo aks prioritar.

Referencë: Neni 35 (2) i Rregullores për implementimin e IPA II dhe pika (c) e nenit 8 (3) të Rregullores së BE-së nr. 1299/2013

I pazbatueshëm

4.3 KONTRIBUTI I NDËRHYRJEVE TË PLANIFIKUARA PËR STRATEGJITË MAKORAJONALE DHE BASENIT DETAR

Kontributi i ndërhyrjeve të planifikuara për strategjitë makrorajonale dhe basenit detar janë subjekt i nevojave të zonës së programit si të identifikuar nga shtetet partnere dhe duke marrë në konsideratë, kur janë të zbatueshme, projekte strategjike të rëndësishme të përcaktuara në ato strategji (kur është e nevojshme) (ku shtetet dhe rajonet marrin pjesë në strategjitë makrorajonale dhe/ose basenit detar).

(Referencë: pika (d) e nenit 8 (3) të Rregullores së BE-së nr. 1299/2013)

Strategjia e Programit INTERREG IPA II CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi është zhvilluar me kontributin e aksionerëve dhe ekspertëve të kërkimit dhe duke marrë parasysh punën përgatitore për përcaktimin e planit të veprimit EUSAIR Dokument Pune i Stafit (DPS (2014) 190 final).

Koherenca me Marrëveshjet e të Partneritetit dhe PDK-në e vendeve të IPA-s, përkatësisht është verifikuar duke synuar koordinimin me rrjedhën e ndërhyrjeve ERDF dhe IPA II; orientimi tematik i fokusuar i Programit reflekton konsensusin e përgjithshëm të vendeve pjesëmarrëse.

Programi Interreg II IPA CBC Itali - Shqipëri - Mali i Zi përputhet pjesërisht dhe është i përfshirë plotësisht në Zonën gjeografike EUSAIR, kjo do të thotë se Programi do të jetë dakord për zbatimin e Planit të Veprimit EUSAIR.

Dhe, në fakt, krahas analizës specifike të Programit Territorial duke theksuar nevojat e zhvillimit të zonës, dokumentet EUSAIR janë konsultuar për elemente të tjera frymëzuese, me qëllim të një konvergjence më të gjere mes temave, veprimeve, rezultateve dhe kontributeve dhe në koherencë me këshillat e vendeve makrorajonale për të bërë një përdorim më të mirë të burimeve, legjislacioneve dhe institucioneve ekzistuese.

Të dy EUSAIR dhe Programi Strategjik Interreg II IPA CBC Itali - Shqipëri - Mali i Zi mbështeten në një qasje të integruar, dhe Programi i tanishëm do të zhvillojë projekte operationale që synojnë zbatimin e strategjisë EUSAIR në bazë të kapaciteteve të institucioneve ekzistuese dhe aksionerëve territorialë që bashkëpunojnë në rajon.

Në kushtet e korrespondencës së EUSAIR dhe objektivave të Programit:

AP1. OS 1.1 Ka për qëllim dhënien e një kuadri më të mirë rregullator me qëllim krijimin e “kushteve mjedisore” për të stimuluar investimet në zonën e Programit, nga ana tjetër një ndërveprim të forcuar mes

organizatave mbështetëse të biznesit dhe NVM-ve, duke promovuar ndërkombëtarizimin dhe inovacionin përmes rrjeteve, bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave mes palëve të interesuara. Mbi të gjitha, duke pasur parasysh prioritetin ndërsektorial përmendur këtu, aksionet do të synojnë forcimin dhe fuqizimin e grupeve novatore dhe rrjeteve, duke theksuar dimensionin e tyre ndërkufitar, kryesisht në fushën e ekonomisë blu, bujqësisë së qëndrueshme, përpunimit të ushqimit, ekonomisë e gjelbër dhe inovacioneve sociale.

OS 1.1 Duke vepruar në “mjedisin e biznesit” ndërkufitar dhe konkurrencës së NMV-ve, ka një koherencë me “rritjen blu” në kolonën 1 të Planit të Veprimit të EUSAIR-it dhe çështje vendore-sektoriale “Ndërtimi i kapaciteteve” dhe “Inovacioni kërkimor dhe zhvillimi i NMV-ve”.

AP 2. Të dy objektivat strategjikë janë duke pranuar trashëgiminë e pasur natyrore dhe kulturore të zonës së Programit qoftë si aset i rritjes së turizmit, por edhe si vlerë për të. Aplikimi i një qasjeje të integruar për trashëgiminë natyrore dhe kulturore do të jetë i lidhur në mënyrë rigoroze me vlerën e shtuar ekonomike dhe vlerësimin e turizmit të qëndrueshëm. Aksionet duhet të ndërtohet mbi njohuritë, aftësitë dhe asetet e trashëgimisë, të cilat do të lidhin dhe promovojnë destinacionet më pak të njohura të zonës. Qasja trajton në mënyrë direkte edhe industrinë krijimtarisë si drejtues për rritjen e ekonomisë dhe atraktivitetin e zonës së Programit.

OS.2.1 Është koherente me kolonën 4 të planit të veprimit të EUSAIR-it, kryesisht në mbështetje të: a) ndërtesës së përbashkët të një marke turizmi/territorial; b) ofertave të qëndrueshme dhe të arritshme turistike; c) programeve turistike tematike; d) nxitjes së trashëgimisë kulturore; e) përmirësimit të produkteve turistike. Për më tepër, OS-të janë në të njëjtën vijë me çështjen ndërsektoriale të EUSAIR-it “Ngritje e kapaciteteve”.

OS.2.1 Është koherente me kolonën 4 të planit të veprimit të EUSAIR-it, kryesisht në mbështetje të: a) nxitjes së trashëgimisë kulturore në një rajon ndër kufitar. Për më tepër, OS-të janë në të njëjtën vijë me çështjen ndërsektoriale të EUSAIR-it “Ngritje e kapaciteteve”.

AP3. Aksi prioritar trajton nevojën për rritjen e strategjive të bashkëpunimit ndërkufitar në hapësirat ujore, për të reduktuar emetimin e karbonit dhe për të miratuar standardet e efikasitetit të energjisë dhe praktikën në sektorin publik, duke përfshirë edhe nevojat e minimizimit të ndikimit të ndryshimeve klimatike, reduktimin e rreziqeve mjedisore, të tilla si: hidrogeologjike, ndotja në brendësi dhe në ujërat bregdetare, mungesa e ujit, emetimi i CO₂ etj.

OS.3.1 Është koherente me kolonën 3 të planit të veprimit të EUSAIR-it, në lidhje me dy temat e saj:

1. Mjedi detar
2. Habitatet tokësore dhe biodiversiteti

Për më tepër, OS-të janë në të njëjtën vijë me çështjen ndërsektoriale të EUSAIR-it “Ndërtimi i kapaciteteve”.

OS 3.2 Është në përputhje me kolonën 2 të planit të veprimit të EUSAIR-it, duke iu referuar temës së tij “Rrjetet e energjisë” pasi të dyja ndërhyrjet e plotësojnë njëra tjetrën dhe mund të prodhojnë një rritje më të zgjuar dhe më të qëndrueshme në nivel e zonës së Programit.

Për më tepër, OS-të janë në të njëjtën vijë me çështjen ndërsektoriale të EUSAIR-it “Ndërtimi i kapaciteteve”.

AP4. Aksi prioritar përmban një dimension territorial në vetvete, duke trajtuar lidhjen me detin Adriatik. Programi fokusohet në multimodalitetin, logjistikën, transportin mjedisor dhe lëvizshmërinë, duke kontribuar në këtë mënyrë në përputhje me përdorimet dhe nevojat e ndryshme mes rajoneve dhe përdoruesve, duke iu referuar njerëzve dhe mallrave transportit.

OS4.1 Është në përputhje me kolonën 2 të planit të veprimit të EUSAIR-it, duke iu referuar temave të mëposhtme:

1. Transporti detar
2. Lidhjet intermodale të brendshme

Përveç kësaj, OS-të janë në të njëjtën vijë me çështjen ndërsektoriale të EUSAIR-it “Ndërtimi i kapaciteteve”.

Në mënyrë për të siguruar ndikim maksimal të aktiviteteve të Programit për implementimin e Strategjisë EUSAIR, përfshirjen dhe konsultimin e organeve qeverisëse të EUSAIR-it (Bordit drejtues dhe të Komitetit Drejtues Tematik) do të sigurohet gjatë gjithë kohëzgjatjes së Programit në fazat më të rëndësishme të planifikimit dhe zbatimit të tij, të tilla si: thirrje për propozime hartimi, vlerësime të projekteve strategjike,

pjesëmarrje në mbledhjet e Komitetit të Përbashkët të Monitorimit. Në përputhje me këto, programi do të monitorojë këto nisma etiketuar në kuadër të planit EUSAIR, duke paraqitur kriteret e vlerësimit që i japin përparësi projekteve koherente me strategjinë EUSAIR.

Kapitalizmi dhe aktivitet e komunikimit, si dhe implementimi i projekteve mund të parashikojë përfshirjen apo konsultimin e programeve të tjera të bashkëpunimit territorial të BE-së, siç janë Programet MED dhe ADRION.

Autoriteti Menaxhues do të sigurojë koherencën dhe plotësimin me instrumentet përkatëse të BE-së dhe të financimit kombëtar që kontribuojnë në objektiva të njëjtë ose të ngjashëm të programit të bashkëpunimit apo që plotësojnë ndërhyrjet e tij.

Përveç kësaj, Programet rajonale tashmë parashikojnë lidhje me këtë CP IPA dhe EUSAIR; autoritetet përkatëse të menaxhimit së bashku me koordinatorët e IPA-s të Shqipërisë dhe Malit të Zi, do të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit të Monitorimit në mënyrë që të vënë në vend një mekanizëm të fortë koordinimi dhe të sigurojë një përputhje mes programeve të ndryshme operative të vendeve pjesëmarrëse. Gjithashtu, edhe referenti italian i Marrëveshjes së Partneritetit do të marrë pjesë në Komitetin e Monitorimit.

SEKSION I 5: DISPOZITAT ZBATUESE PËR PROGRAMIN E BASHKËPUNIMIT

(Referencë: neni 8, pika 4, të Rregullores (BE) nr. 1299/2013 siç referohet në nenin 34, pika 1, të Rregullores (BE) nr. 447/2014)

5.1 AUTORITETET DHE ORGANET PËRKATËSE

Autoriteti /organi	Emri i autoritetit/ organit dhe departamenti ose njësia	Kryetari i autoritetit /organit
Autoriteti Menaxhues	Rajoni Pulia – Departamenti i Mesdheut – Zyra e Autoritetit Menaxhues	Drejtor i Zyrës së Autoritetit Menaxhues
Autoriteti Certifikues	Rajoni Pulia – Zyra e Autoritetit të Certifikimit e Financave dhe Kontrollit të Zonës Itali	Drejtori i përgjithshëm
Autoriteti i Auditimit	Rajoni Pulia- Zyra e Auditit të Politikave Evropiane dhe Kontrollit Itali	Rajoni Pulia – Drejtori i Zyrës së Auditit të Politikave Evropiane dhe Kontrollit

Autoriteti Certifikues është organi tek i cili do të bëhen pagesat nga Komisioni.

(Referencë: shkronja “b”, të nenit 8, pika 4, të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Tabela 20: Organi ose organet që kryejnë detyrat e kontrollit dhe auditimit

(Referencë: shkronjat “a”, “ii” dhe “iii”, të nenit 8, pika 4, të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Autoriteti /organi	Emri i autoritetit/ organit dhe departamenti ose njësia	Kryetari i autoritetit /organit
Organ ose organe të caktuara për të kryer detyrat e kontrollit	Itali Për Italinë, Autoritetit Menaxhues -kryen verifikimet në lidhje me përfituesit në territorin e tij, në përputhje me nenin 125 (4) (a) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 (CPR) dhe nenin 23 (4) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013 përmes një sistemi të decentralizuar të regjistrat të audituesve. Shqipëri Në Shqipëri, Sistemi i Centralizuar i Kontrollit të Nivelit të Parë aplikon verifikimet e kryera sipas nenit 37 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014. Verifikimet kryhen nga Ministria e Integritetit Evropian nëpërmjet	Itali Drejtori i zyrës së Autoritetit Menaxhues Shqipëri Drejtori

	kontrollorëve të kontraktuar (financuar nga burime të disponueshme për Asistencën Teknike Mali i Zi Në Malin e Zi, Sistemi i Kontrollit të Nivelit të Parë i centralizuar aplikohet për Verifikimet e kryera sipas nenit 37 Rregullores Zbatuese (BE) nr. 447/2014. Verifikimet kryhen nga një kontrollor i kontraktuar nga ministri i Financave, Fond (CFCU).	Mali i Zi Drejtori i përgjithshëm dhe kontraktuesi i Fondit të Asistencës
Organi ose organet e caktuara për të kryer detyrat e auditimit	Autoriteti Auditues ndihmohet nga një Grup Audituesish (GoA). Çdo vend pjesëmarrës cakton organin ose personin përgjegjës për kryerjen e detyrave të auditimit të parashikuara në nenin 127 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013. Çdo vend pjesëmarrës i Programit është përgjegjës për auditimet e kryera në territorin e tij. Kompani e jashtme auditimi mund të kontraktohet për të kryer auditime për funksionimin e duhur të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit dhe për modelin e duhur të projekteve.	Organi përgjegjës përfshihet në Marrëveshjen që do të nënshkruhet nga çdo vend pjesëmarrës pas miratimit të Programit të Bashkëpunimit. Anëtari shqiptar i grupit të auditit do të jetë përfaqësues i Agjencisë për auditin e Sistemit të Zbairit të Programeve të BE-së. Kjo agjenci akreditohet në përgjegjësi të Ministrisë së Financave. Për Malin e Zi, detyrat e auditit do të kryhen nga Autoriteti Auditues i Malit të Zi (Beogradska 24b, 81000 Podgorica), nën përgjegjësinë e Audituesit të Përgjithshëm.

5.2 PROCEDURA PËR NGRITJEN E SEKRETARIATIT TË PËRBASHKËT

(Referenca: shkronja “a” (iv) e nenit 8, pika 4, të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Sekretariati i Përbashkët ngrihet në marrëveshje me vendet pjesëmarrëse në Programin INTERREG IPA II CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi, nën përgjegjësinë e Autoritetit Menaxhues.

SP-ja vendoset në Bari, në ambientet e vëna në dispozicion në Departamentin e Mesdheut, Bashkëpunimi ndërrajonal dhe Zyra e Evropës Juglindore të Rajonit të Pulias.

SP-ja ndihmon Autoritetin Menaxhues dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit në kryerjen e detyrave të tyre të përkatëse. Ai, gjithashtu, siguron informacion për të gjithë përfituesit potencialë për mundësitë e financimit të Programit të Bashkëpunimit dhe ndihmon Përfituesit Kryesorë në zbatimin e propozimeve të projekteve të zgjedhura.

Autoriteti Menaxhues nis procedurën e përzgjedhjes për rekrutimin e stafit të SP-së përmes konkurrimit të hapur, duke marrë parasysh termat e referencës rënë dakord nga KPM-ja, që përcaktojnë përshkrimet individuale të punës. Procedurat kontraktuese me kandidatët e përzgjedhur zbatohen në përputhje me legjislacionin italian përkatës dhe sigurojnë një trajtim të barabartë për të gjithë stafin e SP-së. Këto rekrutime janë të hapura për kandidatë nga çdo shtet anëtar i BE-së dhe nga çdo vend pjesëmarrës në Programin INTERREG IPA II CBC.

Itali-Shqipëri-Mali i Zi. Përfaqësimi ndërkombëtar i zonës së bashkëpunimit është i garantuar.

SP-ja përbëhet nga ekspertë ndërkombëtarë të jashtëm, rekrutuar nëpërmjet rregullave të prokurimit publik, që mbulojnë funksionet e mëposhtme:

- Koordinator i SP-së;
- Eksperti ligjor dhe administrativ;
- Eksperti financiar;
- Eksperti i komunikimit;
- Menaxherët e projektit;
- Sekretari operacional.

Për rekrutimin e stafit të Sekretariatit të Përbashkët merren në konsideratë parimet e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit.

5.3 PËRSHKRIMI PËRMBLEDHËS I MENAXHIMIT DHE MARRËVESHJEVE TË KONTROLLIT

(Referenca: shkronja “a” (v), e nenit 8, pika 4, e Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Paragrafi i mëposhtëm përshkruan strukturën e zbatimit të Programit INTERREG II IPA CBC Itali-

Shqipëri-Mal i Zi 2014–2020 dhe, veçanërisht, organet që veprojnë si Autoriteti Menaxhues (AM), Autoriteti Certifikues (AC), Autoriteti i Auditimit (AA) dhe Sekretariati i Përbashkët (SP). Ai, gjithashtu, përcakton detyrat e secilit prej organeve të angazhuara, duke përfshirë KPM-në dhe përshkruan marrëdhëniet ndërmjet organeve të ndryshme në proceset e ndryshme të nevojshme për zbatimin e Programit të Bashkëpunimit.

Gjuha e Programit është gjuha angleze.

Italia, Shqipëria dhe Mali i Zi, të cilat janë vendet pjesëmarrëse në Programin INTERREG II IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi 2014–2020, në përputhje me përgjegjësitë e tyre përkatëse të përcaktuara në Rregulloren (BE) nr. 1303/2013, Rregullorja (BE) nr. 1299/2013 dhe Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 447/2014 pritet të krijojnë një sistem të përbashkët të menaxhimit për të menaxhuar, koordinuar dhe mbikëqyrur zbatimin e Programit të Bashkëpunimit.

Menaxhimi i këtij Programi ndjek strukturën e menaxhimit të zbatueshëm për një Program të Fondeve Strukturore. Për sa u përket vendeve pjesëmarrëse të IPA-s, ai zbaton nenin 9, pika 3, të Rregullores (BE) nr. 231/2014 që themelon Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II) dhe nenin 34 të Rregullores (BE) nr. 447/2014 mbi rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 231/2014, e cila në mënyrë të qartë i referohet Rregullores (BE) nr. 1299/2013 (CTE). Si rezultat i kësaj, parimet e përgjithshme për marrëveshjet e menaxhimit dhe kontrollit specifikohen në nenin 72 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

5.3.1 STRUKTURA E PËRBASHKËT PËR ZBATIMIN DHE NDARJA E DETYRAVE NDËRMJET ORGANEVE TË NDRYSHME KOMITETI I PËRBASHKËT I MONITORIMIT (KPM)

Funksionet kryesore të KPM-së janë të specifikuara në nenin 49 dhe në nenin 110 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 dhe në nenin 38 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014.

Në përputhje me nenin 47 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 dhe nenin 38 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014, shteti anëtar dhe vendet pjesëmarrëse në Programin INTERREG IPA II CBC

Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014–2020, dhe në marrëveshje me Autoritetin Menaxhues, ngrenë Komitetin e Përbashkët të Monitorimit (KPM) brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit për miratimin e Programit të Bashkëpunimit.

KPM harton rregulloret e tij brenda kuadrit institucional, ligjor dhe financiar të vendeve pjesëmarrëse në fjalë dhe i miraton ato në mbledhjen e tij të parë në marrëveshje me AM-në në mënyrë që të ushtrojë detyrat e tij në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 1303/2013, Rregulloren (BE) nr. 1299/2013 dhe Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014. Rregulloret përmbajnë një përshkrim të detajuar të përbërjes, funksionimit dhe detyrave, si edhe procesin e vendim-marrjes të KPM-së.

Anëtarët e KPM-së përfaqësojnë shtetin anëtar dhe vendet pjesëmarrëse të Programit në nivelin politik dhe administrativ, si edhe për të siguruar një qasje transparente.

Përbërja e Komitetit të Përbashkët të Monitorimit

Në përputhje me nenin 48, pika 1, të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 dhe nenin 38, pika 2, të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014, është rënë dakord nga shteti anëtar dhe nga vendet pjesëmarrëse në programin e bashkëpunimit për përbërjen e KPM-së të Programit. Çdo vend pjesëmarrës përfaqësohet në mënyrë të barabartë dhe në përputhje me parimin e partneritetit për menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e propozimeve të projektit në të gjitha fazat e zbatimit të programit.

KPM-ja kryesohet nga një përfaqësues i vendit pjesëmarrës ose nga Autoriteti Menaxhues. Aplikohet parimi i rotacionit.

Vendimet e KPM-së merren me konsensus, ku secili vend pjesëmarrës ka një votë. Vendimet mund të merren përmes procedurës me shkrim. KPM-ja mbledhet të paktën një herë në vit.

KPM-ja përbëhet nga katër përfaqësues për çdo vend pjesëmarrës në nivelin e duhur të qeverisjes (kombëtar, rajonal apo lokal), dhe përfshin edhe përfaqësues të:

- Komisionit Evropian, që marrin pjesë në kapacitet këshillues;
- Koordinatorët IPA të Shqipërisë dhe Malit të Zi
- Autoritetet drejtuese të programeve rajonale italiane, së bashku me referentin (personin konsultues) të Marrëveshjes së Partneritetit.
- Referentët kombëtarë të EUSAIR-it të vendeve pjesëmarrëse.

- Autoriteti Menaxhues dhe Autoriteti Certifikues, që marrin pjesë në kapacitet këshillues;
- SP-ja, që siguron mbështetje sekretariale për KPM-në dhe që merr pjesë në kapacitet këshillues;
- Autoriteti i Auditimit, që mund të marrë pjesë si vëzhgues i pavarur;
- Partnerët ndërkufitarë ekonomik dhe social dhe organizatat dypalëshe joqeveritare, të cilët mund të marrin pjesë në kapacitet këshillues, siç specifikohet në rregulloren e brendshme dhe në përputhje me kodin e sjelljes të partneritetit;

- Aktorë të tjerë institucionalë dhe territorialë, duke përfshirë përfaqësues të shoqërisë civile.

Lista e anëtarëve të KM-së publikohet në faqen e internetit të programit; marrëveshjet e tjera për transparencën e vendimeve të KM-së do të shfaqen në rregulloren e brendshme.

Roli dhe detyrat e Komitetit të Përbashkët të Monitorimit

KPM-ja drejton Programin e Bashkëpunimit dhe shqyrton të gjitha çështjet që ndikojnë në performancën e Programit, për të siguruar cilësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien e zbatimit të tij.

KPM-ja shqyrton zbatimin e Programit dhe progresin drejt arritjes së objektivave të tij dhe, në detaje, kryen funksionet e tij në përputhje me nenin 49 dhe nenin 110 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

KPM-ja miraton metodologjinë, kriteret për përzgjedhjen e propozimeve të projekteve dhe rregullat e përshtatshmërisë para fillimit të çdo thirrje për propozime. KPM-ja përzgjedh propozimet e projektit të financuara nga Programi i Bashkëpunimit në përputhje me nenin 12 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013 dhe me nenin 39 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014.

KPM-ja miraton listën e propozimeve/ operacioneve të projekteve që do të financohen në kuadër të Programit të Bashkëpunimit.

KPM-ja kontrollon vlefshmërinë e përshkrimit të sistemit të menaxhimit dhe të kontrollit që formon bazën për përcaktimin e autoriteteve të Programit sipas nenit 124, pikës 2, të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

AUTORITETI MENAXHUES

Parimet e përgjithshme për marrëveshjet e menaxhimit dhe kontrollit specifikohen në nenin 72 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

Autoriteti Menaxhues, i ndihmuar edhe nga Sekretariati i Përbashkët, është përgjegjës për menaxhimin dhe zbatimin e Programit të Bashkëpunimit në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar. AM-ja kryen funksionet e përshkruara në nenin 125 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 dhe nenin 23 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013.

Veçanërisht, Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për transmetimin e informacionit dhe të dhënave të Komiteti i Përbashkët i Monitorimit dhe të Komisioni Evropian, në veçanti të dhënat financiare dhe të dhënat në lidhje me indikatorët dhe eventet e rëndësishme që lidhen me zhvillimin e projekti, si dhe të dhënat në lidhje me ecurinë e Programit të Bashkëpunimit në arritjen e objektivave dhe rezultateve të tij.

Autoriteti Menaxhues vepron për të mirën e të gjithë Programit të Bashkëpunimit.

Në zbatimin e detyrave të tij Autoriteti Menaxhues vepron në përputhje të plotë me dispozitat ligjore, institucionale dhe financiare italiane.

Autoriteti Menaxhues, në marrëveshje me vendet pjesëmarrëse në Programin e Bashkëpunimit, ngre Sekretariatin e Përbashkët, siç parashikohet në kapitullin 5.2.

Bazuar në parimet e efikasitetit dhe angazhimit, një zyrë e dedikuar në Departamentin e Mesdheut - Zyrën e Bashkëpunimit Ndërrajonal dhe Evropës Juglindore - siguron zbatimin e detyrave të AM-së, duke përfshirë edhe përfshirjen efektive të stafit dhe shërbimeve, sipas organizatës administrative rajonale. Për çështjet administrative dhe financiare Autoriteti Menaxhues mbështetet nga stafi i brendshëm rajonal dhe nga Njësia e jashtme e Asistencës Teknike.

Duke iu referuar marrëdhënieve dhe roleve përkatëse të Autoritetit Menaxhues dhe Komitetit të Përbashkët të Monitorimit të Programit, AM-ja do të garantojë që KPM të kryejë dhe zbatojë detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me rregulloret e BE-së dhe Rregulloret Zbatuese të IPA-s.

AM-ja do të sigurojë të gjitha mjetet e nevojshme që e lejojnë KPM-në të formulojë rekomandime për zbatimin e Programit dhe do të sigurojë reagim të shpejtë për masat konkrete të miratuara si rrjedhojë.

Për më tepër, AM-ja:

- promovon sinergjitë dhe garanton koordinimin e bashkëpunimit territorial të BE-së dhe programet e tjera të zhvillimit të BE-së të financuara nga Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF), Fondi Social Evropian (ESF), Fondi Bujqësor Evropian për Zhvillim Rural (EAFRD), Fondi Evropian Detar dhe i

Peshkimit (EMFF), IPA, si edhe institucionet dhe politikat në nivelin evropian, kombëtar, rajonal dhe lokal;

- i kushton vëmendje zhvillimit të strategjive makrorajonale të Mesdheut dhe rajonit të Adriatikut dhe të Jonit, duke siguruar koherencën në rrugët e zhvillimit territorial të parashikuara këtu;
- respekton vlerat në aspektin e qëndrueshmërisë mjedisore, mundësitë e barabarta, mosdiskriminimit, të drejtat e njeriut, si edhe objektivat e Strategjisë së Bashkimit Evropian 2020;
- vepron duke respektuar parimet e përgjithshme dhe politikat e Bashkimit Evropian, si prokurimi publik dhe rregullat e konkurrencës, çështjet e mjedisit, barazisë dhe mos diskriminimit me qëllim për të synuar thirrjet për propozime në përputhje me prioritetet e Programit të Bashkëpunimit për të përmbushur nevojat reale dhe interesat e territoreve, si dhe për gjenerimin e vlerës së shtuar dhe projekte të qëndrueshme;
- optimizon (ose përdor efektivisht) burimet financiare, njerëzore dhe kohën në një mënyrë plotësisht transparente.

VERIFIKIMET E MENJËHERSHME NË VEND

Për të garantuar kontrollin e cilësisë, Autoriteti Menaxhues, në përputhje me nenin 125, pika 5, shkronja "b" të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, kryen verifikimet e menjëhershme (në vend) në nivelin e përfituesve. Shpeshësia dhe mbulimi i verifikimeve në vend është në proporcion me vlerën e mbështetjes publike ndaj projekt-propozimit dhe nivelit të rrezikut të identifikuar dhe auditimeve nga Autoriteti i Auditimit për sistemin e menaxhimit dhe kontrollit, si një e tërë. Autoriteti Menaxhues harton dhe, sapo të miratohet nga Komiteti i Përbashkët Monitorues, zbaton kriteret për të përcaktuar intensitetin e verifikimeve.

AUTORITETI CERTIFIKUES

Autoriteti Certifikues, sipas nenit 24 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013, kryen funksionet e parashikuara në nenin 126 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

Në veçanti, Autoriteti Certifikues është përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin e aplikimeve të pagesës së Komisionit dhe që vërteton se këto rezultojnë/rrijnë nga sisteme të besueshme të kontabilitetit, dhe janë të bazuara në dokumente të verifikueshme mbështetëse, si dhe kanë qenë subjekt i verifikimeve nga ana e Autoritetit Menaxhues përpara se të dërgohen te Komisioni.

Autoriteti Certifikues është, gjithashtu, përgjegjës për hartimin e llogarive vjetore, që vërtetojnë plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e këtyre llogarive dhe se shpenzimet regjistrohen në llogaritë në përputhje me rregullat e aplikueshme të BE-së dhe ato kombëtare, dhe që lindin/shkaktohen nga propozimet e projekteve të zgjedhura për financim në përputhje me kriteret e zbatueshme për Programin e Bashkëpunimit, që përputhen me rregullat e BE-së dhe ato kombëtare.

Vëmendje e veçantë i kushtohet projektimit dhe zbatimit të instrumentit të TIK-ut për Menaxhimin dhe Monitorimin që do të përdoret, ndër të tjera, për mbështetjen e Autoritetit Certifikues në kryerjen e funksioneve të tij të veçanta, në mënyrë që të garantohet shkëmbimi elektronik i të dhënave mes Autoriteteve të Programit.

Në mënyrë që të përmbushë detyrat e tij, Autoriteti Certifikues mbështetet nga stafi i brendshëm rajonal dhe nga Njësia e jashtme e Asistencës Teknike.

AUTORITETI I AUDITIMIT

Autoriteti i Auditimit kryen funksionet e tij në përputhje me nenet 123, 124, 127 dhe 128 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 dhe të neneve 21 dhe 25 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013.

Autoriteti i Auditimit garanton se auditimet kryhen nëpërmjet funksionimit të duhur të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të Programit të Bashkëpunimit dhe sipas modelit të duhur të propozimeve të projekteve në bazë të shpenzimeve të deklaruar. AA-ja harton një opinion të auditimit mbi llogaritë vjetore për vitin paraprak të kontabilitetit dhe një raport vjetor të kontrollit që përcakton rezultatet e auditimeve të kryera gjatë vitit të kontabilitetit të mëparshëm.

Autoriteti i Auditimit përgatit, brenda tetë muajve të miratimit të Programit të Bashkëpunimit, një strategji auditimi për performancën dhe auditimet. Strategjia e auditimit përcakton metodologjinë e auditimit, metodën e modelit për auditimet në projekte dhe planifikimin e auditimeve në raport me vitin aktual të kontabilitetit dhe dy vitet pasuese të kontabilitetit.

Në përputhje me nenin 25, pika 2, të Rregullores (BE) nr. 1299/2013, Autoriteti i Auditimit asistohet nga një Grup i Auditorëve (QSH) i përbërë nga përfaqësues të organeve përgjegjëse të secilit vend pjesëmarrës në Programin e Bashkëpunimit, që kryejnë detyrat e renditura më sipër të detajuara në nenin 127 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013. Përfaqësuesit duhet të jenë të pavarur nga anëtarët e KPM-së, nga kontrolluesit e përcaktuar sipas nenit 23, pika 4, të Rregullores (BE) nr. 1299/2013 dhe nga çdo aktivitetet

dhe financa të projektit. Qeveria shqiptare vendos brenda tre muajve nga vendimi për miratimin e Programit për bashkëpunimin jo më vonë se koha e specifikuar. Harton rregullat e veta të procedurës dhe kryesohet nga Autoriteti i Auditimit.

Kur auditimet dhe kontrollet kryhen nga një organ tjetër, përveç Autoritetit të Auditimit, ky i fundit siguron që këto organe të kenë pavarësinë e nevojshme funksionale. Vendimi për organin që kryen auditime të sistemit dhe kontrollet mbi shpenzimet merret nga Autoriteti i Auditimit dhe Grupi i Auditorëve gjatë procesit të hartimit të strategjisë së auditimit të Programit të Bashkëpunimit.

Shteti anëtar i BE-së dhe vendet pjesëmarrëse janë përgjegjëse për auditimet e kryera në territoret e tyre.

Autoriteti i Auditimit vepron, në zbatimin e detyrave të tij, në përputhje të plotë me dispozitat institucionale, ligjore dhe financiare italiane.

SEKRETARIATI I PËRBASHKËT

Sipas nenit 23 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013, Sekretariati i Përbashkët ndihmon Autoritetin Menaxhues në kryerjen e funksioneve të tij dhe është organi kryesor për mbështetjen teknike, përgjegjës për zbatimin e Programit të Bashkëpunimit. Sekretariati i Përbashkët siguron informacion për përfituesit potencialë në lidhje me mundësitë e financimit në kuadër të Programit INTERREG IPA II CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi 2014–2020, dhe asiston përfituesit në zbatimin e propozimeve të projekteve. SP-ja krijon dhe mban kontakte me Përfituesit Kryesorë dhe partneritetet e tyre.

Më konkretisht, Sekretariati i Përbashkët siguron koordinimin në nivelin ndërkufitar, ndjekjen dhe promovimin e aktiviteteve dhe ofron mbështetje teknike për përgatitjen e takimeve dhe eventeve në nivel Programit (Komitete Monitorimi, Konferenca ndërkufitare dhe grupe pune, trajnime dhe seminare, takime të tjera të veçanta tematike).

Sekretariati i Përbashkët lehtëson, vlerëson dhe siguron që përzgjedhja e projekteve është e drejtë dhe transparente. SP-ja mbledh të dhëna financiare, fizike dhe statistikore që janë të nevojshme për monitorimin e programit, si dhe për vlerësimet e përkohshme dhe përfundimtare. Ai verifikon pretendimet e pagesës në mënyrë që të shihet pagesa te Përfituesit Kryesorë. Për më tepër, ai kryen detyra që lidhen me zbatimin e planit të komunikimit të Programit dhe që kanë të bëjnë me ndjekjen e projekteve në vazhdim, duke kryer aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit të projekteve të zgjedhura.

Sekretariati i Përbashkët është, gjithashtu, i ngarkuar me zbatimin e sistemit të informacionit që është i hapur dhe në dispozicion të operatorëve për zbatimin e Programit të Bashkëpunimit: afatin, progresin, kontaktet, detajet e telefonit, internetit.

Planet vjetore të punës dhe raportet e SP-së duhet të miratohen nga KPM-ja. Ngritja dhe funksionimi i SP-së, duke përfshirë aktivitetet e tij, financohen nga buxheti i AT-së në përputhje me planet e punës dhe raportet e AM/SP që do të miratohen nga KPM-ja çdo vit.

PIKAT KOMBËTARE INFORMATIVE

Pikat Kombëtare INFO (të informimit) do të vendosen në Mal të Zi dhe Shqipëri. Detyrat e tyre kryesore janë të përkthejnë objektivat/qëllimet e Programit të Bashkëpunimit për përfituesit potencialë në vendet pjesëmarrëse dhe të shërbejnë si pika kombëtare të informimit për përgatitjen e projekteve dhe fazën e dorëzimit, si dhe zbatimit. Pikat kombëtare INFO të Programit IPA II CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi janë sinergjike me aktivitetet e Sekretariatit të Përbashkët. Pikat Kombëtare INFO mund të kryejnë, në bashkëpunim me SP-në dhe autoritetet kombëtare në krye të Programit të Bashkëpunimit, aktivitete të tjera specifike.

Detyrat kryesore të Pikave Kombëtare të Kontaktit, janë:

- të veprojnë si pikë informacioni për aplikantët potencialë të projektit dhe përfituesit në nivel kombëtar;
- të kontribuojnë për të maksimizuar informacionin dhe mekanizmat e publicitetit në vendet përkatëse;
- të veprojnë si lidhje mes përfituesve dhe organeve përgjegjëse, në nivel kombëtar, për zbatimin e Programit të Bashkëpunimit;
- të mbështesin, në nivel kombëtar, kontrollorët e SP-së dhe Programit për zbatimin e aktiviteteve të monitorimit të projekteve;
- të mbështesin organet kombëtare me informacione të nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre.

Pikat Kombëtare INFO (të Informimit) trajnohen në bazë të rregullt, për të siguruar performancat e tyre më të mira dhe për të përafruar aktivitetet e tyre vendore me fazat e ndryshme të zbatimit të Programit.

5.3.2 ORGANIZIMI I VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJA E PROPOZIMEVE TË PROJEKTEVE

Në kuadër të zbatimit të Programit të Bashkëpunimit mund të aplikohet për kategori të ndryshme të thirrjeve për propozime, që kanë të bëjnë me kategoritë e ndryshme të iniciativave të projektit:

- Projektet standarde, thirrjet e hapura që trajtojnë nevojat e zhvillimit të Programit të Bashkëpunimit, në kuadrin e objektivave, rezultateve dhe kontributeve të identifikuara nga strategjia e Programit.

- Projektet strategjike, thirrjet e synuara në bazë të termave të referencës të cilat mbështeten në qasjen nga lart-poshtë dhe që parashikojnë përfshirjen e të gjitha vendeve pjesëmarrëse në Programin e Bashkëpunimit, në kuadrin e një modeli qeverisës multinivelësh, i cili mbështetet në përfituesit përkatës dhe aktorët kryesorë. Dimensioni financiar i projekteve strategjike synon maksimizimin e ndikimit të tyre në afat të mesëm dhe të gjatë në të gjithë zonën e Programit të Bashkëpunimit.

- Projektet tematike, thirrjet e synuara në bazë të termave të referencës të cilat mbështeten në qasjen nga lart-poshtë dhe janë të fokusuara në çështje me rëndësi të veçantë për zonën e Programit të Bashkëpunimit, që dalin nga nevojat specifike. Dimensioni financiar i projekteve tematike synon maksimizimin e ndikimit të tyre në afat të mesëm dhe të gjatë brenda zonës së synuar të Programit të Bashkëpunimit.

Jo më pak se 50% e buxhetit të Programit dedikuar për thirrjet e propozimeve i përkushtohet Projekteve Strategjike dhe Tematike.

Komponentët e AM-së dhe KPM-së sigurojnë vizibilitetin dhe promovimin maksimal të çdo thirrjeje për propozime, së bashku me dokumentet shpjeguese që lidhen me to, si dhe paketat e aplikimit, duke i përhapur ato përmes faqes së internetit të Programit, faqeve të internetit kombëtar dhe eventeve kombëtare të përkushtuara.

Procesi i përzgjedhjes së projektit është nën përgjegjësinë e plotë të KPM-së, i cili miraton grupin/setin e kriterëve të përzgjedhjes dhe Paketën e Aplikimit, hartuar nga SP-ja. KPM-ja miraton listën e projekt propozimeve që do të financohen në kuadër të Programit të Bashkëpunimit. KPM-ja mund të ngrejë një Komitet Drejtues që vepron nën përgjegjësinë e tij për përzgjedhjen e projekt propozimeve, sipas nenit 39 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014.

Procesi i përzgjedhjes dhe kriteret janë të detajuara në mënyrë të qartë në Manualin e Zbatimit të Programit dhe në Paketën e Aplikimit të Projektit të çdo thirrjeje për propozim.

Kriteret e vlerësimit janë përcaktuar me qëllimin për të maksimizuar qasjen e orientuar të rezultateve të Programit, që fokusohen në projekte të aftë për të dhënë rezultate dhe kontribute konkrete dhe të dukshme, duke promovuar zhvillim të integruar territorial të zonës së interesuar, duke iu përgjigjur sfidave të identifikuara që ndikojnë në zonën e Programit dhe trajtojnë nevojat e saj të zhvillimit.

PROCEDURA E PËRZGJEDHJES

Pas dorëzimit në AM, çdo projekt propozim është objekt i procedurës së vlerësimit.

Procedura e përzgjedhjes përbëhet nga dy hapa:

HAPI I PARË – VLERËSIM I ZYRTAR

Sekretariati i Përbashkët (SP) kryen dy nivele kontrolli:

1. Kontrolli i pranimit: propozimet e projektit kontrollohen nëpërmjet një seti kriteresh administrative (d.m.th. dorëzimi i projekt propozimeve brenda afatit të caktuar, formulari i aplikimit është forma zyrtare e parashikuar, të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë të bashkëngjitur etj.);

2. Kontrolli i pranueshmërisë: Propozimet e projektit kontrollohen nëpërmjet një seti kriteresh teknike (p.sh. respektimi i përbërjes së partneritetit ndërkuftar, respektimi i pragut financiar; plotësimi i dokumenteve të kërkuara nga thirrja etj.).

Vetëm propozimet e projekteve që plotësojnë kriteret e pranimit dhe ato të pranueshmërisë pranohen për vlerësimin e mëtejshëm të cilësisë, ndërsa ata që nuk janë të pranueshëm, hidhen poshtë me vendim të KPM-së. Me mbështetjen e SP-së, AM-ja u komunikon përfituesve kryesorë rezultatet e vlerësimit zyrtar.

HAPI I DYTË – VLERËSIMI I CILËSISË

Në fazën e vlerësimit të cilësisë, SP-ja vlerëson propozimet e projekteve nëpërmjet një sërë kriteresh të cilësisë të aprovuar nga KPM-ja. KPM-ja mund të mbështetet te një grup ekspertësh të jashtëm që kryejnë një vlerësim teknik / shkencor të projekt propozimit, duke ofruar komente dhe rezultate që i referohen vetëm një pjesë të veçantë të rrjetit të vlerësimit të cilësisë.

Kriteret e cilësisë, si edhe rezultatet përcaktohen në përputhje me sa më poshtë:

- lidhja ndërkuftare;
- lidhja me temën/ lëndën;

- koherenca me strategjinë e programit, prioritetin dhe objektivin specifik;
- lidhja e partneritetit;
- kontributet konkrete dhe të matshme, rezultatet dhe ndikimi në zonën e Programit të Bashkëpunimit;
- cilësia e planifikimit të aksioneve;
- qëndrueshmëria e projektit, sipas dimensionit të tij më të rëndësishëm: dimension institucional, dimensionin ekonomik, dimensionin mjedisor, dimension i kapitalit të vet;
- pajtueshmëria e kostos së përfitimit me burimet e mobilizuara (njerëzore, financiare, materiale etj.);
- buxheti i fuqishëm (në drejtim të shpërndarjes midis partnerëve, linjat buxhetore, dispozitat e shpenzimeve periodike etj.);
- strategjia e komunikimit/ mjetet/ kanalet/ aksionet e projektit;
- metodologjia e menaxhimit të efektshëm, në lidhje me aftësitë teknike dhe aspektet novatore të saj;
- pajtueshmëria me parimet horizontale dhe prioritetet ndërsektoriale;
- natyra integruese e operacioneve.

AM-ja siguron që procedura e vlerësimit është kryer në përputhje me kërkesat e thirrjes për propozime dhe kriteret të miratuara të përzgjedhjes.

AM-ja dorëzon në KPM listën provizore të klasifikimit të projekt- propozimeve të vlerësuara; KPM-ja miraton me një vendim përfundimtar listën e klasifikimit.

AM-ja publikon listën përfundimtare të klasifikimit në faqen e internetit të Programit dhe, përmes SP-së, informon përfituesit kryesorë me rezultatet e vlerësimit të projektit. Komunikimi përmban, gjithashtu, informacion në rast se partneri kryesor synon të fillojë një procedurë të ankesës.

ZGJIDHJA E ANKESAVE

AM-ja miraton procedura të standardizuara për menaxhimin e ankesave përgjatë gjithë zbatimit të Programit, për të ofruar shërbime më të mira si për aplikuesit ashtu edhe për përfituesit.

Ankesat mund:

- të trajtohen për të rishikuar rezultatet e procesit të përzgjedhjes, duke përfshirë edhe ankesat administrative;
- të jenë ankesa të cilat nuk janë të përfshira në procedurat administrative të ankesave.

Për sa i përket opsionit të mëparshëm, të gjitha procedurat ekzistuese të përcaktuara nga ligji aktual janë të detyrueshme të zbatohen, ndërsa në procedurat e veçanta të mëvonshme duhet të gjendet një zgjidhje më e shpejtë për t'i identifikuar dhe ndarë.

Informacionet e mëtejshme mbi procedurën e parashtrimit të ankesave do të përcaktohen në dokumentet përkatëse të programit që i komunikohen përfituesve kryesorë dhe përfituesve të tjerë.

LIDHJA E KONTRATËS

Pas vendimit të KPM-së për miratimin e aplikimeve të rekomanduara për financim, AM-ja dhe Përfituesi Kryesor nënshkruajnë një kontratë subvencionimi për secilin projekt. AM-ja do të përdorë një model standard për kontratën e subvencionimit të miratuar nga KPM-ja, e cila është krijuar në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Italisë dhe parimet e institucionit që pret Autoritetin Menaxhues.

Kontrata e subvencionimit i drejtohet Përfituesit Kryesor, i zgjedhur nga partneriteti, dhe nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i Përfituesit Kryesor dhe nga AM-ja.

Kontrata e subvencionimit përcakton të gjitha marrëveshjet e nevojshme zbatuese për projekt propozimin.

Dokumentet e miratuara të aplikimit, duke përfshirë formularin përfundimtar të miratuar dhe komunikimin e vendimit të miratuar nga ana e KPM-së, formojnë një pjesë integrale të kontratës së subvencionimit.

5.3.3 MARRËVESHJA PËR VERIFIKIMIN E MENAXHIMIT - PËR TË PËRSHTATUR ME TEJ ME RREGULLAT E IPA-s

Në kuadrin e menaxhimit dhe kontrollit financiar, vendet pjesëmarrëse sigurojnë që sistemi i tyre i menaxhimit dhe kontrollit të jetë krijuar në përputhje me dispozitat e përcaktuara në rregulloren e BE-së dhe se ky sistem funksionon në mënyrën e duhur dhe efektive.

Çdo vend pjesëmarrës në Programin e Bashkëpunimit verifikon që produktet dhe shërbimet e bashkëfinancuara ofrohen, shpenzimet e deklaruara nga përfituesit paguhen dhe përputhen me ligjin e BE-së dhe ligjin kombëtar, Programin e Bashkëpunimit dhe kushtet për mbështetjen e projekt-propozimit, sipas nenit 23, pika 4, të Rregullores (BE) nr. 1299/2013.

Çdo vend pjesëmarrës cakton organin ose personin përgjegjës për kryerjen e verifikimeve të tilla në lidhje me përfituesit në territorin e tij ("kontrolluesit") dhe është, gjithashtu, përgjegjës për verifikimet e kryera në territorin e tij.

Për Programin INTERREG IPA II CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi 2014–2020, këto verifikime kryhen nga kontrollorët e caktuar në bazë të sistemit të kontrollit të secilit vend pjesëmarrës (i centralizuar ose i decentralizuar).

Çdo vend pjesëmarrës garanton që shpenzimet e një përfituesi mund të verifikohen brenda një periudhe tremujore nga dorëzimi i dokumenteve nga ana e përfituesit në fjalë, në përputhje me nenin 23 (4) të Rregullores së BE-së nr. 1299/2013.

Autoriteti Menaxhues garanton që shpenzimi i çdo përfituesi pjesëmarrës në projekt-propozim verifikohet nga kontrolluesi i caktuar.

Me synimin për të thjeshtuar procedurën administrative dhe për përmirësimin e menaxhimit të programit, AM-ja inkurajon harmonizimin dhe koordinimin e aktiviteteve nëpërmjet miratimit të niveleve të përbashkëta të standardeve midis sistemeve kombëtare të kontrollit.

Pas këtyre verifikimeve, SP-ja merr nga çdo projekt raportin e rregullt të progresit të hartuar nga përfituesi kryesor, duke përfshirë kërkesë-pagesën në bazë të afateve të paracaktuara.

VERIFIKIMI I SHPENZIMEVE

ITALIA

Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për verifikimin e shpenzimeve të përfituesve italianë. Ky autoritet kryen verifikime në lidhje me përfituesit në territorin e tij nëpërmjet një sistemi decentralizues të Regjistratit të Auditorëve, në përputhje me nenin 125, pika 4, shkronja "a" të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 (CPR) dhe nenin 23, pika 4, të Rregullores (BE) nr. 1299/2013 (ETC).

Në lidhje me përfituesit italianë

a) Partnerët privatë, në përputhje me kuadrin ligjor evropian dhe kombëtar, kërkojnë kontrolle të aktiviteteve të projekt-propozimeve ose të një pjese të projekt-propozimeve, p.sh. neni 23 i Rregullores (BE) nr. 1299/2013, për ekspertët e kualifikuar. Këta të fundit duhet të plotësojnë kërkesat për profesionalizëm, ndershmëri, pavarësi dhe duhet të jenë të regjistruar për të paktën tre vjet / në një listë kontabilistësh dhe ekspertësh kontabël të certifikuar ose, ndryshe, në regjistrat e audituesve, siç referohet në dekretin legjislativ të datës 27 janar 1992, nr. 88.

Rajoni Pulia – Departamenti i Mesdheut – Zyra e Bashkëpunimit Territorial – vlerëson zgjedhjen e bërë nga përfituesit privatë në mënyrë që të sigurojë plotësimin e të gjithë elementeve të kërkuar. Zyra Territoriale e Bashkëpunimit komunikon vlerësimin tek Autoriteti Menaxhues i Programit të Bashkëpunimit.

b) Partnerët publikë, këta të fundit, në përputhje me kuadrin ligjor evropian dhe kombëtar:

i) kërkojnë kontrolle aktiviteti mbi propozime të projektit ose pjesë të tyre, në përputhje me nenin 23 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013, ndaj ekspertëve të kualifikuar.

Këta të fundit duhet të plotësojnë kërkesat për profesionalizëm, ndershmëri, pavarësi dhe duhet të regjistrohen së paku për tre vjet në një listë të certifikuar kontabilistësh dhe ekspertësh kontabël ose në regjistrat e auditorëve, siç referohet në dekretin legjislativ të datës 27 janar 1992, nr. 88.

Përfituesit e projekteve të përzgjedhura përfshijnë në buxhetin e projektit një sasi të mjaftueshme parash për shpenzime të mundshme gjatë procesit të vlerësimit. (rreth 2% e aktiviteteve).

ii) përfituesit publik mund të kërkojnë kontrolle aktiviteti për projekt-propozimet ose mbi një pjesë të tyre ndaj strukturave të brendshme të kualifikuara siç janë organet/departamentet, me kushtin që të sigurohet ndarja funksionale dhe hierarkike nga strukturat e përfshira në zbatimin e projekteve.

Rajoni Pulia – Departamenti i Mesdheut – Zyra e Bashkëpunimit Territorial – vërteton zgjedhjen e bërë nga përfituesit publik, në mënyrë që të sigurojë ndarjen e duhur të kontrollit të menaxhimit dhe atij të aktiviteteve, si dhe pavarësinë funksionale të strukturave të përfshira në zbatimin e aktiviteteve të projektit. Zyra e Bashkëpunimit Territorial komunikon deklaratën e pavarësisë tek Autoriteti Menaxhues i Programit.

SHQIPËRIA

Në lidhje me përfituesit shqiptarë, një Sistem Kontrolli i Nivelit Fillestar i centralizuar do të aplikohet dhe do të mbikëqyret nga kontrolluesit e kontraktuar nga Ministria e Integritimit Evropian.

Shqipëria do të garantojë pavarësi institucionale dhe ndarje të qartë të funksioneve ndërmjet njësive me përgjegjësi në menaxhimin e programit, përzgjedhjen e projekteve dhe miratimin e tyre, organet përgjegjëse

për verifikimin e shpenzimeve të projektit dhe ecurinë e aktiviteteve të projektit.

Verifikimi i shpenzimeve të projektit dhe ofrimi i produkteve dhe shërbimeve do të kryhet nga zyra (FLC) e ngritur nga Ministria e Integrimit Evropian. Kjo Zyrë do të jetë si nga mënyra e organizimit ashtu edhe nga funksionet e pavarur nga Departamentet e tjera të Ministrisë së Integrimit Evropian:

- Zyra FLC në Shqipëri ka për detyrë të garantojë që shpenzimet e deklaruar nga Përfituesit Shqiptarë, të vlerësohen brenda një periudhe tremujore nga data e paraqitjes së tyre nga Përfituesi”.

Pas këtij kontrolli administrativ mbi shpenzimet e deklaruar cili kryhet për shpenzimet në tërësi, Zyra Shqiptare FLC është e ngarkuar të bëjë kontrolle të herëpashershme mbi këto projekte.

- Zyra Shqiptare FLC duhet të kryejë paraprakisht një kontroll administrativ të deklaratës së shpenzimeve, dhe me pas t'i dorëzojë Autoritetit Menaxhues një deklaratë të certifikuar të Nivelit të Parë të Shpenzimeve.

Vendet pjesëmarrëse caktojnë dhe përgatitën bashkërisht kontrolluesit bazuar në kriteret standarde të kontrollit. Kontrolluesit u aprovuan nga Autoriteti Menaxhues dhe u miratuan nga Komiteti Monitorues.

MALI I ZI

Në lidhje me përfituesit e Malit të Zi, një Sistem Kontrolli i Centralizuar i Nivelit të Parë do të vihet në zbatim dhe do të vëzhgohet nga një kontrollues i kontraktuar nga Ministria e Financave, Drejtoria për Financat dhe Kontraktimin e Fondeve të Asistencës së BE-së (CFCU).

Mali i Zi do të garantojë pavarësinë institucionale dhe ndarjen e qartë të funksioneve ndërmjet organeve me përgjegjësi në menaxhimin e programit, përzgjedhjen e projekteve, miratimin e organeve përgjegjëse për verifikimin e shpenzimeve të projektit, ecurinë e aktivitetit të projektit dhe ofrimin e produkteve dhe shërbimeve.

Verifikimi i shpenzimeve të projektit dhe ofrimi i produkteve dhe shërbimeve do të kryhen brenda Ministrisë së Financave nga CFCU-ja.

CFCU-ja ka pavarësi organizative dhe funksionale nga sektorët e tjerë të Ministrisë së Financave.

CFCU-ja nuk do të përfshihet në program si partner i projektit.

Nga verifikimet e kryera në nivel kombëtar duhet të mbulojë aspektet e mëposhtme të propozimeve të projekteve:

- Verifikimi administrativ - kontrolli i disponueshmërinë i të gjitha dokumenteve mbështetëse në lidhje me llojet e ndryshme të shpenzimeve;

- Verifikimi financiar - siguruar që të gjitha shpenzimet e deklaruar nga përfituesit janë shkaktuar në përputhje të plotë me BE-në dhe rregulloret kombëtare;

- Verifikimi teknik - kontrolli nëse shërbimet dhe mallrat janë dorëzuar dhe nëse mallrat dhe shërbimet e ofruara përmbushin standardet e kërkuara të cilësisë;

- Kontrolli fizik - kontrolli “në vend” (shpesh i kombinuar me verifikimin teknik).

Gjendja e lëshimit të Deklaratës mbi vlefshmërinë e shpenzimeve nga ana e CFCU-së së verifikimi i shpenzimeve ekzekutohet nga kontrolluesi i CFCU.

RIMBURSIMI I PËRFITUESVE KRYE-SORË NGA AUTORITETI MENAXHUES

Në përputhje me nenin 13 të Rregullores së (BE), përkatësisht Rregullorja nr. 1299/2013, për secilin projekt propozim, përfituesit e projektit caktojnë një përfitues kryesor. Përfituesi kryesor merr përgjegjësinë e plotë për aplikimin dhe zbatimin e të gjithë projektit, duke përfshirë menaxhimin e fondeve të BE-së. Bashkëfinancimi kombëtar për projekt-propozimet duhet të sigurohet nga përfituesit e projektit sipas mekanizmave kombëtare përkatëse.

Për sa i përket Italisë, bashkëfinancimi kombëtar garantohet nga neni 1 (241), i ligjit nr. 147/2013 i modifikuar dhe integruar nga neni 1 (672), i ligjit nr. 190/2014. Bashkëfinancimi kombëtar nuk u jepet partnerëve privatë të cilësuar, të cilët duhet të kontribuojnë te projekt-propozimet me burimet e tyre.

Për sa i përket Shqipërisë dhe Malit të Zi, bashkëfinancimi kombëtar u garantohet vetëm në nivel të projektit. Komiteti i Përbashkët i Monitorimit (KPM) mund t'i japë AM-së kompetencën për të shqyrtuar mundësinë e një mekanizmi parafinancues për projektet. Si rregull i përgjithshëm, shpenzimet e vlerësuara si të pranueshme mbulohen nga procedura e rimbursimit.

Shpenzimet e të gjithë përfituesve duhet të vlerësohen nga kontrolluesit e autorizuar kombëtarë. Përfituesi kryesor mbledh raportet e vlerësimit të të gjithë përfituesve të projektit, lëshuar nga kontrolluesit e tyre dhe i përfshin këto në raportet e aktiviteteve periodike dhe të progreseve financiare për AM/SP. Në

këto dokumente, përfituesi kryesor raporton për progresin e arritur nga partneriteti i projektit dhe për shpenzimet e pranueshme të verifikuara.

Për sa i përket fluksit të shpenzimeve të vërtetuara, përfituesi kryesor e dërgon listën e plotë të shpenzimeve të verifikuara te Sekretariati i Përbashkët, i cili pas kryerjes së kontrollit paraprak në (plotësim të dhënash dhe shpenzime të deklaruar) i përcjell ato, shoqëruar me komente, tek Autoriteti Menaxhues. Autoriteti Menaxhues (AM) siguron që i gjithë informacioni i nevojshëm është i disponueshëm për procedurat dhe verifikimet e kryera për shpenzimet, kjo në qëllim të raportit të vlerësimit. Më pas, AM-ja ia përcjell atë Autoritetit Certifikues, për të përgatitur dhe paraqitur në Komision deklaratat e certifikuar të shpenzimeve dhe aplikimet për pagesë.

Në përputhje me nenin 80 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, shumat e përcaktuara në Programin e Bashkëpunimit të paraqitura nga vendet pjesëmarrëse dhe deklaratat e shpenzimeve shprehen në njësinë monetare euro. Të gjitha transferimet e kontributeve të BE-së për përfituesit kryesorë do të bëhen në euro.

5.3.4 INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Në përputhje me nenet 115 dhe 116 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, hartohet një plan komunikimi dhe paraqitet në KPM jo më vonë se 6 muaj pas miratimit të Programit INTERREG IPA II CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014–2020, në mënyrë që të sigurohet transparenca dhe informimi për përfituesit përkatës dhe palët e interesuara.

Plani do të përcaktojë objektivat specifike të komunikimit, audiencat e synuara, mesazhet, si dhe taktikat dhe mjetet për të mbështetur arritjen e qëllimeve më të gjera të programit. Ai do të marrë në konsideratë rregullat e detajuara në lidhje me masat e informimit dhe të komunikimit, siç përcaktohet në nenin 115 dhe në shtojcën XII të Rregullores së lartpërmendur të BE-së. Plani do të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e programimit, plotësuar ose shoqëruar dhe me planet vjetore të punës.

Përgjegjësia e përgjithshme për komunikimet i takon Autoritetit Menaxhues (AM), së bashku me Sekretariatit e Përbashkët (SP). Vendet pjesë-marrëse mbështesin AM-në për të siguruar zbatimin efektiv të kërkesave të informimit dhe publikimit, duke ndërmarrë hapat e duhur për përhapjen e informacionit dhe garantimin e publikimit brenda territorit të tyre.

Pikat Kombëtare të Informimit (Info) kontri-buajnë për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara të planit të komunikimit duke kryer aksione për informimin dhe publikimin në vendet përkatëse.

5.3.5 VLERËSIMI I PROGRAMIT

Programi INTERREG IPA II CBC Shqipëri-Itali-Mali i Zi 2014–2020 ka qenë objekt i një vlerësimi ex-ante të vlerësuesve të pavarur me qëllimin për të përmirësuar cilësinë e programit dhe për të bërë më efektiv alokimin e burimeve buxhetore.

Rekomandimet e këtij vlerësimi janë marrë parasysh gjatë hartimit të këtij Programi Bashkë-punimi.

Në përputhje me nenin 56 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, AM-ja do të hartojë një plan vlerësimi, i cili do të miratohet nga KPM-ja në përputhje me dispozitat siç përcaktohet në nenin 110 (2) (c) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

Në përputhje me nenin 56 të Rregullores së BE-së të përmendur më lart, vlerësimet do të kryhen për të vlerësuar efektivitetin, efikasitetin dhe ndikimin e Programit të Bashkëpunimit. Gjatë periudhës së programimit, vlerësimi do të tregojë se si ka kontribuar mbështetja nga fondet tek objektivat për çdo aks prioritar dhe, gjithashtu, në mbulimin territorial të zonës së programit; të gjitha vlerësimet, rekomandimet dhe për promovimin e përfshirjes sociale, barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin.

KTHIMI I PAGESAVE NGA PËRFI-TUESIT

Rekomandimet dhe masat korrigjuese mund të rezultojnë nga çdo lloj i kontrollit të zbatuar (kontrollat nga ana e Autoritetit Menaxhues, nga shteti anëtar dhe vendet pjesëmarrëse, nga Autoriteti Certifikues, auditimeve të sistemit dhe punë, auditimeve nga Komisioni Evropian dhe nga Gjykata Evropiane e Auditorëve). Pa cenuar përgjegjësinë e vendeve pjesëmarrëse për zbulimin dhe korrigjimin e parregullsive si dhe për kthimin e shumave të paguara tepër sipas nenit 122 (2) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, Autoriteti Menaxhues siguron që çdo shumë e paguar si rezultat i një parregullsi është merret nga projekti nëpërmjet përfituesit kryesor.

Sipas nenit 27 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013, përfituesit e projektit të paguajë te përfituesi udhëheqës të gjitha shumat e paguara padrejtësisht. Autoriteti Menaxhues, gjithashtu, do të rimarrë fondet nga përfituesit udhëheqës (dhe përfituesi udhëheqës nga përfituesit e projektit) pas ndërprerjes së kontratës subvencioneve plotësisht ose pjesërisht në bazë të kushteve të përcaktuara në kontratën e subvencionit.

Nëse përfituesi kryesor nuk ka sukses në sigurimin e shlyerjes nga një përfitues i projektit ose nëse Autoriteti Menaxhues nuk ka sukses në sigurimin e shlyerjes nga përfituesit udhëheqës, pavarësisht të gjitha masave të marra, vendi pjesëmarrës në territorin e të cilit/cilës përfituesi i projektit në fjalë është e vendosur, kompenson Autoritetin menaxhues çdo shumë të paguar tepër ndaj tij, në bazë të nenit 27 (3) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013 (ETC).

Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për rimbursimin e shumave të rikthehet në buxhetin e përgjithshëm të Unionit, në përputhje me ndarjen e detyrimeve midis vendeve pjesëmarrëse (shih më poshtë). Autoriteti Menaxhues do të rimbursojë fondet Bashkimit pasi shumat të jenë marrë nga përfituesi udhëheqës/ përfituesi/ vendi pjesëmarrës. Detajet për procedurën do të përfshihen në përshkrimin e sistemit të menaxhimit dhe të kontrollit, të krijuar në përputhje me nenin 72 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 (CPR). Paralelisht me/ pas rimbursimit për shumën e të parimbursueshme nga vendi pjesëmarrës Autoritetit Menaxhues, vendi pjesëmarrës ka të drejtë të sigurojë pagesën nga përfituesi i projektit në territorin e tij nëse është e nevojshme me rrugë ligjore. Për këtë qëllim Autoriteti Menaxhues dhe përfituesi kryesor caktojnë të drejtat e tyre që rrjedhin nga kontrata e subvencioneve dhe marrëveshja e partneritetit për vendin pjesëmarrës në fjalë.

Në rast se zbulohen parregullsi nga ana e Gjykatës Evropiane të Auditorëve, ose nga Komisioni Evropian, për të cilët është kosto nëse konsiderohet i paligjshëm dhe me gabime financiare duke qenë subjekt i vendimit të KE-së sipas neneve 144 deri 147 të Rregullores (EU) nr. 1303/2013, pasojat financiare për vendet pjesëmarrëse janë të përcaktuara në seksionin e “detyrimeve dhe parregullsive” më poshtë. Çdo shkëmbim i ndërlidhur i korrespondencës mes KE-së dhe shtetit anëtarit dhe vend pjesëmarrës do të regjistrohet në Sekretariatit e Autoritetit Menaxhues/Përbashkët. Ky i fundit do ta informojmë Autoritetin Certifikues, Autoritetin e Auditimit dhe Grupin e Auditorëve.

NDARJA E DETYRIMEVE MES VENDE-VE PJESEMARRËSE

Shteti pjesëmarrës do të mbajë përgjegjësi në lidhje me përdorimin e kontributeve të programit ERDF dhe IPA-së si më poshtë:

- Për shpenzimet në lidhje me projektet, të dhëna përfituesit të projektit për territorin e saj/saj, përgjegjësia është individuale për secilin vend pjesëmarrës;

- Në rast të një parregullsi sistematike apo korigjim financiar (kjo e fundit vendosur nga Komisioni Evropian), vendi pjesëmarrës mbart pasojat financiare në raport me parregullsinë përkatëse të zbuluar në territorin përkatës të vendit pjesëmarrës. Aty ku parregullsia ose korigjimi financiar nuk mund të lidhet me territorin specifik të një vendi pjesëmarrës, vendi pjesëmarrës do të jetë përgjegjës në proporcion me kontributin e ERDF/IPA të paguar përfituesve përkatës të përfshirë në projektin kombëtar.

- Për shpenzimet e asistencës teknike të kryera nga Autoriteti Menaxhues, përgjegjësia lidhur me parregullsitë administrative, do të merret përsipër nga Autoriteti Menaxhues.

Nëse Autoriteti Menaxhues/ Sekretariati i Përbashkët, Autoriteti Certifikues, çdo shtet pjesëmarrës ka dijeni për parregullsi, ato duhet të njoftojnë, pa vonesë vendet pjesëmarrëse përgjegjëse ose Autoritetin Menaxhues. Ky i fundit do të sigurojë kalimin e informacionit Autoritetit Certifikues dhe Autoritetit të Auditimit/ Grupit të Auditorëve, ku është e përshtatshme.

Në përputhje me nenin 122 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 (CPR), çdo vend pjesëmarrës është përgjegjës për raportimin e parregullsive të kryer nga përfituesit që ndodhen në territorin e tyre të KE-së dhe në të njëjtën kohë tek Autoriteti Menaxhues. Nëse vendi pjesëmarrës nuk pajtohet me detyrimet e tij që rrjedhin nga këto dispozita, Autoriteti Menaxhues ka të drejtë të pezullojë pagesat për të gjithë përfituesit e projektit të vendosura në territorin e këtij vend pjesëmarrës.

Marrëveshja e financimit me vendet e IPA-s duhet të qartësojë se çdo vend përfitues që pret një përfitues të projektit është përgjegjës për parandalimin, zbulimin, marrjen e vendimeve dhe korigjimin e parregullsive të bëra nga përfituesit publikë, si dhe ata privatë.

Përdorimi i euros

(Referenca: Neni 28 i Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Në përputhje me nenin 28 të Rregullores (BE) nr. 1299/2013 dhe duke u shmangur nga neni 133 i Rregullores (EU) nr. 1303/2013, shpenzimet e kryera në një monedhë tjetër ndryshe nga euro do të konvertohen në euro nga përfituesit - duke përdorur normën e këmbimit mujor të kontabilitetit të KE-së në muajin gjatë të cilit janë dorëzuar shpenzimet për verifikim tek Autoriteti Menaxhues ose kontrollues. Këmbimi do të verifikohet nga kontrolluesi në shtetin pjesëmarrës ku përfituesi ndodhet.

ANGAZHIMI I PARTNERËVE

(Referenca: pika (c) të nenit 8 (4) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013)

Veprimet e ndërmarra për të përfshirë partnerët në përgatitjen e programit të bashkëpunimit, si dhe rolin e tyre në përgatitjen dhe zbatimin e programit të bashkëpunimit, duke llogaritur përfshirjen e tyre në komitetin monitorues (autoritetet rajonale dhe lokale, kompetente urban dhe të tjera publike, partnerët ekonomikë dhe socialë, organet përkatëse që përfaqësojnë shoqërinë civile (duke përfshirë partnerët e mjedisit), organizatat joqeveritare dhe organet përgjegjëse për promovimin e përfshirjes sociale, barazia gjinore dhe mosdiskriminimit).

5.6 PËRMBLEDHJE E PROCESIT TË PËR-GATITJES SË PROGRAMIT TË BASHKË-PUNIMIT

Programi i Bashkëpunimit është përpunuar sipas kodit të sjelljes të Komisionit Evropian. Procesi i përgatitjes së Programit të Bashkëpunimit zgjati rreth një vit, duke filluar me takimin e parë të Task Forcës, më 27 shkurt 2014, në Podgoricë, me përfaqësues nga 3 vendet pjesëmarrëse (1 shtet anëtar dhe 2 vende të IPA-s).

Gjatë këtij takimi të parë, një rajon i Pulias kandidoi zyrtarisht për t'u bërë Autoriteti Menaxhues i ardhshëm i Programit INTERREG IPA II CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014–2020. Task Forca miratoi rregulloren e brendshme për ngritjen e misionit, procesin e vendimmarrjes dhe përbërjen e Task Forcës. Në mënyrë që të sigurojë koherencë të përgjithshme të përmbajtjes së Programit të Bashkëpunimit (PB) me kuadrin rregullator evropian, plani indikativ kohor i procesit të programimit përditësohet vazhdimisht duke marrë parasysh zhvillimin e draft rregulloreve të BE-së dhe proceset e konsultimit.

Task Forca vendosi të kontraktonte disa ekspertë të jashtëm për kryerjen e detyrave të specializuara që kanë të bëjnë me përgatitjen PB, siç është moderimi (pajtueshmëria) dhe procesi i hartimit të PB, vlerësimi ex-ante dhe ai strategjik mjedisor. Në total u zhvilluan 5 takime gjatë gjithë këtij procesi përgatitor, dhe 3 procedura me shkrim.

5.7 PËRSHKRIMI PËR ANGAZHIMIN E PARTNERËVE

Qëllimi i procesit është të vlerësojë zgjedhjet strategjike (përqendrimin tematik) për Programin INTERREG IPA II CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014–2020 dhe të mbledhë të dhëna/kontribute dhe sugjerime shtesë, si dhe ide për aksionet e mundshme CBC që do të mbështeten. Për përgatitjen e programit të bashkëpunimit, partnerët u përfshinë përmes një konsultimi të lançuar në nivel programi.

Autoriteti Menaxhues paraqiti një konsultë online 14-ditore nga 19 shtator deri më 2 tetor 2014.

Ftesa iu dërgua 726 palëve të interesuara, duke përfshirë ata nga listat e e-maileve dërguar nga anëtar i Task Forcës dhe ata të cilët e plotësuan formularin e regjistrimit online.

Në kuadrin e procesit të programimit, Task Forca organizoi edhe një event ndërrajonal, në Bari, më 20 shtator 2014, ndërsa dy takime kombëtare diskutimi u organizuan në nivel ministrie në Shqipëri dhe Mal të Zi, që kishin si qëllim mbledhjen e kontributeve nga publiku rreth pritshmërisë së tyre për Programin INTERREG IPA II CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014–2020 dhe rezultatet e aksioneve shtesë për përmirësimin e Strategjisë së Programit.

Pjesëmarrësit ishin mjaft aktivë dhe kontribuan me mendime dhe ide për të gjithë komponentët e programit. Këto të dhëna janë përkthyer në rishikimin konkret të projektit të programit të bashkëpunimit dhe fokusohen kryesisht në:

- zonat tematike shtesë që do të përfshihen në fokus të aksit prioritar;
- disa sugjerime për përmirësimin e menaxhimit dhe zbatimit të Programit.

Në procesin e hartimit të dokumentit të Programit të Bashkëpunimit (PB) u konsultuan edhe autoritetet mjedisore të vendeve pjesëmarrëse, për të garantuar kështu një ndikim pozitiv të programit në mjedisin e vendeve të interesuara.

PËRZGJEDHJA E PARTNERËVE

Procesi i këshillimit për Programin INTERREG IPA II CBC Shqipëri-Itali-Mali i Zi 2014–2020 ka ndjekur “Parimet e përgjithshme dhe standardet minimale të Komisionit lidhur me këshillimin e palëve të interesuara” (“Drejt një kulture të përforcuar konsultimi dhe dialogu - parime të përgjithshme dhe standarde minimale nga Komisioni për konsultim të palëve të interesuara”. Bruksel, 11.12.2002 COM (2002) 704 final). Në këtë mënyrë, ky program ka garantuar aplikimin e parimeve të transparencës, llogaridhënies,

efektshmërisë dhe koherencës pas konsultimit me palët e interesuara.

Gjithsej katër palë të interesuara për t'u konsultuar:

- a) Palët e interesuara të përfshira në listat kombëtare / rajonale ofruar nga vendet pjesë-marrëse;
- b) Partnerët e projektit SEE dhe IPA CBC Adriatic 2007-2013;
- c) Grupet e synuara të programit me mundësinë për t'u lidhur me AM-në dhe faqet e internetit të vendeve pjesëmarrëse;
- d) Zbatuesit kryesorë të strukturës qeverisëse EUSAIR.

Njoftimi rreth sondazhit iu dërgua me e-mail 726 adresave.

Lista e partnerëve të përfshirë në procesin e konsultimit

Autoriteti Menaxhues ndërmori konsultimin online midis datës 19 shtator - 2 tetor dhe, pas një njohje të përgjithshme, përfshiu 3 seksione kryesore, duke u kërkuar pjesëmarrësve të kontribuojnë në:

- vlerësimi i lidhjes që kanë 7 objektivat specifike të propozuar, si dhe të paraidentifikuar (nga "ata strategjikë" tek "ata jopërkates") dhe dhënia e disa sugjerimeve për aksionet specifike për secilin prej tyre;
- klasifikimi i 7 objektivave të njëjtë specifike të identifikuar paraprakisht;
- mbështetja e tyre për përmirësimin e mundshëm të sistemit të menaxhimit të programit, duke përfshirë një seksion të lirë ku mund të jepen sugjerime shtesë.

Të 726 palët e interesuara u ftuan për konsultim publik në lidhje me Programin INTERREG IPA II CBC 2014–2020 Shqipëri Itali-Mali i Zi, duke përfshirë edhe ata që u ftuan me anë të emailit dhe ata që plotësuan formularin e regjistrimit online. Norma e kthimit prej 18.5% është më e lartë se mesatarja, bazuar në përvojën e fituar nga sondazhet e ngjashme që janë zhvilluar më përpara. Gjysma e të anketuarve (50%) e plotësuan anketën në më pak se 8 minuta. Në mesin e 135 të anketuarve, rreth 61% ishin nga Italia, 26% nga Mali i Zi dhe 13% nga Shqipëria.

Kur flitet për përqindjen e pjesëmarrjes lidhur me kategorinë e të anketuarve (tabela 2), është kjo shpërndarje: 32% organet kërkimore dhe arsimore, 19% AP qendrore/ rajonale, 18% autoritetet publike vendore, 13% ndërmarrje të orientuara fitimprurëse, 10% agjencitë e zhvillimit/ OJQ-të, 9% dhomat tregtisë, sindikatat dhe shoqatat që përfaqësojnë një interes ekonomik.

Aksion i ndërmarrë për të lehtësuar pjesëmarrjen e partnerëve

Programi INTERREG IPA II CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014–2020 informoi partnerët në lidhje me nisjen e procesit të konsultimit në faqen e internetit Pulia rajon, dhe nga ana tjetër nëpërmjet faqeve të tyre institucionale njoftoi partnerët, autoritetet dhe organet përkatëse të vendeve të tjera pjesëmarrëse.

Aktorët e përfshirë në listat e ofruara nga vendet pjesëmarrëse, partnerët e projektit dhe organet e programit janë ftuar për t'u përgjigjur anketës nëpërmjet email-it.

Ky e-mail përfshinte një shënim të shkurtër shpjegues dhe linkun që të lidh me faqen e internetit të programit për mundësi konsultimi. Gjatë periudhës së konsultimit u dërguan disa kujtesa.

Vlera kryesore e shtuar e partneritetit në përgatitjen e programit të bashkëpunimit

Në përgatitjen e programit të bashkëpunimit, vlera kryesore e shtuar e partnerëve ishte sigurimi i informacionit të detajuar për prioritetet dhe aksionet e pranueshme dhe koherente në nivel territorial për një gamë të gjerë institucionesh dhe organesh. Kjo ndihmoi për të theksuar përparësitë dhe për të kategorizuar çështjet që duhet të merren parasysh në strategjinë e programit.

Partnerët, gjithashtu, ndihmuan në identifikimin sa më të mirë të llojeve të aksioneve dhe aksionet që duhet të mbështeten për çdo prioritet tematik. Kjo ishte e domosdoshme për të propozuar aksione operative dhe të nevojshme, të aftë për të gjeneruar rezultate konkrete dhe të dukshme.

Rezultatet kryesore të konsultimeve me partnerët

Renditja e objektivave tematikë në përgjithësi është në përputhje me paraseleksionimin e bërë nga Renditja e Task Forcës së objektivave të veçantë.

- OS 2.1 - Pasuritë natyrore dhe kulturore (të renditura të parat) janë njohur në pozicionin e parë nga pothuajse të gjitha kategoritë e të anketuarve.

- OS 2.2 - industria kreative dhe zhvillimi lokal (e renditur si e dyta) qëndron në krye sa u përket agjencive zhvillimore dhe OJQ-ve, ndërsa kategoritë e tjera janë më pak entuziaste. Është pothuajse një fakt i çuditshëm që ndërmarrja me drejtim përfitues (nuk është bërë asnjë dallim midis ndërmarrjeve me pronësi publike ose private) tregon pak interes në këtë sektor, sikur të ketë dyshime mbi performancën reale ekonomike të industrisë.

- OS 4.1 - lidhja (e renditur si e treta) është pranuar në mënyrë homogjene mirë nga të gjitha kategoritë,

me një tregim interesi të vogël nga ndërmarrjet me bazë fitimi.

- OS 1.1 – Zhvillimi i objektivave të SME-ve (i renditur si i katërti) mbledh mbështetje nga të gjitha kategoritë, por ka një interes relativisht të vogël në anën e administratave rajonale dhe qendrore.

- OS 3.1 - mbrojtja e mjedisit (e renditur si e pesta) është shumë afër me OS-në e mëparshme, por është padyshim e penalizuar nga mungesa e dukshme e interesit në nivelin e administratës lokale dhe shoqatave që përfaqësojnë një interes ekonomik. Dikush mund të mendojë se në këtë rast ekziston një nevojë e menjëhershme për rezultate të shpejta të prekshme që nxisin një rikthim të rritjes ekonomike së cilës i është dhënë një prioritet më i lartë në krahasim me qëllimet afatgjata të tilla si mbrojtja e mjedisit (dhe politikat për emetimin me karbon të ulët).

- OS 3.3 - menaxhimi i ujit (i renditur i gjashti) nuk është konsideruar si prioritet në këtë rast. Zona e programit përballlet me një numër problemesh që lidhen me menaxhimin e ujërave, por fakti që administrata publike dhe madje edhe përfaqësuesi i interesave ekonomike nuk po shkojnë në këtë drejtim tregon se kjo është një çështje zgjidhjet e të cilës janë zhvendosur në programe të tjera.

- OS 3.2 – reduktimi i emetimeve të karbonit (i renditur si i fundit) është lënë në fund të të gjitha kategorive, agjencive të zhvillimit dhe OJQ-ve, duke qenë i vetmi që tregon një shkallë të caktuar të interesit. Është një rezultat relativisht i papritur, duke pasur parasysh faktin se tema është diskutuar dhe prezantuar para opinionit publik si një ndër rreziqet afatgjata që njerëzimi mund të përballë, por është e qartë se IPA CBC nuk perceptohet si instrumenti i përshtatshëm për të përballuar këto lloj politikash.

Në bazë të rezultateve të konsultimeve, Task Forca pranoi ta përqendrojë strategjinë e programit në vetëm 4 prioritetet tematike duke ulur numrin e SOS për AP3.

Përmirësimi i kapaciteteve administrative dhe qeveritare dhe forcimi i kërkimit dhe inovacionit do të konsiderohet si temat ndërsektoriale për të gjitha AP- të.

5.7.1. Përshtetja e angazhimit të partnerëve në zbatimin e programit të bashkëpunimit dhe angazhimit në komitetin monitorues

Angazhimi i partnerëve përkatës në zbatimin e Programit INTERREG II IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014–2020 do të organizohet për dy arsye:

- Për të rritur pronësinë e programit ndërmjet partnerëve, në mënyrë që të përdorë njohuritë dhe ekspertizën e këtyre partnerëve dhe për të rritur transparencën në proceset e vendimmarrjes;

- Për të përmirësuar koordinimin me ESI të tjera dhe fondet IPA II, si dhe me instrumentet përkatëse të financimit nën patronazhin e Kuadrit të Përbashkët Strategjik (KPS) dhe strategjitë makrorajonale.

5.8 KOORDINIMI ME FONDET E TJERA ESI DHE INSTRUMENTE DHE PROGRAME TË TJERA TË BE-së

Projektet e financuara nga Programi INTERREG II IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014–2020 mund të gjejnë sinergji dhe integrim me programe të tjera të financuara nga BE-ja. Për shembull - veçanërisht nën aksin prioritar 2 dhe 3 - ata mund të plotësojnë veprimtaritë dhe të shfrytëzojnë rezultatet e Programit LIFE 2014–2020, në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ndryshimeve klimatike, parandalimit të rrezikut dhe efikasitetit të burimeve; Programi do të marrë në konsideratë projekte lidhur me çështjet e mbrojtjes së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike sipas prioritetëve të Programit LIFE.

Në mënyrë të veçantë, Programi LIFE “Projektet e integruara” i zbatuar në planet ose strategjitë klimatike ose shkallës mjedisit rajonale, multirajonale, kombëtare ose transnacionale të mjedisit, të kërkuara nga legjislati i specifik mjedisor ose klimatik i Unionit, në fushat e natyrës (duke përfshirë menaxhimin e rrejtës Natura 2000), ujit, mbetjeve, ajrit dhe përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike. Këto projekte inkurajojnë përfshirjen e aktorëve dhe nxisin mobilizimin e së paku një Unioni tjetër përkatës, burimit kombëtar apo privat të financimit.

Për të siguruar koordinimin dhe sinergjitë me financimin nga ERD-ja dhe EAFRD-ja në territoret e programit italian, rajonet e Pulias dhe Molises do të konsultohen me organet e menaxhimit ERDF dhe EAFRD në fazën e vlerësimit të projekteve, duke vendosur kriteret e duhura përzgjedhëse duke vlerësuar përputhshmërinë me dispozitat e rregullores të zhvillimit rural dhe shmangien e financimit të dyfishtë të operacioneve. Autoritetet drejtuese të fondeve të ERDF-së dhe EAFRD-së në rajonet italiane do të ftohen për të marrë pjesë në Komitetin e Monitorimit të programit dhe të shprehin mendimin e tyre për projektet që kanë ndikim në zhvillimin rajonal.

E njëjta procedurë do të zbatohet në rastin e projekteve që u interesojnë politikave të punës apo trajnimeve profesionale, që mund të financohen nëpërmjet ESF-së.

SEKSIONI 6. PARIMET HORIZONTALE

(Referenca: Neni 8 (7) të Rregullores (BE) nr. 1299/2013

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Zhvillimi i qëndrueshëm ri-paraqitet në emër në aksit prioritar 3 dhe të është integruar si një parim horizontal në programin e bashkëpunimit. Ai do të respektohet gjatë gjithë ciklit të programit (programimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit). “Zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes pa vënë në rrezik aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre” (WCDE, WCED) do të jetë përcaktimi bazë që do të përdoret duke zgjeruar pikëpamjet nga thjesht mjedisore në një qasje më të gjerë, duke përfshirë barazinë sociale mes dhe ndër brezave, aspektet e trashëgimisë kulturore, si dhe efikasitetin ekonomik. Aktivitetet e programit do të lidhen me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm të OKB-së (që pasojnë objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit në vitin 2015) dhe do të ngrihet një sistem monitorimi. Përveç kësaj, Pulia dhe Molise kanë konfirmuar zyrtarisht pjesëmarrjen e tyre rrjetin e mjedisit dhe kohezionit cituar nga AP-ja italiane.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) dhe vlerësimi i parashikuar ofroi të dhëna për të siguruar që programi IPA II CBC Itali-Shqipëri – Mal i Zi të respektojë parimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Programi ka për qëllim përmirësimin dhe harmonizimin e kërkesave të mbrojtjes së mjedisit, efikasitetit të burimeve, zbutjen dhe përshtatjen e ndryshimeve klimatike përgjatë gjithë vendeve partnere. Reduktimi i ndikimit të aktiviteteve njerëzore mbi mjedisin dhe mbrojtja e ekosistemeve dhe biodiversitetit mbështeten nga prioritetet tematike D dhe B.

Për më tepër, në mënyrë të tërthortë, përfituesve u është kërkuar të promovojnë eko-inovacione me qëllim për të pasur një përdorim më të qëndrueshëm të burimeve natyrore në të gjitha akset prioritare. Më saktësisht, përfituesve u është kërkuar të përshtatin në projekt propozimet e tyre përpjekjet që do të ndërmerren për të reduktuar “gjurmët e karbonit” të projektit. Gjithashtu, organet e programit (MC, MA, JS, NCP) do ta trajtojnë këtë çështje në lidhje me zbatimin e detyrave të tyre.

Në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, projektet dhe aplikimet do të vlerësohen duke përdorur kriteret e mëposhtme:

- Projektet të cilat kanë një efekt pozitiv në mjedis ose që ruajnë, rrisin apo rehabilitojnë financimet ekzistuese do të preferohen më shumë se ata që janë neutralë në këtë perspektivë;
- Projektet që kanë një efekt potencialisht të dëmshëm në mjedis do të përjashtohen;
- Veprimet e projektuara për të rritur ndërgjegjësimin dhe respektimin mjedisor si brenda sektorëve ekonomikë dhe administrativë, ashtu edhe në mesin e publikut të gjerë, duke përfshirë njohjen që një nivel i lartë të performancës mjedisore mund të sigurojë një avantazh konkurrues afatgjatë, do të mbështeten.

Si udhërrëfyes për procesin e vlerësimit të projektit, aspektet e mëposhtme do të konsiderohen:

- Kontributi në efikasitetin e përdorimit të burimeve (p.sh efikasitetin e energjisë, përdorimit të energjisë së rinovueshme, furnizimin efikas me ujë, trajtimin e ujërave të zeza dhe ripërdorimin e ujit, shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës, menaxhimin e mbetjeve dhe riciklimin etj.);

- Përmirësimi i cilësisë së ajrit, përmes reduktimit të emetimeve dhe ndotësve të ajrit (PM, NO₂);
- Kontributi në zhvillimin e infrastrukturave të gjelbra;
- Kontributi në zhvillimin e qëndrueshëm të integruar urban dhe rajonal;
- Kontributi në ndërgjegjësimin më të lartë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe parandalimin e rrezikut;

• Promovimi i mundësive për punësim, arsimim, trajnim dhe shërbime mbështetëse në kontekstin e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Në formularët e aplikimit, një kapitull i veçantë do t'i kushtohet kriterëve të zhvillimit të qëndrueshëm. Projekt propozimet me tregues të matshëm të prodhimit mbi çështjet mjedisore (atje janë të aplikueshëm, sipas objektivave të projektit) dhe/ose kornizat logjike (aktivitetet e projektit, rezultatet, objektivat specifike, objektivat globale), duke marrë parasysh çështjet e mjedisit, do të inkurajohen.

Këto projekte, kanë ose jo lidhje me çështjet e zhvillimit, do të ftohen për të zbatuar veprimet / për të marrë masa specifike për të reduktimin e ndikimit mjedisor. Kjo mund të përfshijë, për shembull:

- Përdorimi i videokonferencave për të reduktuar udhëtimin;
- Publikime në letër të certifikuar FLC;
- Përdorimi i procedurave të “prokurimit publik jeshil” dhe prokurimit publik novator atëherë kur është e përshtatshme;

- Përdorimi i zinxhirëve të shkurtër të furnizimit për zbatimin e aktiviteteve të projekteve;
- Rritja e ndërgjegjësimit të partnerëve, përfituesve dhe grupeve të synuara për çështjet e qëndrueshmërisë;

- Promovimi i aktiviteteve me përdorim të kufizuar të energjisë dhe burimeve natyrore.

Teknika të ngjashme do të merren parasysh në nivel programi për menaxhimin e aktiviteteve të monitorimit.

Udhëzime më të hollësishme për interpretimin e parimeve kryesore të përshkruara në CP mund të sigurohet në termat e referencës për çdo thirrje për propozim.

MUNDËSITË E BARABARTA DHE MOSDISKRIMINIMI

Mosdiskriminimi mbulon jo vetëm gratë (dhe burrat), por çdo diskriminim bazuar në origjinën racore apo etnike, fenë ose besimin, aftësitë e kufizuara, moshën apo orientimin seksual. Ndërsa legjislacioni kundër diskriminimit është një aspekt i përthithur nga sistemet ligjore të BE-së, zbatimi praktik i praktikave të antidiskriminimit ka mbetur pas. Gjithashtu, një çështje është qasja e barabartë ndaj informacionit dhe kontrollet mbi përmbushjen e kërkesave të barazisë dhe jodiskriminimit.

Strategjia e Programit vë theksin mbi shkëmbimin e njohurive, praktikave të mira dhe parimin e aksesit të barabartë ndaj informacionit. Kjo përfshin synimin e grupeve të ndryshme shoqërore në mënyrë të përshtatshme; heqjen e pengesave në komunikimin e programit (p.sh. media, gjuha etj.), duke promovuar qasje pa pengesa etj.

Ky orientim strategjik i Programit do të rritet nga një përzgjedhje e synuar për operacionet. Kur shqyrton propozimet pyetja në vijim “udhëzuese – aty ku është e mundur – duhet të vlerësohet: A po kontribuon operacioni në promovimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit? Do t’i kushtohet vëmendje mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit nëpërmjet përfshirjes së treguesve përkatës që lidhen me profilin e personave të përfshirë në projekte, p.sh. projekte të gjinisë, prejardhjes etnike, moshës, profesionit dhe të arsimit nivel, aftësive të kufizuara etj.

Nuk do të ketë dënim për projektet që nuk promovojnë në mënyrë aktive mosdiskriminimin dhe mundësi të barabarta, veprimet e tyre do të analizohen në bazë të të dhënave të monitorimit dhe identifikimit të pengesave të hasura.

Ky orientim strategjik i programit mund të rritet nga një përzgjedhje e caktuar operacionesh. Vlerësimi i cilësisë së propozimeve të pranueshme të projekteve do të bazohet në një sërë kriteresh të cilësisë të cilat duhet të jenë të përbashkëta për të gjitha akset prioritar dhe prioritetet tematike. Si një udhëzues për vlerësuesit, aspektet e mëposhtme treguese mund të konsiderohet në përzgjedhjen e projektit:

- Marrja në konsideratë e nevojave të ndryshme dhe ndikimin e qëllimshëm dhe të paqëllimshëm të projektit për grupe të ndryshme (p.sh. njerëzit me aftësi të kufizuara, minoritetet dhe emigrantët, njerëzit e besimeve të ndryshme fetare dhe personat me orientim të ndryshëm seksual etj.);

- Shqyrtimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit në zbatimin e projektit, p.sh. në lidhje me krijimin e një plani të veprimit të mundësive të barabarta, përcaktimi i objektivave për mundësi të barabarta, sigurimi i trajnimeve të mundësive të barabarta ose kurseve të menaxhimit të diversitetit, sigurimi i shërbimeve mbështetëse;

- Dispozitat për një qasje të barabartë në rezultatet dhe përfitimet nga operacioni për të gjithë anëtarët e shoqërisë.

BARAZI MES BURRAVE DHE GRAVE

Qëllimi i barazisë midis grave dhe burrave është një nga vlerat themelore të Bashkimit Evropian dhe është përcaktuar në Traktatin e Bashkimit Evropian (neni 8, versioni i konsoliduar i Traktatit për funksionimin e Bashkimit Evropian, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian C 83/49 e 30.3.2010). Këto vlera themelore duhet të respektohen në rregulloret dhe zbatimin e programit, siç tregohet nga nevoja për të “siguruar se barazia midis burrave dhe grave dhe [se] integrimi i perspektivës gjinore është promovuar në përgatitjen dhe zbatimin e programeve” dhe se “... hapat e duhur [do të merren] për të parandaluar çdo diskriminim në bazë të gjinisë, prejardhjes racore apo etnike, fesë ose besimit, paafësisë, moshës ose orientimit seksual gjatë përgatitjes dhe zbatimit të programeve” (neni 7, CPR, COM (2011) 615 final/ 2, Bruksel, 2012/03/14, f. 34).

- Do kihet kujdes për monitorimin e të dhënave sensitive bazë, si p.sh.:

- Numri i grave dhe burrave që marrin pjesë në projekte;

- Vlerësimi i numrit të grave dhe burrave që përfitojnë nga fondet;

- Vlerësimi se sa mbështetje dhe për cilat projekte gratë dhe burrat të marrin fonde (sipas llojit të projektit/ prioriteti i investimeve).

Vlerësimi i cilësisë së propozimeve të pranueshme të projektit do të bazohet në një sërë kriteresh të cilësisë të cilat duhet të jenë të përbashkëta për të gjitha prioritetet tematike. Si një udhëzues për vlerësuesit, aspektet e mëposhtme indikative të integritetit gjinor mund të konsiderohen në përzgjedhjen e projektit:

Shqyrtimi i qëndrimeve fillestare të ndryshme të grupeve të synuara (ekzistenca dhe niveli i dallimeve midis grave dhe burrave dhe implikimet e këtyre dallimeve për fushën specifike të politikave etj.) dhe për ndikimin e qëllimshëm dhe të paqëllimshëm të aksionit në këto grupe;

Vlerësimi i si dhe arsyes përse dallimet dhe pabarazitë janë të rëndësishme për ndërhyrjen e propozuar, duke identifikuar ku ka hapësira për të ngushtuar këto pabarazi.

SHTOJCAT (NGARKUAR NË SISTEMIN ELEKTRONIK TË SHKËMBIMIT TË TË DHËNAVE SI DOSJE MË VETË):

- draftraporti i vlerësimit ex-ante (duke përfshirë një përmbledhje ekzekutive të raportit);
- konfirmimi i marrëveshjes me shkrim me përmbajtjen e programit të bashkëpunimit;
- një hartë e zonës së mbuluar nga programi i bashkëpunimit;
- një përmbledhje “rreth qytetarëve” të programit të bashkëpunimit;
- vlerësimi strategjik mjedisor.

SHTOJCA IV KUSHTET E PËRGJITHSHME

HYRJE

1. Programi Interreg- IPA BNK Itali – Shqipëri – Mal i Zi 2014–2020; CCI 2014TC16I5CB008 zbatohet nën menaxhimin e përbashkët. Si rrjedhojë, shteti anëtar dhe Komisioni janë përgjegjës për zbatimin, menaxhimin dhe kontrollin e Programit.

2. Autoritetet dhe organet e përfituesit IPA II mbështesin shtetin anëtar në përgjegjësitë e tij dhe bashkëpunojnë ndershmërisht me autoritetet e vetme të Programit, në veçanti, aty ku vetëm autoritetet dhe organet e përfituesit IPA II mund të kryejnë detyrat në territorin e tyre.

3. Qëllimi i pjesës një është të përcaktojë rregullat për zbatimin e Programit Interreg-IPA BNK Itali–Shqipëri–Mal i Zi 2014–2020, siç përshkruhet në shtojcën 1 dhe të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e përfituesit IPA II dhe të Komisionit përkatësisht në kryerjen e këtyre detyrave.

4. Pjesa një zbatohet për detyrimet e përfituesit IPA II, në lidhje me kontributin vetëm të Unionit ose të kombinuar me bashkëfinancimin kombëtar të përfituesit IPA II.

5. Përfituesi IPA II mbetet përgjegjës për mbështetjen e autoriteteve të Programit të shtetit anëtar në përmbushjen e detyrimit të tij të parashikuar në aktet themelore, edhe nëse përfituesi IPA II nën-delegon subjekte të tjera të identifikuara në Programin Interreg-IPA CBC Itali - Shqipëri - Mali i Zi 2014–2020 për të kryer detyra të caktuara. Komisioni, në veçanti, ka të drejtë të ndërpresë pagesat, dhe të pezullojë dhe/ose të përfundojë këtë Marrëveshje Financimi në bazë të akteve, mosveprimeve dhe/ose situatave të ndonjë subjekti të caktuar.

PJESA NJË DISPOZITAT E PËRGJITHSHME TË ZBATUESHME

SEKSIONI I DISPOZITAT DHE PARIMET E PËRBASHKËTA

Neni 1

Përcaktimet

Për qëllimin e kësaj pjesë zbatohen përcaktimet e mëposhtme:

- a) “Përfituesi IPA II” nënkupton një nga përfituesit e përcaktuar në shtojcën I të Rregullores IPA II;
- b) “Vendet pjesëmarrëse” nënkupton përfituesit IPA II bashkë me shtetin anëtar që merr pjesë në një program shumëvjeçar për bashkëpunimin ndërkufitar, i hartuar bashkërisht nga vendet pjesëmarrëse;

c) “Programim” nënkupton procesin e organizimit, marrjen e vendimeve dhe alokimin e burimeve financiare në disa faza, me përfshirjen e partnerëve në përputhje me nenin 5, me qëllim zbatimin, mbi baza shumëvjeçare, veprimet e përbashkëta të Unionit dhe shteteve anëtare për të arritur objektivat e strategjisë së Unionit, për rritjen e zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse;

d) “Program” nënkupton një program bashkëpunimi shumëvjeçar, parashikuar nga neni 2(1) dhe 6(3) të Rregullores (BE) nr. 236/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit¹;

e) “Marrëveshja kuadër” nënkupton një marrëveshje të nënshkruar midis Komisionit dhe një përfituesi IPA II që zbatohet te të gjithë sektorët e politikave IPA II dhe që përcakton parimet e bashkëpunimit financiar midis përfituesit IPA II dhe Komisionit nën këtë Rregullore;

f) “Marrëveshje Partneriteti” nënkupton një dokument të përgatitur nga një shtet anëtar me përfshirjen e partnerëve në përputhje me qasjen e qeverisjes me shumë nivele e cila parashikon strategjinë e shtetit anëtar, prioritetet dhe marrëveshjet për përdorimin e fondeve evropiane strukturore dhe të investimit në një mënyrë efektive dhe efçente për të ndjekur strategjinë e Unionit për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe e cila është miratuar nga Komisioni në vijim të vlerësimit dhe dialogut me shtetin anëtar në fjalë;

g) “Sektor politikash” nënkupton fushat kryesore të bashkëpunimit të trajtuara nga veprimet e financuara nga asistenca IPA II, siç parashikohet në nenin 3(1) të Rregullores IPA;

h) “Shpenzim publik” nënkupton çdo kontribut publik në financimin e operacioneve burimi i të cilit është buxheti i autoriteteve publike kombëtare, rajonale dhe lokale, buxheti i Unionit i lidhur me asistencën IPA II, buxheti i organeve të ligjit publik ose buxheti i shoqatave të autoriteteve publike ose organeve të ligjit publik;

i) “Organ i së drejtës publike” do të thotë në shtetin anëtar një organ që rregullohet nga e drejta publike në kuptim të pikës 4 të nenit 2(1) të direktivës 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit² dhe çdo grupimi evropian të bashkëpunimit territorial (EGTC) të ngritur në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 1082/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit³, pavarësisht nëse EGTC konsiderohet të jetë një organ i së drejtës publike ose një organ i të drejtës private sipas dispozitave zbatuese kombëtare përkatëse, dhe përfituesit IPA II, në përputhje me të drejtën kombëtare, organet ekuivalente me ato të shteteve anëtare;

j) “Dokument” do të thotë një letër ose një medium elektronik, që mbart informacione që kanë rëndësi në kontekstin e kësaj rregulloreje;

k) “Autoritete” do të thotë subjekte publike apo organet e një përfituesi IPA II ose një shteti anëtar në nivel kombëtar, rajonal ose lokal;

l) “Marrëveshje financiare” nënkupton një marrëveshje vjeçare ose shumëvjeçare të përfunduar midis Komisionit dhe një përfituesi IPA II, si edhe shtetit anëtar i cili është autoriteti menaxhues, aty ku shteti anëtar ka vendosur kështu, për zbatimin e asistencës financiare të Unionit nëpërmjet një aksioni që bie brenda qëllimit të Rregullores IPA II;

m) “Operacion” nënkupton një projekt, kontratë, aksion ose grup projektesh të përzgjedhur nga Komiteti i Përbashkët Monitorues ose autoriteti kontraktues që lidhet me programin, ose nën përgjegjësinë e tij që kontribuon në objektiva;

n) “Përfitues” nënkupton një organ publik ose privat, përgjegjës për fillimin ose për fillimin dhe zbatimin e operacioneve;

o) “Vit financiar”, nënkupton periudhën nga 1 korriku deri 30 qershor, përveç vitit të parë kontabël të periudhës së programimit, në respekt të së cilës nënkupton periudhën nga data e fillimit për pranueshmërinë e shpenzimeve deri më 30 qershor 2015; viti financiar final do të jetë nga 1 korrik 2023 deri më 30 qershor 2024;

p) “Vit financiar”, nënkupton periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor;

¹ Rregullorja (BE) nr. 236/2014 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e 11 mars 2014 që përcakton rregullat e përbashkëta dhe procedurat për zbatimin e instrumentave të Unionit për financimin e aksioneve të jashtme, GZ L 77, 15.3.2014, f. 95.

² Direktiva 2014/24/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 26 shkurtit 2014 për prokurimin publik që shfuqizon tekstin e direktivës 2004/18/KE me relevancën EEA GZ L 94, 28.3.2014, f. 65.

³ Rregullorja (BE) nr. 1302/201 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 17 dhjetorit 2013 që amendon Rregulloren (KE) nr. 1082/2006 mbi grupimin evropian të bashkëpunimit territorial (EGTC) në lidhje me qartësimin, thjeshtimin dhe përmirësimin e ngritjes dhe funksionimit e grupimit GZ L 347, 20.12.2013, f. 303.

q) “Parregullsi”, nënkupton çdo shkelje të ligjit të Unionit ose të ligjit kombëtar që lidhet me aplikimin e tij, që rezulton nga një akt ose anashkalim të një operatori ekonomik të përfshirë në zbatimin e kontributit IPA II, i cili ka, ose do të kishte, efektin e cenimit të buxhetit të Unionit duke ngarkuar një objekt të pajustificuar shpenzimi ndaj buxhetit të Unionit;

r) “Operator ekonomik”, nënkupton çdo person natyral ose ligjor ose entitet tjetër që merr pjesë në zbatimin e asistencës nga IPA II, me përjashtim të një shteti anëtar ose përfituesi IPA II që ushtron privilegjet e tij si autoritet publik;

s) “Parregullsi sistematike” nënkupton çdo parregullsi, e cila mund të jetë e një natyre periodike, me një probabilitet të lartë ndodhje në tipat e ngjashme të operacioneve, që rezulton nga një e metë serioze në funksionimin efektiv të një sistemi menaxhimi dhe kontrolli, duke përfshirë pamundësinë për vendosjen e procedurave të duhura në përputhje me këtë Rregullore dhe rregullat e fondit specifik;

t) “E metë serioze në funksionimin efektiv të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit” nënkupton një e metë për të cilën nevojiten përmirësime thelbësore në sistem, të cilat e ekspozojnë asistencën IPA II në një risk domethënës parregullsish dhe ekzistenca e të cilës është e papajtueshme me një opinion të pakualifikuar auditi në lidhje me funksionimin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit;

u) “Rregullat e veçanta të fondit” i referohen dispozitave specifike të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 17 dhjetorit 2013¹ e zbatueshme të Rregullorja (BE) nr. 1299/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit² (Rregullorja e Bashkëpunimit Territorial Evropian “Rregullorja ETC”) dhe Rregullorja (BE) nr. 1301/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit³.

Neni 2

Llogaritja e afateve kohore për vendimet e Komisionit

Aty ku, në pajtim me nenin 6(4) dhe (6) të kësaj Marrëveshje ose neni 107(2) dhe 108(3) e Rregullores (BE) nr. 1303/2013, vendoset një afat kohor për Komisionin për adoptimin ose amendimin e një vendimi, nëpërmjet një akti zbatues, ky afat kohor nuk duhet të përfshijë periudhën e cila fillon në datën kur Komisioni dërgon vërejtjet e tij në shtetin anëtar dhe zgjat deri sa shteti anëtar i përgjigjet vërejtjes.

Neni 3

Parimet e përgjithshme

1. Asistenca IPA II do të mbështesë përfituesin IPA II në adoptimin dhe zbatimin e reformave politike, institucionale, ligjore, administrative, sociale dhe ekonomike të kërkuara, në mënyrë që të përputhen me vlerat e Unionit dhe gradualisht të përafrohen me rregullat, standardet, politikat dhe praktikën e Unionit, me synim anëtarësimin në Union.

Nëpërmjet kësaj mbështetje, asistenca IPA II kontribuon në stabilitetin, sigurinë dhe prosperitetin e përfituesit IPA II.

2. Veçanërisht, asistenca IPA II:

a) mbështet reformat politike, ndër të tjera, nëpërmjet bashkëpunimit rajonal dhe marrë-dhënieve të mira;

b) të fqinjësisë;

c) mbështesë për zhvillimin ekonomik, social dhe territorial, duke pasur parasysh rritjen e zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse; dhe

d) forcimin e integritetit rajonal dhe bashkë-punimit territorial që përfshin përfituesin IPA II dhe shtetin

¹ Rregullorja (BE) nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 dhjetor 2013 që përcakton dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondi Social Evropian, Fondi i Kohezionit, Fondi Bujqësor Evropian për Zhvillimin Rural dhe Fondi Evropian Detar dhe i Peshkimit dhe që përcakton dispozitat e përgjithshme mbi Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondi Social Evropian, Fondi i Kohezionit dhe Fondi Evropian Detar dhe i Peshkimit dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (BE) nr. 1083/2006, GZ L 347, 20.12.2013, f. 320.

² Rregullorja (BE) nr. 1299/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 dhjetor 2013 për dispozitat specifike për mbështetje nga Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal me qëllim të bashkëpunimit territorial evropian, GZ L 347, 20.12.2013, f. 259.

³ Rregullorja (EU) nr. 1301/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 dhjetorit 2013 për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal dhe në lidhje me dispozitat e veçanta në lidhje me Investimet për zhvillim dhe vende pune qëllimin dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) nr. 1080/2006, GZ L 347, 20.12.2013, f. 289.

anëtar.

3. Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse duhet të sigurojnë, duke marrë parasysh kontekstin specifik të çdo shteti anëtar dhe përfituesit IPA II, që asistenca IPA II është e pajtueshme me politikat përkatëse, parimet horizontale që i referohen nenet 4, 5 dhe 6 dhe prioritetet e Unionit dhe që është komplementare ndaj instrumenteve të tjera të Unionit.

4. Asistenca IPA II duhet të zbatohet në bashkëpunim të ngushtë midis Komisionit, shtetit anëtar dhe përfituesit IPA II në përputhje me parimin e subsidiaritetit.

5. Vendet pjesëmarrëse në nivelin e përshtatshëm territorial, në përputhje me kuadrin e tyre institucional, ligjor dhe financiar, dhe organeve të caktuara prej tyre për këtë qëllim do të jenë të përgjegjshëm për përgatitjen dhe zbatimin e programit dhe realizimit të detyrave të tyre, në bashkëpunim me partnerët përkatës të referuar në nenin 7, në përputhje me këtë marrëveshje financiare.

6. Marrëveshjet për zbatimin dhe përdorimin e asistencës IPA II dhe në veçanti burimet financiare dhe administrative të nevojshme për përgatitjen dhe zbatimin e programit, në lidhje me monitorimin, raportimin, vlerësimin menaxhimin dhe kontrollin, duhet të respektojnë parimin e proporcionalitetit duke pasur parasysh nivelin e mbështetjes së alokuar dhe duhet të marrin parasysh, qëllimin e përgjithshëm për reduktimin e barrës administrative në organet e përfshira në menaxhimin dhe kontrollin e programit.

7. Në përputhje me përgjegjësitë e tyre përkatëse, Komisioni, dhe vendet pjesëmarrëse duhet të sigurojnë koordinimin midis këtij programi dhe programeve të tjera IPA II dhe midis asistencës IPA II dhe politikave të tjera përkatëse të Unionit, strategjive dhe instrumenteve, përfshirë ato në kuadër të aksioneve të jashtme të Unionit.

8. Pjesa e buxhetit të Unionit e alokuar për asistencën IPA II do të zbatohet brenda kuadrit të menaxhimit të përbashkët ndërmjet shtetit anëtar dhe Komisionit, në përputhje me Nenin 59 të Rregullores (BE, Euroatom) nr. 988/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹ ("Rregullorja Financiare").

9. Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse duhet të respektojnë parimin e menaxhimit të qëndrueshëm financiar në përputhje me nenin 30 të Rregullores Financiare.

10. Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse duhet të sigurojnë efektivitetin e asistencës IPA II gjatë përgatitjes dhe zbatimit, në lidhje me monitorimin, raportimin dhe vlerësimin.

11. Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse duhet të kryejnë rolet e tyre përkatëse në lidhje me asistencën IPA II me qëllim reduktimin e barrës administrative te përfituesit.

Neni 4

Përputhja me ligjin e Unionit dhe atë kombëtar

Operacionet e mbështetura nga asistenca IPA II duhet të jenë në përputhje me ligjin e Unionit dhe ligjin kombëtar që lidhet me aplikimin e tij ("ligji i zbatueshëm").

Neni 5

Promovimi i barazisë gjinore midis burrave dhe grave dhe mosdiskriminimi

Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse duhet të sigurojnë që barazia midis burrave dhe grave dhe integrimi i perspektivës së gjinisë, të merret parasysh dhe të promovohen gjatë gjithë përgatitjeve dhe zbatimit të programit, përfshirë në lidhje me monitorimin, raportimin dhe vlerësimin.

Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse, duhet të ndërmarrin hapat e duhura për të parandaluar çdo diskriminim bazuar në gjini, racë ose origjinë etnike, fetare ose besimi, paafësi, moshë ose orientim seksual gjatë përgatitjes dhe zbatimit të Programit. Në veçanti, aksesit për personat me aftësi të kufizuara, duhet të merret parasysh gjatë gjithë përgatitjes dhe zbatimit të Programit.

Neni 6

Zhvillimi i qëndrueshëm

Objektivat e asistencës IPA II do të ndiqen në linjë me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe me promovimin e aplikuar nga Unioni me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, siç

¹ Rregullorja (BE, Euratom) nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 25 tetorit 2012 për rregullat financiare e aplikueshme në buxhetin e përgjithshëm të Unionit që zëvendëson Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 1605/2002, GZ L 298, 26.10.2012, f. 1.

parashikohet në nenin 11 dhe nenin 191(1) TFEU, duke marrë parasysh parimet e pagesës së ndotësit.

Komisioni dhe vendet pjesëmarrëse duhet të sigurojnë që kërkesat e mbrojtjes mjedisore, efienca e burimeve, zbutja dhe adaptimi i ndryshimit të klimës, biodiversiteti, elasticiteti i fatkeqësive dhe parandalimi i rreziqeve, të promovohen gjatë përgatitjes dhe zbatimit të Programit.

Neni 7

Parimi i partneritetit

1. Për programin vendet pjesëmarrëse duhen që në përputhje me kuadrin e tyre institucional dhe ligjor të organizojnë një partneritet me autoritetet kompetente rajonale dhe lokale. Partneriteti duhet të përfshijë partnerët në vazhdim:

- a) autoritetet kompetente urbane dhe autoritetet e tjera publike;
- b) partnerët ekonomikë dhe shoqërorë; dhe
- c) organet përkatëse që përfaqësojnë shoqërinë civile, përfshirë partnerët mjedisorë, organizatat joqeveritare dhe organet përgjegjëse për promovimin e gjithëpërfshirjes sociale, barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit.

Vendet pjesëmarrëse mund të përfshijnë gjithashtu, grupimet evropiane të bashkëpunimit territorial që operojnë në zonën e programit dhe autoritetet ose organet që janë të përfshira në zhvillimin e zbatimit të strategjive e basenit të detit ose makrorajonale në zonën e programit, përfshirë koordinatorët e punës prioritare për strategjitë makrorajonale.

Kur autoritetet publike, partnerët ekonomikë dhe socialë dhe organet që përfaqësojnë shoqërinë civile, kanë vendosur një organizatë koordinuese, ata mund të emërojnë një përfaqësues të vetëm, për të prezantuar pikëpamjet e organizatës koordinuese në partneritet.

2. Në përputhje me qasjen e qeverisjes me shumë nivele, partnerët e referuar në paragrafin 1, duhet të përfshihen nga vendet pjesëmarrëse në përgatitjen e progres-raportëve dhe gjatë gjithë përgatitjeve dhe zbatimit të Programit, përfshirë pjesëmarrjen në Komitetin Monitorues të Programit, në përputhje me nenin 15.

3. Rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) nr. 240/2014¹ do të aplikojë *mutatis mutandis* në elementët e ndryshëm të programimit të referuar në paragrafin 2.

SEKSIONI II PROGRAMIMI

Neni 8

Mbulimi gjeografik

Lista e rajoneve të lejueshme duhet të përfshihet në Program, e cila duhet të jetë si më poshtë:

- a) Në shtetin anëtar Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistika (NUTS) niveli 3 rajone;
- b) Në vendin përfitues IPA II Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistika (NUTS) niveli 3 rajone ose, në mungesë të klasifikimit NUTS, zonat ekuivalente përgjatë vijës kufitare tokësore ose detare të ndara në maksimum me 150 km, pa cenuar rregullimet potenciale që nevojiten për të siguruar koherencën dhe vazhdimësinë e programeve të bashkëpunimit kufitar për periudhën e programimit 2007-2013.

Neni 9

Përmbajtja e Programit dhe përqendrimi tematik

1. Programi do të hartohet në përputhje me parimin e partneritetit siç parashikohet në nenin 9 dhe në përputhje me nenin 8(2) deri (4), (7), (9) dhe (10) të Rregullores ETC.

2. Programi do të konsistojë në dy akse prioritare. Pa cenuar asistencën teknike në kuptimin e nenit 32 të Rregullores Zbatuese IPA II, një aks prioritar duhet t'i korrespondojë një prioriteti tematik. Brenda një aksi prioritar, aty ku e përshtatshme dhe në mënyrë që të rritet ndikimi dhe efektiviteti i tij, nëpërmjet një qasje koherente të integruar, elementë të prioritetëve tematike të tjera mund të shtohen.

3. Prioritetet tematikë për Programin duhet të dakortësohen ndërmjet vendeve pjesëmarrëse për secilin

¹ Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) nr. 240/2014 e 7 janarit 2014 mbi Kodin Evropian të Drejtimit të Partneritetit në kuadër të Fondeve Evropiane Strukturore dhe të Investimit, GZ L 74, 14.3.2014, f. 1.

kufi ose grup kufijsh bazuar në prioritetet tematike siç përcaktohen në shtojcën III të Rregullores IPA II.

4. Prioritetet tematike të asistencës IPA II do të jenë ato të përcaktuara në shtojcën III të Rregullores IPA II.

5. Një maksimum prej 4 prioritetesh tematike duhet të përzgjidhet për Programin.

Neni 10

Miratimi dhe ndryshimi/amendimi i Programit

1. Programi duhet të dorëzohet elektronikisht në Komision nga shteti anëtar ku ndodhet autoriteti menaxhues i programit.

2. Banka Evropiane e Investimeve (BEI) mundet, që me kërkesën e vendeve pjesëmarrëse, të marrë pjesë në përgatitje, si dhe në aktivitetet që lidhen me përgatitjen e operacioneve, në veçanti projektet madhore.

Komisioni mund të konsultojë BEI-n, përpara miratimit të Programit;

3. Komisioni duhet të vlerësojë përputhjen e programeve të bashkëpunimit ndërkuftar bazuar në këtë Rregullore, kontributin efektiv të tyre për sa u përket prioritetëve tematike të zgjedhura në shtojcën III të Rregullores së IPA II dhe, gjithashtu, Marrëveshjen përkatëse të Partneritetit të vendeve anëtare që marrin pjesë.

4. Komisioni duhet të bëjë vëzhgime brenda tre muajsh nga data e nënshkrimit të programit të bashkëpunimit ndërkuftar. Vendet anëtare duhet t'i ofrojnë Komisionit të gjithë informacionin e nevojshëm dhe kur është e nevojshme, të rishikojnë programin e propozuar të bashkëpunimit ndërkuftar.

5. Kur aprovet çdo program i bashkëpunimit ndërkuftar duke ndjekur rrugën formale të nënshkrimit të tij, Komisioni duhet të sigurojë se cilido prej vëzhgimeve të tij janë marrë në konsideratë.

6. Kërkesat për amendime të Programit të dorëzuara nga vendet pjesëmarrëse duhet të konkretizohen në mënyrën e duhur dhe duhet në mënyrë specifike të identifikojnë ndikimin e pritshëm të ndryshimeve të Programit në arritjen e objektivave të saj. Këto kërkesa duhet të shoqërohen me Programin e rishikuar. Paragrafët 3 dhe 4 duhet të aplikohen për amendime të Programit.

Neni 11

Qasja për zhvillimin lokal e bazuar në komunitet, planet e përbashkëta të veprimit dhe investimet territoriale të integruara

1. Programi mund të kryejë veprime:

a) Për zhvillimin lokal të udhëhequr nga komuniteti shprehur në nenet 32 deri 35 të Rregullores së (BE) nr. 1303/2013;

b) Për planet e përbashkëta të veprimit shprehur në nenet 104 deri 109 të kësaj Rregulloreje, hartuar në përputhje me nenin 4 dhe shtojcën IV të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 2015/207¹; dhe

c) Për investimet territoriale të integruara shprehur në nenin 36 të kësaj Rregulloreje, duke marrë parasysh parimet themelore të këtyre instrumenteve dhe nenet 9 deri 11 të Rregullores ETC.

2. Rregullat dhe kushtet specifike të veprimeve të renditura në paragrafin 1 duhet të dakordësohen ndërmjet Komisionit dhe vendeve pjesëmarrëse dhe të shprehen në kushtet e veçanta të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Përzgjedhja e veprimeve

1. Veprimet nën këtë Program duhet të përzgjidhen nga Komiteti i Përbashkët i Monitorimit. Komiteti i Përbashkët i Monitorimit duhet të krijoj një komitet drejtues që do të veproj me përgjegjësinë e përzgjedhjes së veprimeve.

¹ Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2015/207 e 20 janarit 2015, që përcakton rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullores (EU) nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për sa u përket modeleve për raportin e progresit, paraqitjen e informacionit mbi një projekt madhor, plani i përbashkët i veprimit, raportet e zbatimit për investime me qëllim zhvillimin dhe punësimin, shpalljes së menaxhimit, strategjia e auditimit, opinionin e auditimit dhe raportin vjetor të kontrollit dhe metodologjinë për kryerjen e analizave kosto-përfitim dhe në pajtim me Rregulloren (BE) nr. 1299/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për sa i përket modelit për raportet e zbatimit me qëllim bashkëpunimin territorial Evropian, OJ L 38, 13.2.2015, f. 1.

2. Veprimet e përzgjedhura do të përfshijnë përfitues nga të paktën dy shtete pjesëmarrëse, ku të paktën njëri prej tyre duhet të jetë një shtet anëtar. Një operacion mund të zbatohet në një vend të vetëm pjesëmarrës, me kusht që ndikimet dhe përfitimet ndërkufitare të jenë identifikuar.

3. Përfituesit duhet të bashkëpunojnë në zhvillimin dhe zbatimin e këtyre veprimeve. Si rrjedhojë, ata duhet të bashkëpunojnë si në staf, ashtu edhe në financimin e operacioneve.

Neni 13

Lejet dhe autorizimi

Çdo lloj i lejes dhe/ose autorizimit i nevojshëm për zbatimin e Programit duhet të sigurohet nga autoritetet kompetente përfituese të IPA II, në përputhje me ligjin kombëtar, përpara se dokumenti grant i referuar në nenin 14 (6) të jetë ofruar përfituesit udhëheqës prej autoritetit menaxhues.

Neni 14

Përfituesit

1. Kur ka dy ose më shumë përfitues për një operacion nën të njëjtin Program, një prej tyre do të përzgjidhet nga gjithë përfituesit si përfituesi udhëheqës.

2. Përfituesi udhëheqës duhet të ndërmarrë detyrat e mëposhtme:

a) të përcaktojë marrëveshjet me përfituesit e tjerë ku të përfshihen dispozita që, ndër të tjera, garantojnë një menaxhim financiar të qëndrueshëm të fondeve të akorduara për funksionimin e operacioneve, duke përfshirë dhe alokimet e nevojshme të shumave të paguara në mënyrë të padrejtë apo me probleme;

b) të marrë përgjegjësinë për sigurimin e zbatimit të gjithë operacionit;

c) të sigurojë që shpenzimet e paraqitura nga të gjithë përfituesit janë kryer për zbatimin e operacioneve dhe veprimeve dhe korrespondojnë me aktivitetet e rënë dakord ndërmjet gjithë përfituesve dhe janë në përputhje me dokumentacionin e grantit ofruar nga autoriteti menaxhues ashtu sikurse është dhënë në paragrafin 6;

d) të sigurojë që shpenzimet e prezantuara nga përfituesit e tjerë janë verifikuar nga një kontrollues (a)¹ ku ky verifikim nuk duhet të kryhet nga autoriteti menaxhues, në përputhje me nenin 23 (1) i Rregullores ETC.

3. Nëse nuk është specifikuar ndryshe në marrëveshjet e përmendura në pikën (a) të paragrafit (2), përfituesi kryesor duhet të sigurojë që përfituesit e tjerë të marrin shumën totale të mbështetjes publike sa më shpejt të jetë e mundur dhe në mënyrë të plotë. Asnjë shumë nuk duhet të zbritet ose mohohet dhe asnjë pagesë tjetër e veçantë ose pagesa të tjera me efekt të njëjtë nuk do të reduktojnë këto shuma për përfituesit e tjerë.

4. Përfituesit udhëheqës apo të vetëm duhet të jenë vendosur në një nga vendet pjesëmarrëse.

5. Pavarësisht nga neni 12, pika 2, një grupim evropian për bashkëpunimin territorial (EGTC) ose ndonjë organ tjetër juridik i themeluar sipas ligjeve të një prej vendeve pjesëmarrëse mund të aplikojë si përfitues i vetëm për një operacion vetëm nëse ky i fundit është themeluar nga autoritetet dhe organet publike e të paktën dy shteteve pjesëmarrëse.

6. Autoriteti menaxhues duhet të ofrojë vendit udhëheqës ose përfituesit të vetëm për çdo operacion një dokument ku përcaktohen kushtet për mbështetjen e operacionit, duke përfshirë edhe kërkesat e veçanta në lidhje me produktet apo shërbimet që do të dërgohen në bazë të operacionit, planin e financimit dhe afatin për ekzekutim ("dokumenti grant").

SEKSIONI III MONITORIMI

Neni 15

Komiteti i Përbashkët i Monitorimit (ngritja dhe përbërja)

1. Brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendeve anëtare lidhur me vendimin që miraton Programin, vendet pjesëmarrëse duhet të kenë ngritur një Komitet të Përbashkët të Monitorimit ("KPM").

¹ Siç përcaktohet në nenin 42(2)

2. KPM-ja duhet të përbëhet nga përfaqësues të Komisionit, nga koordinatorët kombëtarë IPA ("NIPAC") dhe autoritetet e tjera kombëtare përkatëse dhe organet përfituese të IPA II, vendet pjesëmarrëse dhe, aty ku është përkatëse, institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe aktorët e tjerë, duke përfshirë këtu shoqërinë civile dhe organizatat e sektorit privat. Lista e anëtarëve të KPM-së duhet të publikohet.

3. KPM-ja duhet të udhëhiqet nga një përfaqësues i një prej vendeve pjesëmarrëse ose prej autoritetit menaxhues

4. Komisioni duhet të marrë pjesë në punën e KPM-së duke luajtur rolin e kapacitetit këshillues

5. Nëse Banka Evropiane e Investimeve (EIB) kontribuon në Program, atëherë ajo mund të marrë pjesë në punën e KPM-së në cilësinë e këshilltarit.

6. KPM-ja duhet të përshtatë rregullat e tij të procedurës.

7. KPM-ja duhet të mbledhet të paktën një herë në vit. Takime të tjera, gjithashtu, mund të organizohen me nismën e një prej shteteve pjesëmarrëse ose të Komisionit, veçanërisht në bazë tematikash.

Neni 16

Funksionet e Komitetit të Përbashkët Monitorues

1. KPM-ja do të shqyrtojë efektivitetin e përgjithshëm, cilësinë dhe koherencën e zbatimit të të gjitha veprimeve drejt përmbushjes së objektivave të përcaktuar në Program, marrëveshjeve të financimit dhe dokumenteve strategjike përkatëse. Komiteti mund të bëjë rekomandime për veprime korrigjuese sa herë është e nevojshme.

KPM-ja duhet të shqyrtojë të gjitha problema-tikat që cenojnë performancën e Programit, duke përfshirë konkluzionet e performancës së rishikuar.

Komiteti mund të bëjë vrojtime tek autoriteti menaxhues për sa i përket zbatimit dhe vlerësimit të Programit përfshirë veprimet e lidhura me reduktimin e barrës administrative për përfituesit.

Komiteti duhet të monitorojë veprimet e ndërmarra si rezultat i vrojtimeve.

2. KPM-ja dhe autoriteti menaxhues duhet të kryejnë monitorimin duke iu referuar treguesve të parashtruar në Program, në përputhje me nenin 16 të Rregullores së Bashkëpunimit Territorial (ETC).

3. KPM-ja duhet të shqyrtojë dhe aprovojë:

a) metodologjia dhe kriteret e përdorura për përzgjedhjen e veprimeve;

b) raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit;

c) planin e vlerësimit për Programin dhe çdo ndryshim të planit të vlerësimit në përputhje me nenin 21 (6);

d) strategjia e komunikimit për Programin dhe çdo ndryshim në strategji;

e) çdo propozim nga autoriteti menaxhues për çdo ndryshim në Program.

4. KPM-ja duhet të shqyrtojë në veçanti:

a) çdo çështje që ndikon në performancën e programit operativ;

b) progresin e bërë në zbatimin e planit të vlerësimit dhe ndjekjen e rezultateve të vlerësimit;

c) zbatimin e strategjisë së komunikimit;

d) zbatimin e planeve të përbashkëta të veprimit;

f) veprime për të nxitur barazinë midis burrave dhe grave, shanseve të barabarta dhe mosdiskriminim, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara;

g) veprime për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm.

Neni 17

Raportimi

1. Prej 31 majit 2016 dhe në çdo 31 maj të viteve pasardhëse deri dhe duke përfshirë 2023-n, autoriteti menaxhues duhet t'i plotësojë Komisionit një raport zbatimi vjetor në përputhje me nenin 50(1) të Rregullores së BE-së nr. 1303/2013.

Raporti zbatimit duhet të dorëzohet më 2016-n dhe duhet të mbulojë vitet financiare 2014 dhe 2015.

2. Për raportet e dorëzuara më 2017-n dhe 2019-n, afati përfundimtar referuar paragrafit 1 do të jetë data 30 qershor.

3. Raportet vjetore të zbatimit duhet të vendosin informacione të rëndësishme në lidhje me zbatimin e Programit dhe prioritetet e tij, duke u referuar të dhënave financiare, treguesve specifikë dhe të përbashkët

të programit, si dhe vlerave të synuara sasiore, përfshirë ndryshimet në vlerat e treguesve së rezultatit kur është e nevojshme dhe, duke filluar nga raporti vjetor zbatimit të paraqitur në vitin 2017, piketa të përcaktuara në kuadrin e performancës. Të dhënat e transmetuara duhet të kenë lidhje me vlerat e treguesve të operacioneve të zbatuara plotësisht dhe, gjithashtu, kur është e mundur, duhet marrë në konsideratë faza e zbatimit për operacionet e përzgjedhura. Ata, gjithashtu, duhet të përcaktojnë një sintezë të gjetjeve nga të gjitha vlerësimet e programit që janë bërë të disponueshme gjatë vitit të kaluar financiar, çështje të cilat ndikojnë në ecurinë e programit dhe masat e ndërmarra.

4. Neni 14(3) dhe (4) të Rregullores së ETC-së do të zbatohen për sa u përket raporteve të zbatimit.

5. Raportet vjetore dhe finale të zbatimit duhet të hartohen në përputhje me nenin 8 dhe shtojcën X të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 2015/207.

Neni 18

Takimi vjetor për rishikimin

1. Takimi vjetor i rishikimit do të organizohet ndërmjet Komisionit, shteteve anëtare dhe përfituesve të IPA II çdo vit nga 2016 deri më 2023-n duke përfshirë edhe këtë vit, për të shqyrtuar punën e Programit, duke marrë parasysh raportin vjetor të zbatimit dhe vërtetimet e Komisionit aty ku është e zbatueshme. Takimi vjetor i rishikimit mund të mbulojë më shumë se një program.

2. Si përjashtim nga paragrafi 1, shtetet anëtare dhe Komisioni mund të bien dakord që të mos organizojnë një takim vjetor rishikimi për Programin ndër vite, përveç 2017-s dhe 2019-s. Në këtë rast, shqyrtimi vjetor mund të bëhet me shkrim.

3. Takimi Rishikimi vjetor do të kryesohet nga Komisioni, ose, nëse shteti anëtar kërkon kështu, i bashkëkryesuar nga shteti anëtar dhe Komisioni.

4. Vendi anëtar dhe përfituesi IPAII duhet të sigurojnë mbarëvajtjen e duhur bazuar komenteve të dhëna nga Komisioni duke marrë parasysh problematikat e identifikuara gjatë takimit të rishikimit, të cilat cenojnë zbatimin e Programit dhe kur është e përshtatshme, të informojë Komisionin rreth masave të marra, brenda tre muajve.

Neni 19

Transmetimi i të dhënave

1. Prej 31 janarit, 31 korrikut dhe 31 tetorit të çdo viti, autoriteti menaxhues do të transmetojë Komisionit në mënyrë elektronike për qëllime monitorimi, lidhur me Programin dhe për akset prioritare:

a) Kostot publike të lejuara dhe totale të operacioneve dhe atyre veprimeve të përzgjedhura për mbështetje dhe ndihmë;

b) Shpenzimet totale të lejuara të deklaruara nga përfituesit drejt autoritetit menaxhues.

2. Përveç kësaj, transmetimi i bërë nga 31 janari duhet të përmbajë të dhënat e përmendura në pikat (a) dhe (b) të paragrafit 1, ndarë sipas kategorisë së ndërhyrjes. Ky transmetim do të konsiderohet për të përmbushur kërkesat për paraqitjen e të dhënave financiare të referuara në nenin 17 (2).

Të dhënat financiare duhet të transmetohen në përputhje me nenin 2 dhe shtojcën II të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 1011/2014.

3. Një parashikim i shumës për të cilën autoriteti menaxhues pret që të dorëzojnë aplikimet e pagesave për vitin aktual financiar dhe pas viti financiar do të shoqërojë transmetimi të bëhet nga 31 janari dhe 31 korriku¹.

4. Afati i fundit për të dhënat e paraqitura sipas këtij paragrafi do të jetë fundi i muajit pararendës i muajit të dorëzimit.

Neni 20

Informimi dhe komunikimi

¹ Rregullorja e Zbatimit të Komisionit (BE) nr. 1011/2014 e 22 shtatorit 2014, që përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, sa i përket modeleve për paraqitjen e informacioneve të caktuara të Komisionit dhe të rregullat e hollësishme në lidhje me shkëmbimin e informacionit ndërmjet përfituesve dhe autoriteteve menaxhuese, autoritetet certifikuese, autoritetet e kontrollit dhe strukturat e ndërmjetme, GZ L 286, 30.9.2014, f. 1.

1. Autoriteti menaxhues duhet të koordinojë detyrat lidhura me kërkesat për informacion, publicitetit dhe transparencës në bazë të paragrafëve 2 dhe 3.

Me anë të derogimit nga neni 25 i II IP IPA, autoriteti menaxhues do të jetë përgjegjës për aktivitetet e informacionit dhe komunikimit, si të përcaktuara në nenet 115 dhe 116 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

Duhet të zbatohen nenet nga 3 deri në 5 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 821/2014¹, lidhur me karakteristikat teknike për sa u përket masave të informimit dhe komunikimit për veprimet dhe udhëzimet e nevojshme për krijimin e stemës së Unionit dhe përkufizimit të ngjyrave standarde.

2. Çdo aktor që përfshihet në zbatimin e asistencës IPA II, siç përcaktohet në pikat (a) deri (c) të nenit 58 (1) të rregullores financiare duhet të përmbushë kërkesat për informacion, publicitet dhe transparencë në përputhje me nenin 35 (2) të kësaj Rregulloreje, dhe të sigurojë transparencën e duhur të veprimeve.

3. Dokumentet strategjike dhe shumëvendëshe dhe çdo rishikim i tyre, përfshirë dhe i programeve, duhet të jenë dokumente publike aty ku është e mundur, dhe duhet të jenë të disponueshme për publikun e gjerë dhe shoqërinë civile.

SEKSIONI IV VLERËSIMI

Neni 21

Parimet e vlerësimit dhe vlerësimet specifike

1. Asistenca IPA II e do të jetë objekt i vlerësimeve, në përputhje me nenin 30 (4) të rregullores financiare me qëllim të përmirësimit të përshtatshmërisë së saj, koherencën, cilësinë, efikasitetin, efektivitetin, vlerën e shtuar të Unionit, qëndrueshmërinë dhe sinergjinë me politikat përkatëse dialoguese.

2. Vlerësimet mund të kryhen në nivele politike, strategjike, tematike, sektoriale, të programit dhe atë operacionale, si në nivel vendi edhe në nivel rajonal.

3. Rezultatet e vlerësimeve duhet të merren parasysh nga KPM-ja.

4. Vlerësimet duhet të kryhen nga ekspertë të brendshëm apo të jashtëm që janë funksionalisht të pavarur nga autoritetet përgjegjëse për zbatimin e programit. Të gjitha vlerësimet duhet të bëhen publike.

5. Vendet pjesëmarrëse së bashku duhet të kryejnë një vlerësim ex ante në përputhje me neni 55 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

Neni 56 i Rregullores (BE) nr. 1303/2013 në lidhje me vlerësimin gjatë periudhës së programimit duhet të zbatohen.

Në veçanti, autoriteti menaxhues duhet të hartojë një plan vlerësimi që do të dorëzohet në KPM jo më vonë se një vit pas miratimit të Programit.

6. Neni 57 i Rregullores (BE) nr. 1303/2013 në lidhje me vlerësimin ex post duhet të zbatohen.

SEKSIONI V ASISTENCA TEKNIKE

Neni 22

Qëllimi dhe kufiri (tavani)

1. Programi duhet të përfshijë një shpërndarje të veçantë buxhetore për sa u përket operacioneve të asistencës teknike, duke përfshirë përgatitjen, menaxhimin, monitorimin, vlerësimin, informimin, komunikimin, ndërlidhjen, zgjidhjen e ankesave, kontrollit dhe auditimit të aktiviteteve që lidhen me zbatimin e programit dhe aktiviteteve që përforcojnë kapacitetet administrative për zbatimin e programit.

Asistenca e IPA II mund të përdoret edhe nga vendet pjesëmarrëse për të mbështetur veprimet për reduktimin e barrës administrative për përfituesit, duke përfshirë sistemet e shkëmbimit të të dhënave elektronike, dhe veprimet për të përforcuar kapacitetin e tyre, si dhe shkëmbimin e praktikave më të mira mes autoriteteve të vendeve pjesëmarrëse dhe përfituesve që do të administrojnë dhe përdorin asistencën

¹ Rregullorja e Zbatimit të Komisionit (BE) nr. 821/2014 e 28 korrikut 2014, që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me masat e detajuara për transferimin dhe menaxhimin e kontributeve të programit, raportimi mbi instrumentet financiare, karakteristikat teknike të masave për informacionin dhe komunikimin lidhur me operacionet dhe sistemit për të regjistruar dhe ruajtur të dhënat, GZ L 223, 29.7.2014, f. 7.

IPA II.

Këto veprime mund t'i përkasin periudhave të mëparshme ose të mëvonshme të programimit.

2. Shuma e ndihmës IPA II që do të shpërndahet për ndihmë teknike do të kufizohet në 10% të shumës totale të përcaktuar për Programin, por nuk duhet të jetë më pak se 1, 000, 500 EURO.

Neni 23

Pranueshmëria

Shpenzimet e asistencës teknike për mbësh-tetjen e përgatitjes së Programit dhe ngritjen e strukturave menaxheriale dhe sistemeve të kontrollit duhet të jenë të pranueshme para datës së vendimit të Komisionit për miratimin e Programit, por jo më parë se 1 janari 2014.

SEKSIONI VI

PRANUESHMËRIA E SHPENZIMEVE DHE KOHËZGJATJA E OPERACIONEVE

Neni 24

Parimet e pranueshmërisë

Në përputhje me nenin 43 (5) IPA II IP hierarkia e rregullave të lejueshmërisë për këtë Program është themeluar si më poshtë:

Pa cenuar rregullat e lejueshmërisë të përcaktuara në këtë nen dhe në nenin 33 (2), ose në aktet e deleguara të sipërpërmendura në nenet 27 dhe 28, vendet pjesëmarrëse në KPM duhet të vendosin rregulla shtesë për shpenzimet e lejueshme për të gjithë Programin.

Për çështje që nuk parashikohen në rregullat e lejueshmërisë të përcaktuara në këtë nen ose në aktet e deleguara të përmendura në nenet 27 dhe 28, apo në rregullat e vendosura nga vendet pjesëmarrëse në përputhje me paragrafin e tretë, rregullat kombëtare të shtetit anëtar ose të vendit përfitues IPA II në të cilin kanë ndodhur këto shpenzime.

1. Një veprim mund të ketë mbështetje nga ky Program apo prej ndonjë prej instrumenteve të Unionit, me kusht që zëri i shpenzimeve i përfshirë në aplikimin e pagesave për rimbursim nga Asistenca e IPA II nuk përkrahet apo mbështetet nga ndonjë instrument tjetër i Unionit apo Asistencës IPA II të ndonjë programi tjetër.

2. Në përputhje me neni 3 (2) të Rregullores (BE) nr. 10301/2013, ndihma e IPA II mund të mbështesë ndarjen e mbështetjes dhe burimeve njerëzore dhe të gjitha llojet e infrastrukturës përtej kufijve të këtij Programi.

3. Me përjashtim të nenit 30, ky seksion nuk zbatohet për Asistencën Teknike. Seksioni V do të zbatohet.

Neni 25

Pranueshmëria në kohë

1. Shpenzimet janë të lejuara për financim nën IPA II- asistenca e bashkëpunimit ndërkufitar:

a) nëse ajo ka ndodhur dhe paguar nga ndonjë prej përfituesve të vendeve anëtare ndërmjet datave 1 janar 2014 dhe 31 dhjetor 2023; ose

b) nëse ka ndodhur nga ndonjë prej përfituesve të IPA II dhe paguar pasi është nënshkruar Programi, por jo më vonë se 31 dhjetori 2023.

2. Në rastin e shpenzimeve të rimbursuara në përputhje me pikat (b) dhe (c) të paragrafit të parë të nenit 26 (2), veprimet që përbëjnë arsyet për rimbursim duhet të kryhen ndërmjet 1 janarit 2014 dhe 31 dhjetorit 2023.

3. Shpenzimet që konsiderohen si të lejueshme si rezultat i një amendamenti në program duhet vetëm të bëhen të lejuara vetëm prej datës së dorëzimit në Komision të kërkesës për amendament ose, në rast të aplikimit të nenit 10 (6), nga data e hyrjes në fuqi të vendimit për amendimin e programit.

Neni 26

Format e mbështetjes; format e granteve dhe asistencës së shlyeshme

1. Ndihma e IPA II do të përdoren për të siguruar mbështetje në formën e granteve, shpërblimeve dhe asistencë të shlyeshme, ose një kombinim mes tyre.

Në rastin e asistencës së shlyeshme, mbështetja e cila shlyhet në organin që e ka ofruar atë, ose në autoritetet e tjera kompetente të vendeve anëtare apo vendeve përfituese të IPA II, duhet të mbahen në llogari të veçuara apo të ndara me kodet përkatëse të mbajtjes së llogarive dhe të mund të ripërdoren për të njëjtin qëllim dhe në përputhje me objektivat e Programit.

2. Grantet dhe ndihma e shlyeshme mund të marrë një prej formave të mëposhtme:

- a) kompensim kostosh të lejuara të cilat janë faktike dhe janë shlyer, së bashku me, aty ku është e zbatueshme, formën e kontributeve në natyrë dhe amortizimin;
- b) shkallë standarde të kostove për njësi;
- c) shumat totale jo më tepër se 100 000 euro nga kontributi publik;
- d) financim me normë të sheshtë, i përcaktuar nga aplikimi i një përqindjeje të një ose më shumë kategorish kostosh të përcaktuara.

Opsionet e përmendura në nënparagrafin e parë mund të kombinohen vetëm kur secili opsion mbulon kategoritë e ndryshme të shpenzimeve kur ato janë përdorur për projekte të ndryshme por që përbëjnë vetëm një pjesë të një operacioni ose për kategoritë që mbulojnë faza të njëpasnjëshme të një operacioni.

3. Për sa i përket aftësisë juridike apo lejueshmërisë së kontributeve në natyrë në formën e dispozitave lidhur me punën, mallrat, shërbimet, token dhe pasuritë e patundshme, zbatohet neni 69 (1) i Rregullores së (BE) nr. 1303/2013.

4. Shpenzimet e amortizimit mund të konsiderohen si të pranueshme bazuar në nenin 69 (2) të Rregullores së (BE) nr. 1303/2013.

Neni 27

Normat e sheshta për shpenzimet e tërthorta dhe shpenzimet e personelit

1. Kur zbatimi i një operacioni shkakton kostot e tërthorta, ato mund të llogariten me një normë të sheshtë në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) Normë e sheshtë deri në 25% e kostove të lejuara direkte, me kusht që norma është llogaritur mbi bazën e një metode të drejtë, të barabartë dhe të verifikueshme apo me anën e një metode të zbatuar në skemat e granteve të financuara nga vendet anëtare ose të përfituesve të IPA II për lloje të ngjashme operacionesh apo përfituesish;

b) Normë e sheshtë deri në 25% e kostove të lejuara që lidhen drejtpërdrejt me personelin pa pasur nevojën e një kërkesë për vendin anëtar apo përfituesin IPA II për kryerjen e një llogaritje për përcaktimin e normës së zbatueshmërisë;

c) Normë e sheshtë që zbatohet mbi kostot direkte të lejuara bazuar në metodat ekzistuese dhe normave që korrespondojnë, të zbatueshme në politikat e Bashkimit Evropian për lloje të ngjashme funksionimi dhe përfituesish.

Zbatohen nenet 20 dhe 21 të Komisionit të parashtruar në Rregulloren e (BE) nr. 480/2014¹ për sa i përket përcaktimit të normës së sheshtë dhe metodave lidhur me të, referuar në pikën (c) të këtij nënparagrafi të parë në këtë paragraf.

2. Për të përcaktuar kostot e personelit që kanë të bëjnë me zbatimin e një projekti, norma e zbatueshme për orë mund të llogaritet duke ndarë nga 1720 orë koston bruto të punësimit të dokumentuar së fundmi.

3. Shpenzimet e stafit për një operacion mund të llogariten me një normë të sheshtë prej deri në 20% e kostove direkte, përveç shpenzimeve të tjera të stafit për këtë operacion.

Neni 28

Rregullat e veçanta të pranueshmërisë për kategori të caktuara të shpenzimeve

1. Zbatohet Rregullorja e (BE) nr. 481/2014² e deleguar e Komisionit.

2. Gjithsesi, me përjashtim të nenit 5 (5) deri (8) të kësaj Rregulloreje, në vijim vlen:

¹ Të ndryshuar me Rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2015/616 e datës 13 shkurt 2015, e cila ndryshon Rregulloren e deleguar (BE) nr. 480/2014 sa i përket referencave të Rregullores (BE) nr. 508/2014 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, GZ L 102, 2015/04/21, f. 33.

² Rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) nr. 481/2014 e datës 4 mars 2014, që plotëson Rregulloren (BE) nr. 1299/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me rregullat specifike të drejtën e shpenzimeve për programet e bashkëpunimit, GZ L 138, 13.5.2014 f. 45.

a) Veprimtari lidhur me asistencën teknike apo aktivitete promocionale dhe ato lidhur me ngritjen e kapaciteteve, shpenzime që ndodhin jashtë zonës së programit do të konsiderohen si të lejueshme, vetëm nëse janë kryer në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikat (a) dhe (c) të nenit 30 (2).

b) Për sa u përket personave të tjerë, përveç atyre që mbulohen nga pikat c) dhe d), autoriteti menaxhues mund të pranojë kostot e akomodimit dhe ushqimit që janë kryer në vende të cilat kanë vendndodhje jashtë zonës së lejuar të programit, gjithmonë nëse ndodhin në përputhje me nenin 30(2). Kjo do të zbatohet, gjithashtu, për kostot e transportit lokal në vendin e eventit ose të ndonjë aktiviteti jashtë zonës së programit.

c) Për stafin e përfituesve të cilët ndodhen jashtë zonës së programit, autoriteti menaxhues mund të pranojë ato kosto që janë të përmendura në paragrafin 1, duke përfshirë edhe kostot e udhëtimit duke u bazuar te vendndodhja brenda ose jashtë zonës së programit, si e një ngjarjeje apo një aksioni apo veprimtarie, në qoftë se këto të fundit janë në përputhje me nenin 30 (2).

d) Për stafin e përfituesve që ndodhen brenda zonës së lejuar të programit, kostot referuar paragrafit 1, duke përfshirë edhe kostot e udhëtimit për në një vendndodhje të një eventit apo veprimtarie, duhet të konsiderohen të lejuara bazuar nenit 30(1).

Neni 29

Shpenzimet e papranueshme

1. Asistenca e bashkëpunimit ndërkufitar IPA II nuk duhet të mbulojë:

a) interesin mbi borxhin;

b) tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), përveç aty ku ajo është jo e kthyeshme sipas legjislacionit kombëtar të TVSH-së;

c) dekomisionimit apo nxjerrja jashtë funksionit dhe ndërtimin e centraleve bërthamore;

d) investimi për të arritur pakësimin e emetimeve të gazrave serë nga aktivitetet në kuadër të shtojcës I të direktivës 2003/87/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian (11);

e) prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit dhe produkteve të duhanit;

f) ndërmarrjeve në vështirësi siç përcaktohet në bazë të rregullave të ndihmës shtetërore të Unionit;

g) investimet në infrastrukturën e aeroportit, përveç rasteve kur këto investime lidhen me mbrojtjen e mjedisit apo kur ato shoqërohen me investime të nevojshme për të lehtësuar apo për të reduktuar ndikimin negativ në mjedis.

2. Blerja e tokës, të pandërtuar dhe të ndërtuar, deri në vlerën e 10% të kostos totale të lejuar të kryer në kuadër të veprimtarisë në fjalë, duhet të jetë e lejueshme për financim nën asistencën e bashkëpunimit ndërkufitar IPA II. Për sheshe të braktitura dhe për ato sheshe që më parë kanë qenë për përdorim industrial dhe që kanë ndërtesa, ky kufizim do të rritet në 15%. Në rastet e veçanta dhe përkatësisht të justifikuara të atyre veprimtarive të cilat lidhen me ruajtjen e mjedisit, ky afat mund të vendoset edhe mbi përqindjet e mësipërme.

3. Veprimtaritë nuk duhet të përzgjidhen apo financohen nga asistenca e IPA II në momentin kur ato kanë përfunduar fizikisht apo janë zbatuar përpara se aplikimi për fonde nga ky program të jetë dorëzuar tek Autoriteti Menaxhues, edhe nëse të gjitha pagesat mund të jenë kryer nga përfituesi.

4. Në përputhje me pikën (l) të nenit 4 të Rregullores së (BE) nr. 481/2014 e Komisionit të Deleguar, pagesat për transaksionet financiare brenda një vendi anëtar ose brenda vendit përfitues IPA nuk janë të pranueshme.

Neni 30

Pranueshmëria në varësi të vendndodhjes

1. Operacionet, subjekt i shmangieve të përmendura në paragrafët 2 dhe 3, duhet të jenë të vendosura në zonën e programit që përfshin një pjesë të territorit të vendeve pjesëmarrëse të përcaktuara në Programi ("zona e programit").

2. Autoriteti menaxhues mund të pranojë që të gjitha ose një pjesë e një operacioni të zbatohet jashtë zonës së programit, me kusht që të plotësohen gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Projekti është në interesin e zonës së programit;

b) Shuma e përgjithshme e caktuar në kuadër të programit të bashkëpunimit ndërkufitar me operacionet

e vendosura jashtë zonës së programit nuk kalon 20% të mbështetjes nga Unioni në nivel programi;

c) Detyrimet e autoriteteve të menaxhimit dhe auditimit në lidhje me menaxhimin, kontrollin dhe auditimin për sa i përket operacionit janë përmbushur nga autoritetet e programit të bashkëpunimit ndërkufitar, ose ata të hyjnë në marrëveshje me autoritetet në shtetin anëtar ose në vendin në të cilin operacioni është zbatuar;

3. Për operacionet që lidhen me asistencën teknike, aktivitete promovuese dhe ngritje kapacitetesh, shpenzimet mund të kryhen jashtë zonës së programit duke siguruar që kushtet e përcaktuara në pikat (a) dhe (c) të paragrafit 2 janë përmbushur.

Neni 31

Operacionet që gjenerojnë të ardhura neto pas përfundimit

1. Ky nen zbatohet për operacionet të cilat gjenerojnë të ardhura neto pas përfundimit të tyre. Për qëllimet e këtij neni “të ardhura neto” nënkupton të ardhura me para në dorë (cash) të paguara direkt nga përdoruesit për mallrat ose shërbimet e ofruara nga operacioni, të tilla si pagesa që përballohen drejtpërdrejt nga përdoruesit për përdorimin e infrastrukturës, shitje ose me qira të tokës apo ndërtesave, ose pagesat për shërbime më pak se ndonjë kosto operative dhe kostot e zëvendësimit të pajisjeve të amortizuara të shkaktuara gjatë periudhës përkatëse. Kursimet e gjeneruara nga operacioni do të trajtohen si të ardhura neto nëse ato nuk janë kompensuar nga një reduktim të barabartë në subvencioneve operative.

Kur jo e gjithë kostoja e investimeve është e pranueshme për bashkëfinancim, të ardhurat neto do të ndahen proporcionalisht me pjesët e pranueshme dhe jo të pranueshme të koston së investimit.

2. Shpenzimet e pranueshme të operacionit për t'u bashkëfinancuar nga asistenca IPA II, do të reduktohen në paraprakisht, duke pasur parasysh potencialin e operacionit për të gjeneruar të ardhura neto gjatë një periudhe të caktuar referimi që mbulon edhe zbatimin e operacionit dhe periudhës pas përfundimit të tij.

3. Të ardhurat neto potenciale të operacionit do të përcaktohen paraprakisht nga një prej metodave të mëposhtme të zgjedhura nga autoriteti menaxhues për një sektor, nënsektor ose llojin e operacionit:

a) aplikimi i një norme të sheshtë të përqindjes së të ardhurave neto për sektorin apo nënsektorin të zbatueshme për operacionin siç përcaktohet në shtojcën V të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 ose në ndonjë prej veprimeve të deleguara të përmendura në nënparagrafët e dytë, tretë dhe të katërt.

b) llogaritja e të ardhurave neto të zbritura të operacionit, duke marrë parasysh periudhën referuese të përshtatshme për sektorin apo nënsektor të zbatueshme për operacionin, përfitimet që normalisht priten nga kategoria e investimeve në fjalë, aplikimi i parimit ndotësi paguan dhe nëse është e përshtatshme, vlerësimi i kapitalit lidhur me mirëqenien relative të shtetit anëtar ose rajonit në fjalë.

Në përputhje me nenet 1 dhe 2 të Rregullores së deleguar të Komisionit (BE) nr. 2015/1516¹ për operacionet në sektorin e kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit do të vendoset një normë e sheshtë prej 20%, siç referohet në pikën (a) të nënparagrafit të parë.

Kur zbatohet metoda e përmendur në pikën (a) të nënparagrafit të parë, të gjitha të ardhurat neto të gjeneruara gjatë zbatimit dhe pas përfundimit të operacionit do të konsiderohen se duhet të merret parasysh nga aplikimi i normës së sheshtë dhe për këtë arsye nuk do të zbriten më pas nga shpenzimet e lejueshme të operacionit.

Kur është vendosur një normë të sheshtë për një sektor apo nënsektor të ri me miratimin e një akti të deleguar, në përputhje me nënparagrafët tretë dhe të katërt, një autoritet menaxhues mund të zgjedhë për të aplikuar metodën e përcaktuar në pikën (a) të nënparagrafit të parë për operacione të reja në lidhje me sektorin apo nënsektorin në fjalë.

Nenet 15 deri 19 të Rregullores së deleguar të Komisionit (BE) nr. 480/2014² do të zbatohen në lidhje

¹ Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2015/1516 e datës 10 qershor 2016, që vendos në pajtim të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, një normë të sheshtë për operacionet që financohen nga fondet Strukturore Evropiane dhe Investimit në sektorin e Kërkimit, Zhvillimit dhe Inovacionit, Gazeta Zyrtare L239, 15.9.2015, f. 65.

² Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) nr. 480/2014 e 3 marsit 2014, Rregullores plotësuese (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit që përcakton dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian, Fondine Kohezionit, Fondin Evropian Bujqësor për Zhvillim Rural dhe Marina Evropiane dhe

me metodën për llogaritjen e të ardhurave neto të zbritura të operacioneve të gjenerojnë të ardhura neto.

4. Metoda me të cilën të ardhurat neto zbriten nga shpenzimet e operacionit të përfshirë në kërkesën për pagesën dorëzuar Komisionit do të përcaktohen në përputhje me rregullat kombëtare.

5. Si një alternativë për zbatimin e metodave të përcaktuara në paragrafin 3, norma maksimale e bashkëfinancimit të referuar në nenin 50 mundet, me kërkesë të një shteti anëtar ose vendi përfitues të IPA II, të zvogëlohet në momentin e miratimit të një programi për një prioritet ose masë në të cilat të gjitha operacionet e mbështetura nën këtë prioritet apo masë mund të zbatojnë një normë të sheshtë uniforme në përputhje me pikën (a) të nënparagrafit të parë të paragrafit 3. Zbritja nuk do të jetë më pak se shumta e llogaritur duke shumëzuar e normës maksimale e bashkëfinancimit të Unionit e zbatueshme sipas rregullave specifike të financimit me normën e sheshtë përkatëse të përmendur në pikën (a) të nënparagrafit të parë të paragrafit 3.

Kur zbatohet metoda e përmendur në nënparagrafin e parë, të gjitha të ardhurat neto të krijuara gjatë zbatimit, dhe pas përfundimit të operacionit, do të konsiderohen si të marra parasysht nga aplikimi i normës së ulur të bashkëfinancimit, pra nuk do të zbriten më pas nga shpenzimet e lejueshme e operacioneve.

6. Kur nuk është objektivisht e mundur për të përcaktuar më parë të ardhurat në bazë të ndonjë nga metodat e përcaktuara në paragrafët 3 ose 5, të ardhurat neto të gjeneruara brenda tri viteve të përfundimit të një operacioni ose të afatit përfundimtar për dorëzimin e dokumenteve për mbylljen e programit të vendosur në rregullat specifike të financimit, çilido që është më herët, do të zbriten nga shpenzimet e deklaruara Komisionit.

7. Paragrafët 1 deri 6 nuk zbatohen, për:

a) operacionet, kostot totale të pranueshme të të cilëve para aplikimit të paragrafëve 1 deri 6 nuk i kalojnë 1 000 000 euro;

b) asistenca e shlyer në bazë të shlyerjes së plotë të një detyrimi dhe çmimet;

c) asistenca teknike;

d) operacionet për të cilat mbështetja publike merr formën e shumave fikse ose të kostos standarde për njësi;

e) operacionet e zbatuara nën një plan të përbashkët veprimi;

Pavarësisht nga pika (a) të nënparagrafit të parë të këtij paragrafi, kur një shtet anëtar ose përfituesi i vendit IPA II zbaton paragrafin 5, kjo mund të përfshijë në prioritetin ose masën përkatëse operacione kostoja totale e pranueshme e të cilave para aplikimit të paragrafëve 1 deri 6 nuk i kalon 1 000 000 euro.

8. Përveç kësaj, paragrafët 1 deri 6 nuk zbatohen për operacionet për të cilat mbështetja nën Program konsiston në:

a) Ndhimën de minimis;

b) Ndhimën e shtetit për SME-të, ku një limit i intensitetit të ndihmës ose kufizim i sasisë së ndihmës zbatohet në lidhje me ndihmën shtetërore;

c) ndihmën e shtetit, ku është kryer një verifikim individual i nevojave për financim, në përputhje me rregullat e zbatueshme ndihmës shtetërore.

Pavarësisht nga nënparagrafi i parë, një autoritet menaxhues mund të zbatojë paragrafët 1 deri 6 për operacionet që hyjnë nën pikat (a) deri (c) të nënparagrafit të parë të këtij paragrafi, kur kjo është e parashikuar në rregullat kombëtare.

9. Ky paragraf do të zbatohet për operacionet të cilat gjenerojnë të ardhura neto gjatë zbatimit të tyre dhe për të cilat paragrafët 1 deri 6 nuk zbatohen.

Shpenzimet e pranueshme të operacionit që do të bashkë-financohen nga financimi i IPA II do të reduktohen nga të ardhurat neto që nuk janë marrë parasysht në momentin e miratimit të operacionit të gjeneruara direkt vetëm gjatë zbatimit të tij, jo më vonë se në kërkesën përfundimtare të pagesës paraqitur nga përfituesi. Kur jo të gjitha shpenzimet janë të pranueshme për bashkëfinancim, të ardhurat neto do të ndahen proporcionalisht me pjesët e pranueshme dhe jo të pranueshme të kostos.

Nënparagrafët e tretë dhe të katërt të nenit 65, pika 8 CPR, gjithashtu, do të zbatohen.

Kohëzgjatja e operacioneve

1. Një operacion që përfshin investime në infrastrukturë apo investime produktive, do të paguajë kontributin nga asistenca e IPA II në qoftë se brenda pesë viteve të pagesës përfundimtare për përfituesit ose brenda periudhës kohore të përcaktuar në rregullat e ndihmës shtetërore, kur është e zbatueshme, i nënshtrohet si më poshtë:

- a) një ndërprerje ose zhvendosje e një aktiviteti prodhues jashtë zonës së programit;
- b) një ndryshim në pronësinë e një elementi të infrastrukturës, e cila i jep një firmë apo subjekti publik një avantazhi të parregullt;
- c) një ndryshim i rëndësishëm që ndikon në natyrën e tij, objektivat ose kushtet e zbatimit që mund të rezultojë në përmbyse të objektivave fillestarë të tij.

Shumat e paguara padrejtësisht në lidhje me operacion do të mbulohen nga shteti anëtar ose përfituesi IPA II në raport me periudhën për të cilën nuk janë përmbyshur kërkesat.

Shtetet anëtare ose përfituesi IPA II mund të shkurtojnë afatin e përcaktuar në paragrafin e parë në tre vjet në rastet që lidhen me mirëmbajtjen e investimeve apo vendeve të punës të krijuara nga SME-të.

2. Një operacion që përfshin investime në infrastrukturë apo investime produktive do të paguajë kontributin nga asistenca IPA II nëse brenda 10 viteve të pagesës përfundimtare për përfituesin veprimtaria prodhuese është subjekt i zhvendosjes jashtë Unionit, përveç kur përfituesi është një SME. Ku kontributi nga asistenca IPA II merr formën e ndihmës shtetërore, periudha prej 10 vitesh do të zëvendësohet nga një afat përfundimtar i zbatueshëm në bazë të rregullave të ndihmës shtetërore.

3. Operacionet mbështetura nga asistenca e IPA II që nuk janë investime në infrastrukturë apo investime prodhuese, kontributi nga asistenca e IPA II do të paguhet vetëm kur janë subjekt i një detyrimi për mirëmbajtjen e investimeve sipas rregullave në fuqi ndihmës shtetërore dhe ku ata i nënshtrohen një ndërprerje ose zhvendosje të një aktiviteti prodhues brenda periudhës së përcaktuar në këto rregulla.

4. Paragrafët 1, 2 dhe 3 nuk zbatohen për ndonjë operacion i cili i nënshtrohet ndërprerjes së veprimtarisë prodhuese për shkak të falimentimit jomashtres.

5. Paragrafët 1, 2 dhe 3 nuk zbatohen për personat fizikë në shtetet anëtare të cilët janë përfitues të mbështetjes së investimeve dhe pas përfundimit të operacionit të investimeve, bëhen të ligjshëm për të marrë mbështetje nën Rregulloren (BE) nr. 1309/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹, ku investimi në fjalë është e lidhur direkt me llojin e aktivitetit të identifikuar si të drejtë për mbështetje nga Fondi i Rregullimit të Globalizimit Evropian.

SEKSIONI VI PROKURIMI

Prokurimi nga përfituesit

1. Për lidhjen e kontratave të shërbimit, furnizimit dhe punës, nga përfituesit, duhet të ndiqen procedurat e prokurimit:

- a) dispozitat në nenet 190 dhe 191 të kapitullit 3 të titullit IV të pjesës së dytë të Rregullores Financiare;
- b) dispozitat e neneve 260 të 276 të kapitullit 3 të pjesës II të pjesës së dytë të Rregullores së deleguar (BE) nr. 1268/2012²;

të cilat zbatohen në të gjithë zonën e programit, si në shtetin anëtar dhe në territorin e IPA II përfituesit/ve.

2. Procedurat e prokurimit publik në lidhje me shpenzimet e lidhura me fazën përgatitore të një operacioni dhe të nisura nga përfituesit përpara dokumentit të grantit të përmendur në nenin 14 (6) që janë dhënë për përfituesit do të ndjekin edhe dispozitat e referuara në paragrafin 1.

¹ Rregullorja (BE) nr. 1309/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 dhjetor 2013 mbi Fondin Rregullimit të Globalizimit Evropian (2014-2020) dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) nr. 1927/2006, GZ L 347, 20.12.2013, f. 855.

² Rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) nr. 1268/2012 e 29 tetor 2012 mbi rregullat e zbatimit të Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Unionit, GZ L 362, 31.12.2012, f. 1.

Megjithatë, shpenzimet lidhur me procedurat e prokurimit publik të cilat janë nisur nga përfituesit sipas ligjit kombëtar të përfituesit IPA II para bërjes së Programit nuk janë të pranueshme në kuadrin e Programit, duke përfshirë nëse shpenzimet e tilla janë kryer dhe paguar pas dorëzimit të Programit.

Neni 34

Rregullat mbi kombësinë dhe origjinën

1. Pjesëmarrja në financimin e kontratave të prokurimit, granteve dhe procedurat e tjera të financimit për veprimet e financuara në kuadrin e Programit do të jetë e hapur për të gjithë personat fizikë që janë shtetas të, dhe/ose personat juridikë, të cilët janë të vendosur në mënyrë efektive në vendet pjesëmarrëse, shtetet e tjera anëtare, vende të tjera përfituese IPA II, palët kontraktuese të Marrëveshjes mbi Zonën Ekonomike Evropiane dhe vendeve partnere që mbulohen nga Instrumenti Evropian i Fqinjësisë (më poshtë të referuara si “vendet e pranueshme”) dhe për organizatat ndërkombëtare¹.

Personat juridikë mund të përfshijnë organizatat e shoqërisë civile, të tilla si: organizatat joqeveritare jofitimprurëse dhe fondacione politike të pavarura, organizatat me bazë komunitare dhe agjencitë jofitimprurëse të sektorit privat, institucionet dhe organizatat dhe rrjetet e tyre në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për sa kohë pasi janë të aftë për të pasur të drejta dhe detyrime ligjore, në përputhje me ligjet përkatëse kombëtare.

Autoriteti menaxhues mund të lejojë pjesëmarrjen në thirrjen për propozime të subjekteve pa personalitet juridik.

2. Të gjitha pajisjet e blera sipas një kontrate prokurimi, ose në përputhje me një marrëveshje granti, financiar nën IPA II duhet ta kenë origjinën nga një vend i lejueshëm.

Megjithatë, ata mund të vijnë nga çdo vend, kur shumica e pajisjeve që do të blihet është nën pragun për përdorimin e procedurës së negociuar konkurruese². Për qëllime të këtij neni, termi “origjina” është përkufizuar në nenet 23 dhe 24 të Rregullores së Këshillit (KEE) nr. 2913/92³.

Për qëllime të këtij neni, termi “origjina” është përkufizuar në nenet 23 dhe 24 të Rregullores së Këshillit (EEC) nr. 2913/92⁴.

3. Rregullat sipas këtij neni nuk zbatohen për, dhe nuk krijojnë kufizime të kombësisë për personat fizikë të punësuar ose ndryshe të kontraktuar në mënyrë të ligjshme nga një kontraktor i lejueshëm ose, kur është e zbatueshme, nënkontraktuesi.

4. Me qëllim promovimin e kapaciteteve lokale, tregjeve dhe blerjeve, prioritet do t’u jepet kontraktuesve lokalë dhe rajonale, kur Rregullorja Financiare parashikon dhënien në bazë të tenderit të vetëm. Në të gjitha rastet e tjera, pjesëmarrja e kontraktuesve lokalë dhe rajonalë do të promovohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregullores Financiare.

5. Pranueshmëria siç përcaktohet në këtë nen mund të kufizohet më tej në kushtet e veçanta të kësaj Marrëveshjeje Financiare në lidhje me kombësinë, vendndodhjen gjeografike apo natyrën e kandidatëve, ku kufizimet të tilla kërkohen nga natyra specifike dhe objektivat e veprimit dhe ku ato janë të nevojshme për zbatimin efektiv të tij, në mënyrë të veçantë për pjesëmarrjen në procedurat e dhënies në rast të veprimeve të bashkëpunimit ndërkufitar.

6. Ofertuesit, aplikuesit dhe kandidatët nga vendet jo të pranueshme ose, pa cenuar nënparagrafin e dytë të nenit 34 (2), mallrat me origjinë jo të pranueshme mund të pranohen si të pranueshme nga autoriteti menaxhues, në rast urgjence apo mospasjes së produkteve dhe shërbimeve në tregjet e vendeve në fjalë ose në raste të tjera të arsyeshme, ku zbatimi i rregullave të përshtatshmërisë do të kryejë realizimin e një projekti, programi apo veprimi të pamundur apo shumë i vështirë.

7. Personat fizikë dhe juridikë, të cilëve u janë dhënë kontrata do të përputhen me legjislacionin e mjedisit

¹ Organizatat ndërkombëtare janë organizatat ndërkombëtare të sektorit publik të përcaktuara nga marrëveshjet ndërqeveritare, agjencitë e specializuara të ngritur nga organizata të tilla dhe organizatat e tjera jofitimprurëse asimiluar në organizatat ndërkombëtare me vendim të Komisionit.

² Shihni pikën (b) (ii) të nenit 267 (1) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE, Euratom) nr. 1268/2012: kontratat me vlerë më të vogël se 100 000 euro.

³ Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 2913/92, 12 tetor 1992 që vendos Kodin Doganor të Komunitetit dhe legjislacionin tjetër të Komunitetit që rregullon origjinën jopreferenciale, GZ L 302, 19 tetor 1992, f. 1.

⁴ Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 2913/92, 12 tetor 1992 që vendos Kodin Doganor të Komunitetit dhe legjislacionin tjetër të Komunitetit që rregullon origjinën jo-preferenciale, GZ L 302, 19 tetor 1992, f. 1.

në fuqi, duke përfshirë marrëveshjet shumëpalëshe mjedisore, si dhe standardet themelore të punës të pranuar ndërkombëtarisht¹.

Neni 35

Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Kontratat e lidhura me përfituesit e vendosur në vendin përfitues të IPA II financiar sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare do të sigurojnë që përfituesi IPA II të marrë të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale të nevojshme në lidhje me teknologjinë e informacionit, studime, skica, plane, publicitet dhe çdo material tjetër të përgatitur për qëllime të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit.

2. Përfituesi IPA II do të garantojë që Komisioni, ose dikush apo ndonjë person i autorizuar nga Komisioni, do të kenë qasje dhe të drejtën për të përdorur një material të tillë. Komisioni do të përdorë materiale të tilla vetëm për qëllimet e veta.

Neni 36

Prokurimet nga autoriteti menaxhues

Për dhënien e shërbimit, pajisjeve dhe kontratave të punës nga autoriteti menaxhues, përfshirë kur kontraktohet në emër të Sekretariatit të Përbashkët ose organeve të ndërmjetme që veprojnë nën përgjegjësinë e tij, nën ndarjen e veçantë buxhetore për projektet e asistencës teknike, procedurat e prokurimit që zbatohen nga autoriteti menaxhues mund të jenë ose ato të përmendura në nenin 33 ose ato të ligjit të tij kombëtar.

SEKSIONI VIII

AUTORITETET E PROGRAMIT DHE PËRCAKTIMI I TYRE

Neni 37

Përcaktimi i autoriteteve

1. Vendet pjesëmarrëse në Program caktojnë për qëllimet e nenit 123 (1) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, një autoritet të vetëm menaxhues; për qëllim të nenit 123 (2) të kësaj Rregulloreje, një autoritet të vetëm certifikues, dhe me qëllim të nenit 123 (4) të kësaj Rregulloreje, një autoritet të vetëm auditues.

2. Procedura për caktimin e autoritetit menaxhues dhe, sipas rastit, i autoritetit certifikues, të përcaktuar në nenin 124 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, do të kryhet nga shteti anëtar në të cilin autoriteti është e vendosur.

Përshkrimi i funksioneve dhe procedurave në vend për autoritetin menaxhues dhe, sipas rastit, autoritetin certifikues duhet të hartohet në përputhje me nenin 3 dhe aneksin III të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 1011/2014.

Raporti i auditimit i organit të pavarur të auditimit të përmendur në nenin 124 (2) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 do të hartohet në përputhje me nenin 4 dhe shtojcën IV të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 1011/2014.

Mendimi i organit të pavarur të auditimit të përmendura në nenin 124 (2) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, do të hartohet në përputhje me nenin 5 dhe shtojcën V të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 1011/2014.

3. Përcaktimet e parashikuara në këtë nen nuk cenojnë ndarjen e detyrimeve në lidhje me zbatimin e korrigjimeve financiare midis vendeve pjesëmarrëse, siç parashikohet në programin e bashkëpunimit ndërkufitar.

4. Autoriteti menaxhues dhe autoriteti i auditimit duhet të ndodhet në të njëjtin shtet anëtar. Vendet pjesëmarrëse në Program mund të caktojnë autoritetin menaxhues të vetëm për të kryer funksionet e autoritetit certifikues.

¹ Standardet themelore të punës - Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), konventat për lirinë e shoqërive dhe negociatat kolektive, eliminimin e detyrueshëm të punës së detyruar, eliminimin e diskriminimit në lidhje me punësimin dhe profesionin dhe heqjen e punës së fëmijëve.

Neni 38

Funksionet e autoritetit menaxhues

Lidhur me funksionet e autoritetit menaxhues, do të zbatohet neni 125 i Rregullores (BE) nr. 1303/2013 dhe neni 23 (1), (4) dhe (5) të Rregullores ETC.

Në lidhje me të dhënat që do të regjistrohen dhe ruhen në formë të kompjuterizuar në kuadër të sistemit të monitorimit të përcaktuar në pikën (d) të nenit 125 (2) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 do të zbatohet neni 24 i Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) nr. 480/2014.

Në lidhje me sistemin e themeluar në bazë të pikës (d) të nenit 125 (2) CPR për të regjistruar dhe për të ruajtur të dhënat mbi projektet do të zbatohen nenet 6 deri 11 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 821/2014.

Në lidhje me kërkesa të detajuara minimale për gjurmët e auditimit të përmendura në pikën (d) të paragrafit të parë të nenit 125 (4) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 do të zbatohet neni 25 i Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) nr. 480/2014.

Deklarata e menaxhimit e përmendur në pikën (e) të nënparagrafit të parë të nenit 125 (4) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 do të hartohet në përputhje me nenin 6 dhe shtojcën VI të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 2015/207.

Neni 39

Sekretariati i përbashkët

Autoriteti menaxhues, pas konsultimit me vendet pjesëmarrëse, do të ngrejë një sekretariat të përbashkët.

Sekretariati i përbashkët do të ndihmojë autoritetin drejtues dhe komitetin e monitorimit dhe mund të ndihmojë autoritetin kombëtar në kryerjen e funksioneve të tyre përkatëse. Sekretariati i përbashkët do të sigurojë informacion për përfituesit e mundshëm në lidhje me financimin e mundësive në kuadër të programeve të bashkëpunimit dhe do të ndihmojë përfituesit në zbatimin e projekteve.

Neni 40

Funksionet e autoritetit certifikues

Lidhur me funksionet e autoritetit certifikues do të zbatohet neni 126 i Rregullores (BE) nr. 1303/2013 dhe neni 24 i Rregullores ETC.

Neni 41

Funksionet e autoritetit të auditimit

Lidhur me funksionet e autoritetit menaxhues do të zbatohet neni 127 i Rregullores (BE) nr. 1303/2013 dhe neni 25 i Rregullores ETC.

Strategjia e auditimit e cituar në nenin 127 (4) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, opinioni i auditit të cituar në pikën (a) të nënparagrafit të parë të nenit 127 (5) të Rregullores (EU) nr. 1303/2013 dhe raporti vjetor i kontrollit të cituar në pikën (b) të paragrafit të parë të nenit 127 (5) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 do të përcaktohet në përputhje me nenin 7 dhe shtojcat VII (strategjia e auditimit), VIII (opinion i auditit) dhe IX (raporti vjetor kontrolli) i Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 2015/207.

Në lidhje me përdorimin e të dhënave të mbledhura gjatë auditimeve të kryera nga zyrtarët e Komisionit ose përfaqësuesit e autorizuar të Komisionit do të zbatohet neni 26 i Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) nr. 480/2014.

Në lidhje me qëllimin dhe përmbajtjen e auditimeve të operacioneve dhe llogarive dhe metodologjinë për zgjedhjen e modelit të operacioneve do të zbatohen nenet 27 deri 29 të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) nr. 480/2014.

Neni 42

Funksionet e autoriteteve të përfituesit IPA II

1. Autoritetet dhe strukturat e përfituesit IPA II do të mbështesin shtetin anëtar në përgjegjësitë e tij dhe do të bashkëpunojnë me besnikëri me autoritetet e vetme të Programit.

2. Kur autoriteti menaxhues nuk kryen verifikimet sipas pikës (a) të nenit 125 (4) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 në territorin e përfituesit të IPA II, përfituesi IPA II do të caktojë strukturën ose personin

përgjegjës për kryerjen e verifikimeve të tilla në lidhje me përfituesit në territorin e saj (kontrolluesi (t)).

Në shtetin anëtar, kontrolluesit e përmendur në nënparagrafin e parë mund të jenë të njëjtat struktura përgjegjëse për kryerjen e verifikimeve të tilla për programet operative në kuadër të Investimeve për zhvillim dhe vende pune qëllimi ose, në rastin e vendeve të treta, për kryerjen e verifikimeve të krahasueshme në bazë të instrumenteve të politikës të jashtme të Unionit.

Përfituesi IPA II do të garantojë që shpenzimi i një përfituesi mund të verifikohet brenda një periudhe prej tre muajsh nga dorëzimi i dokumenteve nga ana e përfituesit në fjalë.

Përfituesi IPA II do të jetë përgjegjës për verifikimet e kryera në territorin e tij.

Kur shpërndarja e produkteve apo shërbimeve të bashkëfinancuara mund të verifikohet vetëm në lidhje me një operacion të tërë, verifikimi do të kryhet nga autoriteti menaxhues ose kontrollues i shtetit anëtar ose IPA II përfituesit ku përfituesi kryesor ndodhet.

3. Në përputhje me ligjin e vet kombëtar, përfituesi IPA II mund të autorizojë autoritetin e auditimit për të kryer drejtpërdrejt funksionet e parashikuara në nenin 127 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013 në të gjithë territorin e mbuluar nga një program bashkëpunimi. Ky autorizim duhet të specifikojë kur autoriteti i auditimit duhet të shoqërohet nga një auditues i përfituesit IPA II.

Kur autoriteti i auditimit nuk ka autorizimin e përmendur në nënparagrafin e parë, ai do të ndihmohet nga një përfaqësues nga përfituesit e IPA II në kryerjen e funksioneve të parashikuara në nenin 127 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

Përfaqësuesi nga përfituesit IPA II do të sigurojë që puna e auditimit merr parasysh standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht.

Në rastin e përshkruar në paragrafin e dytë, përfituesi IPA II do të jetë përgjegjës për auditimet e kryera në territorin e tij.

Përfaqësuesi nga vendi përfitues IPA II do të jetë përgjegjës për sigurimin e elementeve faktike në lidhje me shpenzimet në territorin e tij të cilat janë kërkuar nga autoriteti i auditimit për të kryer vlerësimin e tij.

Përfaqësuesi nga vendi përfitues IPA II do të jetë funksionalisht i pavarur nga kontrollues/rë që kryejnë verifikimet në bazë të nenit 38.

SEKSIONI IX MENAXHIMI DHE KONTROLLI

Neni 43

Parimet e përgjithshme të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit

1. Shteti anëtar do të sigurojë që sistemet e menaxhimit dhe kontrollit për programin janë ngritur në përputhje me nenet 72, 73 dhe 74.

2. Sistemet e menaxhimit dhe kontrollit në përputhje me nenin 3 (9) parashikojnë:

a) një përshkrim të funksioneve të secilit organ të përfshirë në menaxhimin dhe kontrollin, si dhe ndarjen e funksioneve brenda secilit organ;

b) pajtueshmërinë me parimin e ndarjes së funksioneve ndërmjet dhe brenda organeve të tilla;

c) procedurat për të siguruar saktësinë dhe rregullsinë e shpenzimeve të deklaruara;

d) sistemet kompjuterike për kontabilitetin, për ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave financiare dhe të dhënave për treguesit, për monitorimin dhe për raportimin;

e) sistemet për raportimin dhe monitorimin e ku organi përgjegjës i beson kryerjen e detyrave të një organi tjetër;

f) marrëveshjet për auditimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit;

g) sistemet dhe procedurat për të siguruar një auditim të përshtatshëm;

h) parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e parregullsive, duke përfshirë mashttrimin dhe rikuperimin/kompensimin e shumave të paguara padrejtësisht, së bashku me ndonjë interes në pagesat e vonuara.

3. Shtetet anëtare duhet të garantojnë që jo më vonë se 31 dhjetori 2015, të gjitha shkëmbimet e informacionit midis përfituesve dhe autoritetit menaxhues, një autoritet certifikues, një autoritet të auditimit dhe të organeve të ndërmjetme mund të bëhet me anë të sistemeve elektronike të shkëmbimit të të dhënave.

Sistemet e përmendura në nënparagrafin e parë do të lehtësojnë ndërveprimin me kuadrin kombëtar dhe të Unionit dhe do të lejojnë për përfituesit të paraqesin të gjithë informacionin e referuar në nënparagrafin e

parë vetëm një herë.

Në lidhje me shkëmbimin elektronik të informacionit do të zbatohen nenet 8 deri 10 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 1011/2014.

Neni 44

Menaxhimi i përbashkët dhe përgjegjësitë

Në përputhje me parimin e menaxhimit të përbashkët, shteti anëtar, përfituesi IPA II dhe Komisioni do të jetë përgjegjës për menaxhimin dhe kontrollin e programeve, në përputhje me përgjegjësitë e tyre përkatëse të përcaktuara në Rregulloren (BE) nr. 1303/2013, Rregullorja Financiare, Rregullorja ETC dhe Rregullorja e Zbatimit IPA.

Në lidhje me përgjegjësitë e shteteve anëtare, do të zbatohet neni 74 i Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

Neni 45

Përgjegjësitë e përfituesit IPA II

KKIPA-ja siç përcaktohet në përputhje me Marrëveshjen Kuadër do të jetë përgjegjës për koordinimin e pjesëmarrjes së përfituesit IPA II në programet ndërkufitare përkatëse. KKIPA-ja mund të delegojë këtë detyrë të koordinimit një koordinatori të bashkëpunimit territorial apo strukture operative sipas rastit.

Përfituesi IPA II do të ngrejë një sistem të kontrollit, siç përshkruhet, në përputhje me nenin 47 të rregullores së zbatimit IPA, në nenin 5 të Programit.

Neni 46

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Do të zbatohet neni 75 i Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

Neni 47

Bashkëpunimi midis Komisionit dhe autoritetit auditues

1. Komisioni do të bashkëpunojë me strukturat e auditimit për të koordinuar planet e tyre të auditimit dhe metodat dhe menjëherë do të shkëmbejnë me ato autoritete rezultatet e auditimeve të kryera në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit.

2. Komisioni, autoritetet e kontrollit dhe çdo strukturë koordinuese do të takohen mbi baza të rregullta dhe si rregull i përgjithshëm, të paktën një herë në vit, nëse nuk është rënë dakord ndryshe, për të shqyrtuar raportin vjetor të kontrollit, opinionin e auditimit dhe strategjinë e auditimit dhe për të shkëmbyer pikëpamjet mbi çështjet që lidhen me përmirësimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit.

Neni 48

Kontroli proporcional i programeve të bashkëpunimit

Do të zbatohet neni 148 i Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

SEKSIONI X

LLOGARITJA BAZË DHE INTENSITETI I NDIHMËS

Neni 49

Baza për llogaritjen e asistencës IPA II

Vendimi i komisionit miraton programin (anekset I, II dhe III), cakton normën e bashkë financimit si edhe shumat maksimale të asistencës IPA II në bazë të shpenzimeve totale të pranueshme, duke përfshirë shpenzimet publike dhe private ose shpenzimet publike të pranueshme.

Neni 50

Intensiteti i ndihmës IPA II

Shkalla e bashkëfinancimit në nivel të secilit aks prioritar të programit nuk do të jetë më pak se 20% dhe jo më shumë se 85% të shpenzimeve të pranueshme.

Përfituesit e IPA II duhet të respektojnë normën minimale të kontributit të tyre të përcaktuar në shtojcat

I dhe III. Në rast të kontributeve si nga përfitues të IPA II dhe Bashkimit Evropian, kontributi i përfituesve të IPA II do të vihet në dispozicion në të njëjtën kohë si kontributi përkatës nga Unioni.

SEKSIONI XI
MENAXHIMI FINANCIAR, ANULIMI I FONDEVE, SHQYRTIMI DHE PRANIMI I
LLOGARIVE, MBYLLJA DHE KORRIGJIMET FINANCIARE

NËNSEKSIONI 1
ANGAZHIMET DHE PAGESAT

Neni 51

Angazhimet buxhetore

1. Angazhimet buxhetore të Unionit në lidhje me programin do të bëhen me këste vjetore gjatë periudhës: 1 janar 2014 – 31 dhjetor 2020.

2. Vendimi i Komisionit për miratimin e programit do të përbëjë një vendim financimi brenda kuptimit të nenit 84 të rregullores financiare, duke njoftuar shtetin anëtar në fjalë, i cili është angazhim ligjor në kuptim të kësaj rregulloreje.

3. Për çdo program, angazhimet buxhetore për pjesën e parë do të ndjekin miratimin e programit nga ana e Komisionit.

4. Angazhimet buxhetore për këstet e mëvonshme do të bëhen nga Komisioni para datës 1 maj të çdo viti, në bazë të vendimit të përmendur në paragrafin e dytë të këtij neni, përveç kur zbatohet neni 16 i Rregullores së Financimit.

Neni 52

Rregullat e përbashkëta për pagesat

1. Pagesat e kontributit nga Komisioni për asistencën IPA të këtij programi do të bëhen në përputhje me ndarjet buxhetore, të cilat janë subjekt i fondeve në dispozicion. Çdo pagesë do të postohet më parë nga buxheti i hapur i ndihmës IPA II.

2. Pagesat do të marrin formën e parafinancimit, kundrejt pagesave të përkohshme dhe pagesës së bilancit përfundimtar.

3. Format e përkrahjes sipas pikave (b), (c) dhe (d) të pikës së parë të nenit 26 (2) dhe sipas nenit 26 (3), dhe (4), si dhe nenit 27 (1) dhe (2), kostot e llogaritura në bazë të aplikimeve do të konsiderohen si shpenzime të pranueshme.

4. Asistenca e Programit IPA II të do të paguhet në një llogari të vetme dhe jo në nënlllogari të tjera Kombëtare. Autoriteti certifikues do të marrë pagesat e bëra nga Komisioni.

5. Shteti anëtar do të sigurojë nga mbyllja e programit shumën e shpenzimeve publike e cila është e barabartë me kontributin e asistencës së IPA II, e cila paguhet nga komisioni për shtetin anëtar dhe për përfituesit e IPA II.

Neni 53

Rregullat e përbashkëta për llogaritjen e pagesave të përkohshme dhe pagesën e bilancit përfundimtar

1. Shumat e rimbursuara si pagesa të përkohshme dhe të bilancit përfundimtar do të jenë një funksion i normës specifike të bashkëfinancimit të zbatueshëm me shpenzimet e pranueshme.

2. Komisioni do të kompensojë pagesat e përkohshme 90% të shumës që rezultojnë nga zbatimi i normës së bashkëfinancimit për secilin prioritet, të përcaktuara në vendimin dhe miratimin e programit, me shpenzimet e lejuara për prioritetet përfshirë në aplikimin e pagesës. Komisioni do të përcaktojë shumën e mbetura të cilat duhet të rimbursohen si pagesa të përkohshme ose do të mbulohen në përputhje me nenin 139 të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

3. Kontributi nga asistenca e IPA II në një prioritet nëpërmjet pagesave të përkohshme dhe pagesës së bilancit përfundimtar nuk do të jetë më i lartë se:

- a) shpenzimet e pranueshme publike të cilat tregohen në aplikimet e pagesave për prioritetet;
- b) kontributi nga asistenca e IPA II për prioritetet e përcaktuara në vendimin e komisionit për miratimin

e Programit.

Neni 54

Aplikimet e pagesës

1. Kërkesat e pagesave që do të paraqiten në Komision do të sigurojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për Komisionin për të prodhuar llogaritë në përputhje me nenin 68 (3) të rregullores financiare.
2. Do të zbatohet neni 131 i Rregullores (BE) nr. 1303/201.
3. Aplikimet e pagesave duhet të dorëzohen në përputhje me modelin e përcaktuar në nenin 6 dhe shtojcën VI të Komisionit për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 1011/2014.

Neni 55

Afatet për paraqitjen e aplikimeve të pagesave të përkohshme dhe për pagesat e tyre

1. Autoriteti certifikues duhet të paraqesë në mënyrë të rregullt një kërkesë për pagesë të përkohshme në përputhje me nenin 54 (3) duke mbuluar kështu shumat hyrëse në sistemin e kontabilitetit në vitin financiar. Megjithatë, autoriteti certifikues, kur e konsideron të nevojshme, mund të përfshijnë shumat e tilla në aplikimet e pagesave të paraqitura në vitet e mëvonshme financiare.
2. Autoriteti certifikues duhet të paraqesë kërkesën përfundimtare për një pagesë të përkohshme deri më 31 korrik pas përfundimit të pagesës së vitit të kaluar dhe në çdo rast para aplikimit të parë për pagesat e pjesshme për vitin e ardhshëm të kontabilitetit.
3. Autoriteti certifikues duhet të paraqesë kërkesën përfundimtare për një pagesë të përkohshme deri më 31 korrik pas përfundimit të pagesës të vitit të kaluar dhe në çdo rast para aplikimit të parë për pagesat e pjesshme për vitin e ardhshëm të kontabilitetit.
4. Kërkesa e parë për pagesën e përkohshme nuk duhet të bëhet para se të njoftohet Komisioni i caktimit të autoriteteve drejtuese dhe autoriteteve menaxhuese, në pajtim me nenin 37.
5. Pagesat e përkohshme nuk do të bëhen për Programin nëse raporti vjetor i zbatimit është dërguar te Komisioni në përputhje me nenin 17 (1) dhe (2).
6. Në varësi të fondeve në dispozicion, Komisioni do të bëjë pagesën e përkohshme jo më vonë se 60 ditë pas datës në të cilën kërkesa për pagesë është regjistruar në Komision.

Neni 56

Pagesat për përfituesit

1. Autoriteti certifikues, si rregull i përgjithshëm, duhet të kryejë pagesat për përfituesit udhëheqës në përputhje me paragrafët 2 dhe 3.
2. Në bazë të disponueshmërisë së fondeve nga parafinancimi dhe pagesat fillestare dhe ato vjetore, autoriteti menaxhues do të sigurojë që përfituesi të marrë shumën totale të shpenzimeve publike të pranueshme në mënyrë të plotë dhe jo më vonë se 90 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për pagesë nga përfituesi.
Asnjë shumë nuk do të zbritet ose mbahet dhe asnjë pagesë e veçantë apo pagesë tjetër me efekt të njëjtë nuk do të vendoset, e cila mund të zvogëlojë shumat e caktuara për përfituesit.
Referuar në paragrafin 2, afati i pagesës mund të ndërpritet nga autoriteti menaxhues, në njërin nga këto raste të justifikuara:
 - a) shumat e kërkesës për pagesë nuk vjen për shkak të dokumenteve mbështetëse, duke përfshirë dokumentet e nevojshme për verifikime të menaxhimit sipas pikës (a) të nënparagrafit të parë të nenit 125 (4) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013, të cilat nuk janë siguruar;
 - b) një hetim ka nisur në lidhje me një parregullsi të mundshme që ndikon në shpenzimet në fjalë.Përfituesi në fjalë do të informohet me shkrim për ndërprerjen dhe arsyet përse ka ndodhur kjo ndërprerje.

Neni 57

Përdorimi i euros

1. Shumat e përcaktuara në Program, parashi-kimet e shpenzimeve, deklaratat e shpenzimeve, aplikimet e pagesave, llogaritë dhe shpenzimet e përmendura në raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit duhet të

jenë të shprehura në euro.

2. Shtetet anëtare që nuk kanë miratuar euron si monedhën e tyre në datën e kërkesës për pagesë duhet të kthejnë shumat e shpenzimeve nga monedha kombëtare në euro. Kur euro bëhet monedhën e një vendi anëtar, procedura e konvertimit të përcaktuara në nënparagrafin e parë do të vazhdojë të zbatohet për të gjitha shpenzimet e regjistruara në llogaritë nga autoriteti certifikues para datës së hyrjes në fuqi të normës fikse të konvertimit midis monedhës kombëtare dhe euros.

3. Shpenzimet e bëra në një monedhë të ndryshme nga euro do të konvertohet në euro nga përfituesit, duke përdorur normën mujore të kursit të këmbimit të Komisionit gjatë muajit në të cilin shpenzimi, është:

a) kryer;

b) i është dorëzuar për verifikim autoritetit menaxhues ose kontrollues, në përputhje me nenin 42 (3); ose

c) i është raportuar përfituesit kryesor.

Metoda e zgjedhur për këtë program do të përcaktohen në program dhe do të zbatohen për të gjithë përfituesit.

Konvertimi do të verifikohet nga autoriteti menaxhues ose kontrollues në shtetin anëtar ose nga përfituesit e IPA II në të cilën përfituesi është e vendosur.

Neni 58

Parafinancimi

Në lidhje me parafinancim, pas vendimit të Komisionit në lidhje për miratimin e programit, para financimi do të paguhet nga Komisioni.

Parafinancimi do të arrijë në 50% të detyrimeve 3-vjeçare buxhetore të Programit.

Shuma e parafinancimit, kur është e nevojshme, mund të paguhet në dy këste, në përputhje me nevojat buxhetore.

Nëse aplikimi për pagesën e Programit nuk dërgohet brenda 24 orëve nga data në të cilën Komisioni ka paguar këstin e parë të shumës së parafinancimit, shuma totale e parafinancimit do t'i rimbursohet Komisionit.

Kësti i parë i shumës së parafinancimit do të fshihet tërësisht nga llogaria e Komisionit jo më vonë se kur të mbyllet programi.

Neni 59

Ndërprerja e afatit të pagesave dhe pezullimi i pagesave

1. Në lidhje me ndërprerjen e pagesave do të zbatohet neni 83 i Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

2. Në lidhje me pezullimin e pagesave do të zbatohet neni 142 i Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

NËNSEKSIONI 2

ANULIMI I FONDEVE

Neni 60

Parimet

1. Programi duhet t'i nënshtrohet një procedure anulimi fondesh e ngritur në bazë të shumave që lidhen me detyrimet të cilat nuk janë mbuluar nga parafinancimi ose nga aplikimi për pagesat brenda një periudhe të caktuar, duke përfshirë çdo aplikim për pagesa në të cilin një pjesë ose i gjithë aplikimi është pjesë e ndërprerjes së afatit të pagesave ose e pezullimit të pagesave, të cilat duhet të anulohen.

2. Angazhimet që lidhen me periudhën e shkuar të vitit duhet të anulohen në përputhje me rregullat që do të ndiqen për mbylljen e programit.

3. Pjesë të angazhimeve të cilat mbeten ende të hapura duhet të anulohen nëse ndonjë nga dokumentet e kërkuara për mbylljen nuk i është dorëzuar Komisionit brenda afateve të përcaktuara në nenin 61.

Neni 61

Afati për anulimin

1. Komisioni duhet të anulojë çdo shumë të programit

a) e cila nuk është përdorur për pagesat fillestare dhe vjetore të parafinancimit dhe pagesat e ndërmjetme deri më 31 dhjetor të vitit të 3-të financiar, i cili pason angazhimet e vitit buxhetor nën programin e veprimit; ose

b) për të cilën aplikimi i pagesave i hartuar në përputhje me nenin 54 nuk është dorëzuar në përputhje me nenin 55.

2. Pjesa e angazhimeve e cila vazhdon të qëndrojë e hapur deri më 31 dhjetor 2023 do të anulohet nëse ndonjë nga dokumentet e kërkuara nën nenin 69 nuk i është dorëzuar Komisioni deri më 15 shkurt 2025.

Neni 62

Përfshirjet nga anulimi

1. Shuma e cila lidhet me anulimin do të reduktohet nga shumat ekuivalente me atë pjesë të buxhetit të angazhuar, për:

a) projektet të cilat janë pezulluar nga një procedurë ligjore ose nga një vendim administrativ i cili ka efekt pezullues; ose

b) nuk është bërë e mundur kryerja e një kërkesë për pagesa për shkak të forcës madhore e cila ndikon seriozisht në zbatimin e të gjithë programit.

Autoritet Kombëtare të cilat pretendojnë për shkaqe të forcës madhore nën pikën (b) të nënparagrafit të parë duhet të tregojnë pasojat direkte që kjo forcë madhore ka pasur mbi zbatimin e programit.

Për qëllim të pikave (a) dhe (b) të nënparagrafit të parë, reduktimi mund të kërkojë një herë, nëse pezullimet nga forca madhore zgjasin jo më shumë se 1 vit, ose shpeshtësia e cila korrespondon me kohëzgjatjen e forcës madhore ose me numrin e viteve midis datës së vendimit ligjor ose administrative për pezullimin e zbatimit të projektit dhe datës së vendimit përfundimtar ligjor ose administrativ.

2. Deri më 31 janar, vendet anëtare duhet t'i dërgojnë Komisionit informacionin mbi përfshirjet e pikave (a) dhe (b) të nënparagrafit të parë për shumën e cila do të deklarohet në fund të vitit pasardhës.

Neni 63

Procedurat

1. Komisioni duhet të informojë vendet anëtare, përfituesit e IPA II dhe autoritetin menaxhues për ato raste kur ekziston rreziku i aplikimit të rregullit të anulimit nën nenin 60.

2. Në bazë të informacionit të marrë deri më 31 janar, Komisioni duhet të informojë vendet anëtare dhe përfituesit e IPA II, si dhe autoritetin menaxhues mbi shumën e anulimit që rezulton nga ky informacion.

3. Vendet anëtare kanë afat 2 muaj për të rënë dakord mbi shumën e cila do të anulohet ose do t'i nënshtrohet vëzhgimeve.

4. Deri më 30 qershor, vendet anëtare do t'i dorëzojnë Komisionit një plan financiar të rishikuar, i cili do të reflektojë, për vitin financiar që lidhet me të, shumën e reduktuar që është ofruar për të mbështetur një ose më shumë prioritetet të programit. Nëse kjo procedurë dështon, Komisioni duhet të rishikojë planin financiar duke reduktuar asistencën financiare IPA II për vitin financiar që lidhet me të. Reduktimi do t'i alokohet në mënyrë proporcionale secilit prioritet.

5. Komisioni do ta ndryshojë (amendojë) vendimin e miratimit të Programit, me anë të akteve zbatuese, jo më vonë se data 30 shtator.

NËNSEKSIONI 3

SHQYRTIMI DHE PRANIMI I LLOGARIVE

Neni 64

Përgatitja e llogarive

1. Llogaritë e referuara në pikën (a) të nenit 59 (5) të Rregullores Financiare i dorëzohen Komisionit për secilin program bashkëpunimi. Llogaritë duhet të mbulojnë vitin financiar dhe përfshihen në nivel të çdo

prioriteti:

a) Shuma e përgjithshme e shpenzimeve të lejuara të përfshira në sistemin e llogarive të autoritetit certifikues, i cili është përfshirë në kërkesat e pagesave që do i dorëzohen Komisionit në përputhje me nenin 54 dhe nenin 55 (2) deri më 31 korrik nga përfundimi i vitit financiar, shuma totale e shpenzimeve publike të realizuara për zbatimin e projekteve, dhe shuma totale e pagesave përkatëse që u janë bërë përfituesve nën nenin 56(2);

b) Pagesat e tërhequra dhe të kthyer gjatë vitit financiar, pagesat për t'u kthyer në fund të vitit financiar, si dhe kthimet e bëra në përputhje me nenin 32 dhe shumat e pakthyeshme;

c) Shumat e kontributit të programit dhe parapagesa nga ndihma shtetërore nën nenin 131 (4) të Rregullores së BE-së nr. 1303/2013;

d) Për secilin prioritet, një përputhje midis shpenzimeve të përcaktuar në pikën (a) dhe shpenzimeve të deklaruara në përputhje me të njëjtin vit financiar në aplikimet e pagesave, të shoqëruara nga shpjegimet përkatëse për diferencat.

2. Kur shpenzimet e përfshira më parë në një aplikim për pagesat e ndërmjetme për vitin financiar përjashtohet nga një vend anëtar nga llogaritë e tij për shkak të një vlerësimi të vazhdueshëm për lejueshmërinë dhe rregullsinë e tij, të gjitha ose ndonjë nga shpenzimet e konstatuara më pas që janë të ligjshme dhe të rregullta mund të përfshihen në një aplikim për pagesat e ndërmjetme që lidhen me vitin financiar pasues.

3. Llogaritë do të përgatiten në përputhje me nenin 7 dhe shtojcën VII të Rregullores së Komisionit për Zbatim (BE) nr. 1011/2014.

Neni 65

Paraqitja e informacionit

Për secilin vit nga 2016 deri më dhe duke përfshirë vitin 2025, vendet anëtare duhet të dorëzojnë brenda afatit të përcaktuar në nenin 59 (5) të Rregullores së Financimit dokumentet e përcaktuara në atë nen, si më poshtë:

a) Llogaritë e referuara në nenin 64 (1) për vitin financiar pasardhës;

b) Pasqyra e menaxhimit dhe përmbledhja vjetore referuar pikës (e) të nënparagrafit të parë të nenin 125 (4) të Rregullores së (BE) nr. 1303/2013, për vitin pasardhës financiar;

c) Opinioni i auditimit dhe raporti i kontrollit referuar pikave (a) dhe (b) të nënparagrafit të parë të nenit 127 (5) të Rregullores së (BE) nr. 1303/2013, për vitin pasardhës financiar.

Neni 66

Shqyrtimi dhe pranimi i llogarive

1. Do të aplikohen dispozita e nenin 139(1) e Rregullores së BE-së nr. 1303/2013.

2. Vendet pjesëmarrëse ose përfituesit e IPA II mund të zëvendësojnë shumat e parregullta të identifikuar pas miratimit të llogarive, duke kryer rregullimet e nevojshme në llogaritë për vitin financiar në të cilin është identifikuar parregullsia, pa cenuar nenet 74 dhe 75.

Neni 67

Afati

Deri më 31 maj të vitit pasues të periudhës së financimit, Komisioni, në përputhje me nenin 59(6) të Rregullores së Financimit, duhet të aplikojë procedurat për shqyrtimin dhe pranimin e llogarive dhe informimin e autoriteteve menaxhuese mbi pranimin dhe përfundimin e llogarive në mënyrën e duhur dhe në përputhje me nenin 139 të Rregullores së BE-së nr. 1303/2013.

Neni 68

Disponueshmëria e dokumenteve

Në lidhje me detyrimin e autoritetit menaxhues për të bërë të disponueshme dokumentet, duhet të zbatohet neni 140 i Rregullores së BE-së nr. 1303/2013.

Neni 69

Dorëzimi i dokumenteve mbyllëse

Përveç dokumenteve të cituara në nenin 65, për vitin e fundit financiar nga 1 korriku 2023 deri më 30 qershor 2024 autoritetet menaxhuese duhet të dorëzojnë raportin final të zbatimit të programit.

Neni 70

Pagesa e bilancit përfundimtar

Pagesa e transhit të fundit duhet të kryhet jo më vonë se tre muaj pas datës së miratimit të llogarive të vitit të fundit financiar ose një muaj pas datës së miratimit të raportit final të zbatimit, cilado datë të jetë më e vonë.

NËNSEKSIONI 4

KORRIGJIMET FINANCIARE DHE RIKUPERIMET NGA VENDET PJESËMARRËSE

Neni 71

Përgjegjësitë e vendeve pjesëmarrëse

1. Vendet pjesëmarrëse duhet të identifikojnë, parandalojnë dhe korrigjojnë parregullsitë, si dhe duhet të mbulojnë shpenzimet financiare të paguara jo në mënyrën e duhur, së bashku me interesat e pagesave të vonuara.

2. Vendet pjesëmarrëse duhet të jenë përgjegjës për hetimin e parregullsive dhe për kryerjen e korrigjimeve financiare të nevojshme dhe mbulimin e shpenzimeve. Në rastet e parregullsisë sistematike, vendet pjesëmarrëse duhet të zgjerojnë hetimin e parregullsive për të mbuluar projektet potenciale të cenuara.

3. Vendet pjesëmarrëse duhet të kryejnë korrigjimet financiare të kërkuara në përputhje me parregullsitë individuale ose të sistemit të identifikuar në projektet ose programet operationale. Korrigjimet financiare duhet të konsistojnë në anulimin e pjesës së kontributit publik të një projekti ose programet operationale. Vendet pjesëmarrëse duhet të marrin në konsideratë natyrën dhe rëndësinë e parregullsive, si dhe humbjet financiare të asistencës financiare IPA II dhe duhet të zbatojnë një korrigjim proporcional. Korrigjimet financiare duhet të regjistrohen në llogaritë e vitit financiar ku anulimi është identifikuar.

4. Kontributi nga asistenca IPA II i anuluar në përputhje me paragrafin 3 mund të ripërdoret nga vendet pjesëmarrëse, në kuadër të programit në fjalë, në bazë të paragrafit 5.

5. Kontributi i anuluar në përputhje me paragrafin 3 mund të refuzohet për çdo veprim i cili ishte subjekt i anulimit ose kur korrigjimi financiar është bërë për parregullsi sistematike, për çdo veprim që cenohej nga kjo parregullsi.

Neni 72

Njoftimi i parregullsive

1. Në emër të vendeve pjesëmarrëse, autoriteti menaxhues duhet të njoftojë Komisionin për parregullsitë, të cilat tejkalojnë 10 000 EURO të kontributit të asistencës IPA II, si dhe duhet t'i mbajë të informuar mbi progresin e kryer në lidhje me çështjet administrative dhe procedurat ligjore.

2. Autoriteti Menaxhues nuk duhet të njoftojë Komisionin për parregullsitë të cilat ndodhin në vendet pjesëmarrëse, në lidhje me sa më poshtë:

a) Rastet kur parregullsitë konsistojnë vetëm në dështimin e ekzekutimit, tërësisht ose pjesërisht, të një projekti të përfshirë në bashkëfinancimin e programit të bashkëpunimit për shkak të falimentimit të përfituesit;

b) Rastet e sjella në vëmendjen e autoritetit menaxhues ose të autoritetit certifikues vullnetarisht nga përfituesi dhe para identifikimit nga autoriteti, qoftë përpara ose pas pagesës së kontributit publik;

c) Rastet të cilat janë identifikuar dhe rregulluar nga autoriteti menaxhues ose autoriteti certifikues para përfshirjes së shpenzimeve në aplikimet e pagesave të dorëzuara në Komision.

3. Në të gjitha rastet e tjera, veçanërisht ato në të cilat i paraprijnë falimentimit ose në rastet e dyshimeve për mashtrim, parregullsitë e identifikuar dhe masat parandaluese dhe korrigjuese duhet të raportohen në Komision.

4. Rregulloja e Deleguar e Komisionit (BE) nr. 2015/1970¹, e cila përcakton rregulla të detajuara shtesë mbi kriterin e përcaktimit të rasteve të parregullsive që do të raportohen dhe të dhënat që duhet të sigurohen për t'u aplikuar.

5. Rregullorja e Zbatimit të Komisionit (BE) nr. 2015/1974², e cila përcakton shpeshtësinë dhe formatin që duhet të ndjekin raportimet e parregullsive.

Neni 73 **Rikuperimet**

1. Autoriteti Menaxhues duhet të sigurojë se çdo shumë e paguar si rezultat i parregullsive është rikthyer nga përfituesi lider ose i vetëm. Përfituesit duhet t'i shlyejnë përfituesit lider çdo shumë të paguar tepër.

2. Nëse përfituesi nuk siguron shlyerjet nga përfituesit e tjerë ose nëse autoriteti menaxhues nuk siguron pagesat nga përfituesi lider ose i vetëm, vendi pjesëmarrës në territorin e të cilit përfituesi në fjalë është i vendosur ose në rastet e një EGTC-je, është i regjistruar duhet t'i rimbursojë autoritetit menaxhues çdo shumë të paguar tepër përfituesit. Autoriteti menaxhues duhet të jetë përgjegjës për rimbursimin e shumave që lidhen me buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit, në përputhje me shpërndarjen e detyrimeve midis vendeve pjesëmarrëse siç është parashikuar në Program.

3. Vendet pjesëmarrëse mund të vendosin të mos i rikthejnë shumë paguar tepër nëse shuma që duhet të rikthehet nga përfituesi, duke mos përfshirë interes, nuk i kalon 250 EURO të kontributit të asistencës IPA II.

4. Rregulloja e deleguar e Komisionit (BE) nr. 2015/568³, e cila përcakton rregulla të detajuara shtesë mbi kushtet dhe procedurat që duhet të aplikohen për të përcaktuar nëse shumat të cilat janë të pakthyeshme do të rimbursohen.

NËNSEKSIONI 5 **KORRIGJIMET FINANCIARE NGA KOMISIONI**

Neni 74 **Shkelja e kriterëve dhe e ligjit të zbatueshëm**

1. Komisioni duhet të bëjë korrigjime financiare duke anuluar të gjithën ose një pjesë të asistencës IPA për Programin dhe të ndikojë në mbulimin e efekteve financiare nga vendet anëtare dhe përfituesit e IPA II duke përjashtuar financimin e shpenzimeve nga BE-ja, e cila është në kundërshtim me ligjin me ligjin e zbatueshëm.

2. Shkelja e ligjit në fuqi do të çojë në një korrigjim financiar vetëm në lidhje me shpenzimet e deklaruara në Komision dhe ku plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) Shkelja e ligjit ka ndikuar në përzgjedhjen e projekteve nga trupa përgjegjëse për mbështetjen e asistencës IPA II ose në rastet kur, për shkak të natyrës së shkeljes së ligjit nuk është e mundur krijimi i një ndikimi, por ekziston një risk i arsyetuar që kjo shkelje ka krijuar një efekt të tillë;

b) Shkelja e ligjit ka ndikuar në shumën e shpenzimeve të deklaruara për rimbursim nga buxheti i Unionit ose në rastet kur, për shkak të natyrës së shkeljes, nuk është e mundur të përcaktohet ndikimi financiar, por ekziston një risk i arsyetuar që kjo shkelje ka krijuar një efekt të tillë.

3. Në lidhje me kriterin e korrigjimeve financiare, do të aplikohen dispozitat e nenit 144 (1) të Rregullores së (BE) nr. 1303/2013.

¹ Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2015/1970 e 8 korrikut 2015 plotëson Rregulloren (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian me dispozitat specifike për raportimin e parregullsive që lidhen me Fondin e Zhvillimit Rajonal Evropian, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit dhe Fondin Detar dhe të Peshkimit Evropian, FZ L 293, 10.11.2015, f. 1.

² Rregullorja e Zbatimit e Komisionit (BE) 2015/1974 e 8 korrikut 2015, e cila përcakton shpeshtësinë dhe formatin e raportimit të parregullsive në lidhje me Fondin e Zhvillimit Rajonal Evropian, Fondin e Ndihmës Sociale, Fondin e Kohezionit dhe Fondin Detar dhe të Peshkimit Evropian, nën Rregulloren (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, FZ L 293, 10.11.2015, f. 20.

³ Rregullorja e Delegimit e Komisionit (BE) nr. 2016/568 e 29 janarit 2016 Rregullorja plotësuese (BE) nr. 1303/2013 e Këshillit dhe e Parlamentit Evropian në lidhje me kushtet dhe procedurat të cilat përcaktojnë nëse shumat e pakthyeshme do të rimbursohen ngave vendet anëtare në lidhje me Fondin e Zhvillimit Rajonal Evropian, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit dhe Fondin Detar dhe të Peshkimit Evropian, FZ L 97, 13 prill 2016, f. 1.

4. Do të zbatohen nenet 30 dhe 31 të Rregullores së Delegimit të Komisionit (BE) nr. 480/2014 në lidhje korrigjimet financiare për sistemin e mangësive nga Komisioni.

Neni 75

Procedurat

1. Kur vendoset për një korrigjim financiar duke u bazuar në nenin 74 (1), Komisioni do të respektojë parimin e proporcionalitetit, duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e shkeljes së ligjit në fuqi dhe implikimet e saj financiare për buxhetin e Unionit. Komisioni duhet të mbajë të informuar Parlamentin Evropian për vendimin për të aplikuar korrigjimet financiare

2. Kriteret dhe procedurat për aplikimin e korrigjimeve financiare duhet të përcaktohen në rregullat specifike të financimit.

3. Për sa u përket procedurave do të zbatohen dispozitat e nenit 145(1) dhe (7) të Rregullores (BE) nr. 1303/2013.

Neni 76

Detyrimet e vendeve pjesëmarrëse

Korrigjimet financiare të Komisionit nuk duhet të përjashtojnë vendet anëtare nga detyrimi për të ndjekur kthimet sipas nenit 71 (3) dhe vendet anëtare për të rimarrë ndihmën shtetërore sipas nenit 107 (1) dhe në bazë të nenit 14 të Rregullores së Këshillit 659/1999¹.

Neni 77

Shlyerjet

1. Çdo shlyerje që do të bëhet në buxhetin e Unionit do të kryhet para afatit të përcaktuar në urdhrin për rikthimin, i cili është hartuar në përputhje me nenin 73 të Rregullores së Financimit. Data e duhur do të jetë dita e fundit e muajit të dytë pas lëshimit të urdhrin.

2. Çdo vonesë në shlyerje do të ndikojë në rritjen e interesave duke filluar nga data e caktuar deri në datën e pagesës aktuale. Norma e interesit do të jetë 1.5% mbi normën e aplikuar nga Banka Qendrore Evropiane në veprimet e saj kryesore për rifinancim në ditën e parë të punës së muajit në të cilin bie data e përcaktuar.

SEKSIONI XII

NDËRPRERJA E PROGRAMIT

Neni 78

Dështimi për nënshkrimin e Marrëveshjes së Financimit

1. Kur përfituesi IPA II nuk e ka nënshkruar marrëveshjen e financimit deri në fund të vitit që pason vitin e miratimit të Programit, Komisioni ndërpret programin.

2. Këstet (pagesat) vjetore të Fondit Evropian për Zhvillimin Rajonal tashmë të angazhuara mbeten në dispozicion për gjithë kohëzgjatjen e tyre normale, por mund të përdoren vetëm për aktivitete që zhvillohen vetëm në shtetet anëtare në fjalë dhe që janë të kontraktuara para vendimit të ndërprerjes nga Komisioni. Autoriteti menaxhues transmeton raportin përfundimtar brenda tre muajve nga mbyllja e kontratave të Komisionit që veprojnë në pajtim me nenet 79 dhe 80.

Neni 79

Problemet e zbatimit

1. Në rastet kur program nuk mund të zbatohet për shkak të problemeve të lindura midis vendeve pjesëmarrëse dhe në raste të tjera të justifikuara, Komisioni mund të vendos ndërprerjen e programit përpara datës së mbarimit të periudhës së ekzekutimit, me kërkesën të KPM-së ose me iniciativën e tij pas konsultimit me KPM-në.

¹ Rregullorja e Këshillit (BE) nr. 659/1999 e 22 marsit 1999, e cila përcakton në mënyrë të detajuar rregullat për aplikimin e nenit 93 të Traktatit të BE-së, OJ L 83, 27.3.1999, f. 1

2. Kur Programi ndërpritet, autoriteti menaxhues duke u bazuar në vendimin e Komisionit do të dorëzojë brenda 6 muajve raportin final. Pas përfundimit të pagesave të parafinancimit, Komisioni duhet të paguajë diferencën ose kur është e përshtatshme, lëshimin e urdhrit për rikthim. Komisioni duhet të anulojë dhe bilancin e angazhimeve financiare.

3. Si një zgjidhje alternative mund të vendoset të reduktohen alokimet e Programit për t'i përdorur në funksion të qëllimit të programit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 10(6).

Neni 80

Rialokimet

1. Në rastet e përmendura në nenet 78 dhe 79, mbështetje e paangazhuar nga Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal që korrespondon me kështet ose pagesat vjetore ende jo të angazhuara ose kështet vjetore të angazhuara dhe të anuluarat tërësisht ose pjesërisht gjatë të njëjtit vit buxhetor, të cilat nuk kanë qenë të rialokuara për një Program tjetër të së njëjtës kategori të programeve të bashkëpunimit të jashtëm, do të alokohen ose ndahen për programet e brendshme ndërkufitare të bashkëpunimit në përputhje me nenin 4 të Rregullores së Bashkëpunimit Territorial Evropian (ETJ).

Asistenca IPA II korrespondon me kështet ose pagesa vjetore ende të paangazhuara ose kështet vjetore të angazhuara dhe anuluarat tërësisht ose pjesërisht gjatë të njëjtit vit buxhetor përdoren për të financuar programe ose projekte të tjera që janë të pranueshëm për asistencën IPA II.

PJESA II

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 81

Konsultimi midis vendeve pjesëmarrëse dhe Komisionit

1. Përfituesi IPA II dhe Komisioni duhet të konsultohen me njëri tjetrin para se të ndërmarrin çfarëdo mase lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi mbi bazën e nenit 85 të këtyre Kushteve të Përgjithshme ose çdo konflikt në lidhje me interpretimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi që nuk mund të zgjidhet në përputhje me nenin 3 të kushteve të veçanta.

2. Në rastet kur Komisioni njihet me problematika të përfituesit IPA II lidhur me zbatimin e procedurave për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, duhet të vendosë të gjitha kontaktet e mundshme me përfituesin IPA II për të zgjidhur situatën dhe ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme.

3. Si rezultat i këtij konsultimi, kjo Marrëveshjeje Financimi mund të ndryshohet, pezullohet ose përfundohet.

4. Komisioni dhe përfituesi IPA II, duhet të informojnë shtetin anëtar lidhur me çdo konsultim ose kontakt sipas paragrafëve 1 dhe 2.

5. Komisioni duhet të konsultojë shtetin anëtar para se të ndërmarrë ndonjë nga masat e parashikuara në paragrafin 3.

Neni 82

Amendimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje Financiare duhet të bëhet në formë të shkruar.

2. Në rast se ndonjëri prej vendeve pjesëmarrës kërkon një ndryshim, kjo kërkesë duhet t'i përcillet Komisionit të paktën gjashtë muaj para hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi.

3. Në rast se Komisioni vjen në dijeni të një mos përputhjeje midis dispozitave të Marrëveshjes së Financimit dhe akteve bazë të renditura në nenin 1 të kushteve të veçanta, Komisioni duhet të propozojë të gjitha përshtatjet e domosdoshme të kësaj Marrëveshjeje Financiare me dispozitat e akteve kryesore.

Në rast se aktet bazë pësojnë ndonjë ndryshim, Komisioni duhet të propozojë të gjitha përshtatjet e domosdoshme të kësaj Marrëveshjeje Financiare me dispozitat e ndryshuara të akteve kryesore, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi.

4. Komisioni mund të ndryshojë Rregulloren e Zbatimit (BE) nr. 2015/207 për sa u përket modeleve të ndryshme pa qenë i nevojshëm një ndryshim i kësaj MF-je. Përfituesi IPA II duhet të informohet me shkrim lidhur me secilin prej këtyre modifikimeve dhe hyrjen e tyre në fuqi.

Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Marrëveshja e Financimit mund të pezullohet në rastet e mëposhtëm:

- a) Në rast se përfituesi IPA II shkel ndonjërin prej detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje Financimi;
- b) Në rast se përfituesi IPA II shkel ndonjë prej detyrimeve të përcaktuar në dokumentet procedurale dhe standarde sipas nenit 18(2) të Marrëveshjes Kuadër;
- c) Në rast se përfituesi IPA II nuk plotëson kërkesat për besimin e detyrave të zbatimit të buxhetit;
- d) Në rast se përfituesi IPA II vendos të pezullojë ose të heqë dorë nga procesi i anëtarësimit në BE;
- e) Në rast se përfituesi IPA II shkel një detyrim lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, të parimeve të demokracisë dhe të mbizotërimit të ligjit ose në raste të rënda korrupsioni.

2. Kjo Marrëveshje Financimi mund të pezullohet në rast të forcave madhore përcaktuar si më poshtë:

“Forcë madhore” do të thotë çdo situatë të paparashikueshme dhe të jashtëzakonshme, ose secila ngjarje që shkon përtej kontrollit të palëve dhe që pengon secilën prej tyre për të përmbushur detyrimet e tyre, që nuk mund të lidhet me gabime ose neglizhencë nga ana e tyre (ose nga kontraktuesit, agjentët ose të punësuarit e tyre) dhe vërtetohet të ketë qenë i pashmangshëm edhe pse është përdorur i gjithë verifikimi i mundshëm. Defektet e pajisjeve ose materialeve ose vonesa në vënien e tyre në dispozicion, konflikte në punë, greva ose vështirësi financiare, nuk mund të konsiderohen si forcë madhore. Njëra nga palët nuk mund të konsiderohet të ketë shkelur detyrimet e saj në rast se nuk i ka përmbushur për shkak të një arsye madhore mbi të cilën pala tjetër është informuar. Njëra prej palëve e prekur nga forca madhore, duhet të informojë palën/palët e tjera pa vonesa, duke saktësuar llojin, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikuara të problematikës, dhe të marrin çdo masë për të minimizuar dëmin e mundshëm. Në rast se forca madhore prek vetëm pjesë të Programit, pezullimi i Marrëveshjes së Financimit do të jetë i pjesshëm.

Asnjëra prej Palëve nuk mund të konsiderohet të ketë shkelur detyrimet e saj në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Financimi në rast se është detyruar nga forca madhore, duke vërtetuar që ka marrë të gjitha masat për të minimizuar çdo dëm të mundshëm.

3. Komisioni mund të pezullojë këtë Marrëveshje Financimi pa njoftim paraprak.

4. Komisioni duhet të ndërmarrë çdo masë të nevojshme para se pezullimi të hyj në fuqi.

5. Në rastet kur njoftohet pezullimi, duhet të saktësohen pasojat mbi prokurimet ose kontratat e grantit në zbatim ose në fazë nënshkrimi, dhe duhet të përcaktohen marrëveshjet e delegimit.

6. Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje nuk cenon ndërprerjen e pagesave në përputhje me nenin 59 dhe me përfundimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nga Komisioni sipas nenit 84.

7. Palët mund të rifillojnë zbatimin e Marrëveshjes së Financimit në rast se kushtet do ta lejojnë dhe vetëm me miratimin paraprak në formë të shkruar nga Komisioni. Kjo nuk cenon asnjë ndryshim të kësaj Marrëveshjeje Financimi që do të rezultojë i nevojshëm për të përshtatur Programin me kushtet e reja të zbatimit, përfshirë, në rast se është e mundur, kohëzgjatjen e periudhës së lejueshmërisë ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi në përputhje me nenin 84.

Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Në rast se çështjet që kanë sjellë në pezullimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nuk zgjidhen brenda një periudhe maksimale prej 180 ditësh, secila nga Palët mund të përfundojë Marrëveshjen Financiare pas 30 ditëve nga njoftimi.

2. Kjo Marrëveshje Financimi duhet të përfundohet automatikisht në rastet kur brenda periudhës 2-vjeçare nga nënshkrimi i saj:

- a) Nuk është kryer asnjë pagesë;
- b) Nuk është nënshkruar ndonjë kontratë zbatimi ose marrëveshje delegimi.

3. Në rastet kur përfundimi është njoftuar, duhet të përcaktohen pasojat për prokurimet dhe kontratat e grantit në zbatim, marrëveshjet e delegimit dhe për kontratat e grantit ose marrëveshjet e delegimit në fazë nënshkrimi.

4. Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi nuk duhet të pengojë mundësinë që Komisioni të kryejë korrigjime financiare në përputhje me nenet 74 deri 77.

Dispozitat për zgjidhjen e kontradiktave

1. Në rast se kontradiktat lidhur me këtë Marrëveshje Financimi nuk mund të zgjidhen brenda një periudhe 6-mujore nëpërmjet konsultimit midis palëve sipas nenit 81, këto do të zgjidhen me arbitrazh sipas kërkesës nga njëra prej palëve.

2. Secila prej palëve duhet të caktojë një arbitër brenda 30 ditëve nga kërkesa për arbitrazh. Në rast se palët nuk janë në gjendje të caktojnë arbitrin përkatës, secila prej palëve mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit (Hagë) të caktojë një arbitër të dytë. Të dy arbitrat duhet të caktojnë një arbitër të tretë brenda 30 ditëve. Në rast se edhe kjo nuk realizohet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit të caktojë arbitrin e tretë.

3. Në rast se arbitrat nuk vendosin ndryshe, duhet të zbatohet procedura e përcaktuar në Rregulloren Opsionale për Arbitrazhin që përfshin organizatat ndërkombëtare dhe shtetet e Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit. Vendimet e arbitrave duhet të merren me shumicë brenda një periudhe tremujore.

4. Secila prej palëve është e detyruar të marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve.

